



# **RAPORTI VJETOR 2024**

## PËRMBAJTJA

<b>RAPORTI VJETOR 2024</b> .....	1
<b>HYRJE</b> .....	7
<b>FUNKSIONIMI I DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË TATIMEVE</b> .....	7
Misioni .....	7
<b>II.REALIZIMI I TË ARDHURAVE</b> .....	9
Menaxhimi sipas objektivave.....	9
Të ardhurat e vitit 2024 .....	9
Grafik 1. Struktura e të ardhurave .....	12
Tabela 1. Totali DPT 12 Mujori 2024 .....	13
Tabela 2. Të ardhurat e realizuara për vitin 2024 sipas DRT-ve (000 lekë).....	14
Tabela 3. Të ardhura nga Tatimi mbi Vlerën e Shtuar (000 lekë) .....	14
Tabela 4. Të ardhura nga Tatimi mbi Fitimin (000 lekë).....	15
Tabela 5. Të ardhura nga Tatimi mbi të Ardhurat Personale (000 lekë).....	15
Tabela 6. Krahasimi TAP sipas zërave (000 lekë) .....	16
Tabela 7. Të ardhura nga Taksat Kombëtare dhe Tarifa (000 lekë) .....	16
Tabela 8. Taksat Kombëtare dhe Tarifat sipas llojeve (përfshirë Tarifa Buxhetore) .....	18
Tabela 9. Të ardhura nga Taksa e Qarkullimit Rrugor (000 lekë).....	19
Tabela 10. Të ardhurat nga sigurimet shoqërore & shëndetësore .....	19
Sektori i Kontabilitetit dhe Pagesës .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
<b>III. SHËRBIMI I TATIMPAGUESVE</b> .....	23
I. Puna e kryer nga Sektori i Asistencës dhe shërbimit ndaj tatimpaguesve .....	23
Tabela 1. Vërtetime të lëshuara/miratuara në sportelet e shërbimit 2024.....	26
Tabela 2. Vërtetime të lëshuara online nga portali e-Albania 2024.....	26
II. Sektori i Thirrjeve dhe struktura organizative.....	28
III. Aktivitete të realizuara gjatë vitit 2024.....	29
<b>IV. PERFORMANCA TEKNIKO-LIGJORE</b> .....	33
Hyrje .....	33
Objektivat e drejtorisë për vitin 2024.....	34
Progresi Organizativ i Administratës Tatimore dhe Zhvillimi i kapaciteteve njerëzore .....	35
Aktivitetet e programuara dhe realizuara gjatë vitit 2024 në funksion të realizimit të objektivave .....	35
Sektori Ligjor.....	35
Sektori Teknik.....	38
<b>V. KONTROLLI TATIMOR</b> .....	42

Objektivat për vitin 2024.....	43
Aktivitete të realizuara për vitin 2024 .....	47
<b>VI.MENAXHIMI I RISKUT</b> .....	49
Objektivat e Drejtorisë për vitin 2024 .....	49
Aktivitetet e programuara dhe realizuara gjatë vitit 2024 në funksion të realizimit të objektivave .....	50
Plani i Turizmit 2024 .....	50
Informaliteti në punë.....	52
Përmirësimi i Modullit të Riskut .....	53
Analizimi i riskut të tatimpaguesve që bëjnë Kërkesë për Rimbursim.....	54
Analiza periodike për fenomene të ndryshme , tatime të veçanta dhe për sektorë të caktuar .....	54
Të tjera aktivitete të realizuara nga DMR gjatë vitit 2024.....	61
Projekte të ndërmarra aktualisht në bashkëpunim me organizma ndërkombetare .....	62
<b>VII. DREJTORIA E MBLEDHJES SE DETYRIMEVE TATIMORE TE PAPAGUARA</b> .....	64
Detyrimet sipas Llojit të Tatimit.....	65
Detyrimet sipas llojit të Tatimit 2024 vs 2023 në miliardë lekë .....	66
Mosha e detyrimeve të papaguara në afat.....	66
Detyrimet sipas statusit të tatimpaguesit.....	67
<b>VIII. RIMBURSIMI I TVSH-SË</b> .....	69
Objekti dhe detyrat e Drejtorisë së Rimbursimit të TVSH-së.....	69
Baza Ligjore.....	69
Aktivitetet e programuara dhe realizuara për vitin 2024 .....	71
Trajtimi dhe Rimbursimi i kërkesave për rimbursim të TVSH-së sipas afateve ligjore; .....	71
Publikimi i Stokut të Rimbursimit të TVSH-së; .....	74
Automatizimi i sistemit të trajtimit të kërkesave për rimbursim. ....	75
Rimbursimi i TVSH-së për projektet e kryera në kuadër të marrëveshjeve financiare të ratifikuara nga Kuvendi .....	75
<b>IX. DREJTORIA E VERIFIKIMIT DHE KOORDINIMIT NË TERREN NË DPT</b> .....	76
Organizimi.....	76
Qëllimi .....	76
Objektivat .....	76
Realizimet .....	76
Grafiku 1: Verifikimet dhe Shkeljet e DVKT-së .....	77
Grafiku 2: Vlera e Shkeljeve sipas DVKT-ve .....	77
Grafiku 3: Shkeljet kryesore të DVKT-së.....	78

Krahasimore e kontrolleve gjatë vitit 2023 me vitin 2024 .....	78
Denoncime/Ankesa.....	80
<b>X. MARRËDHËNIET ME JASHTË DHE MENAXHIMI I PROJEKTEVE.....</b>	<b>84</b>
Hyrje.....	84
Detyrat funksionale .....	84
Objektivat për vitin 2024.....	85
Aktivitetet e programuara dhe realizuara gjatë 2024 në funksion të realizimit të objektivave.....	85
Sektori për Marrëdhëniet me Jashtë .....	85
Sektori i Menaxhimit të Projekteve .....	86
<b>XI.BURIMET NJEREZORE .....</b>	<b>88</b>
Struktura organizative .....	88
Aktivitetet në vitin 2024 .....	89
Trajnimi dhe ngritja e kapaciteteve të burimeve njerëzore.....	90
Masat disiplinore .....	92
Të dhënat për vlerësimet e rezultateve në punë për vitin 2024.....	93
<b>XII. BUXHETI DHE FINANCA .....</b>	<b>95</b>
Shpenzimet faktike-Viti 2024 .....	95
Numri i punonjësve në Administratën Tatimore në vitin 2024.....	96
<b>XIII. DREJTORIA E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE .....</b>	<b>97</b>
SEKTORI I BRENDSHËM.....	97
SEKTORI I PROKURIMEVE.....	98
Investime të realizuara në vitin 2024.....	99
<b>XIV. DIBA .....</b>	<b>100</b>
<b>XV. Drejtoria e Kontrollit të Specializuar .....</b>	<b>101</b>
Hyrje .....	101
Struktura organizative .....	101
Objekti dhe detyrat për vitin 2024 .....	102
Aktivitetet e planifikuara dhe të realizuara gjatë vitit 2024 .....	102
Plani Sektorial i Informalitetit të Pagave.....	102
Plani i Përbushjes për Individët me të Ardhura të Larta, Viti 2022 .....	103
Plani i veprimt për individët që nuk kanë dorëzuar DIVA për vitin 2023.....	104
Trajnimi i stafit .....	105
<b>XVI. DREJTORIA PËR PROCESET E BIZNESIT.....</b>	<b>106</b>
Varësia sipas strukturës organizative të DPT dhe historiku i krijimit. ....	106

Organizimi.....	106
Sektori i Koordinimit të Manualeve të Punës .....	107
Sektori i Analizës dhe implementimit .....	108
Bashkëpunimi me palët e treta.....	108
Veprimtaritë në proces dhe të kryera.....	109
<b>XVII. DREJTORIA E INFORMACIONIT .....</b>	<b>111</b>
Detyrat kryesore të Drejtorisë së Informacionit .....	111
Organizimi i Drejtorisë së Informacionit .....	112
Objektivat e Drejtorisë për vitin 2024 .....	112
<b>AKTIVITETET E PROGRAMUARA DHE KRYERA GJATË VITIT 2024 .....</b>	<b>113</b>
<b>SEKTORI I KOMUNIKIMIT .....</b>	<b>113</b>
<b>SEKTORI I SHKËMBIMIT TË INFORMACIONIT.....</b>	<b>115</b>

Raporti vjetor i Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve është një dokument publik i cili ngarkohet në faqen zyrtare të internetit, [www.tatime.gov.al](http://www.tatime.gov.al)

<b>Shkurtime</b>	
<b>DPT</b>	Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve
<b>DRT</b>	Drejtoria Rajonale Tatimore
<b>TVSH</b>	Tatimi mbi Vlerën e Shtuar
<b>TAP</b>	Tatimi mbi të Ardhurat Personale
<b>DPD</b>	Drejtoria e Përgjithshme e Doganave
<b>RPA</b>	Regjimi i Përpunimit Aktiv

## HYRJE

### FUNKSIONIMI I DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË TATIMEVE

#### Misioni

Administrata Tatimore Qendrore administron mbledhjen e të ardhurave tatimore dhe kontributeve shoqërore, duke nxitur përmbushjen vullnetare dhe duke kërkuar nga të gjithë kuptimin dhe respektimin e detyrimeve ligjore.

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve është autoriteti shtetëror i specializuar, në varësi të Ministrisë së Financave për krijimin, sigurimin dhe mbledhjen e të ardhurave tatimore dhe Kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë.

Institucioni është i organizuar në nivel qendror me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, përgjegjëse për hartimin, monitorimin dhe zbatimin e strategjive dhe politikave operacionale efikase në realizimin e misionit të institucionit. Në nivel rajonal, institucioni ka 14 Drejtori Rajonale Tatimore dhe në total në organikën e administratës tatimore shqiptare numërohen 1 241 punonjës (fakt 2024) duke e renditur administratën tatimore si një nga institucionet ligj zbatues më të rëndësishëm në vend.

Në këtë frymë, administrata tatimore nisur edhe nga praktikat e shumë vendeve anëtare të BE-së që kanë ndryshuar qëndrimin e tyre ndaj taksapaguesve, duke u larguar nga monitorimi i njëanshëm i përmbushjes së detyrimeve tatimore, u orientua drejt një marrëdhënie proaktive dhe partneriteti me tatimpaguesit, duke investuar në forcimin e besimit të tatimpaguesve në përmbushje të nevojave të tyre. Përvoja tregon se tatimpaguesit e informuar kanë më shumë gjasa të përmbushin detyrimet e tyre në mënyrë të rregullt dhe kjo ka dhënë efekte të matshme e pozitive të cilat do t'i gjeni në treguesit statistikorë në këtë raport.

Të dhënat e vitit 2024 tregojnë se angazhimi serioz në luftën kundër informalitetit ka dhënë efektet e pritura të cilat shërbejnë si indikator për rritjen e besimit dhe sigurimin e një mjedisi të shëndoshë ekonomik.

Objektivat strategjikë nga të cilat AT udhëhiqet janë:

Garantimi i asistencës për përmbushjen vullnetare, përmes:

Ofrimit të shërbimeve cilësore dhe reduktimit të barrës administrative në pagesën e detyrimeve tatimore dhe kontributeve shoqërore.

Rritjes së ndërgjegjësimit publik duke ndihmuar në zhvillimin e kulturës për përbushje vullnetare më të lartë dhe kuptimin e rolit të Administratës Tatimore në shoqëri.

Zbatimi efikas i legjislacionit tatimor dhe sigurimeve shoqërore, dhe hetimi i rasteve të mashtrimit tatimor, përmes:

Zbatimit të strategjisë së përbushjes së menaxhimit të riskut ,

Përmirësimit të mëtejshëm të kontrollit tatimor dhe gjurmimit të mashtrimeve tatimore,

Mbledhjes efikase dhe efektive të borxhit ,

Progresi organizativ i Administratës Tatimore dhe zhvillimi i kapaciteteve njerëzore, përmes;

Aplikimit të metodave dhe sistemeve për të menaxhuar një administratë tatimore moderne,

Zhvillimit të kapaciteteve dhe motivimit të punonjësve,

Mbajtjes së proceseve optimale dhe strukturës së Administratës Tatimore,

Zhvillimit dhe përmirësimit të partneriteteve,

Modernizimit dhe rinovimit të infrastrukturës,

Kënaqësia nga shërbimet elektronike të tatimeve është dukshëm më e lartë në 2024 në të tëra aspektet e vlerësuara, si aksesit, besueshmëria dhe saktësia e përpunimit të të dhënave,

Një rritje e konsiderueshme në vlerësimin për cilësinë e raportit të auditimit, si dhe sjelljen dhe etikën e inspektorëve,

Një rritje të ndjeshme në ndërgjegjësimin e tatimpaguesve për Modulin e Analizës së Riskut dhe përzgjedhjen për inspektim bazuar në të.

## II.REALIZIMI I TË ARDHURAVE

### Menaxhimi sipas objektivave

Gjatë periudhës janar - dhjetor 2024 një ndër objektivat kryesore të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve ka qenë:

Rritja e pajtueshmërisë vullnetare,

Rritja e performancës së mbledhjes të të ardhurave tatimore mbi parashikimet aktuale

Përmirësimi dhe sigurimi i shërbimeve më të mira për tatimpaguesit,

Reforma kundër informalitetit dhe fokusi në mirë-administrim,

Trajnimi i vazhdueshëm për nënpunësit e të gjitha niveleve.

*Në arritjen e objektivave janë mbajtur në konsideratë:*

Përmirësimi i administrimit të mbledhjes së tatimeve me efekte në rritjen e tyre.

Efektet e paketës fiskale për vitin 2023.

Forcimi i mbledhjes së taksave bazuar në strategjinë e riskut të pajtueshmërisë.

Përzgjedhja dhe trajnimi i stafit të administratës tatimore.

### Të ardhurat e vitit 2024

Administrata Tatimore Qendrore, për periudhën 12 mujore 2024, paraqet një performancë pozitive në mbledhjen e të ardhurave. Vendosmëria e administratës për të luftuar evazionin dhe ekonominë informale, si dhe fushatat sensibilizuese të ndërmarra kanë ndikuar në prirjen rritëse të të ardhurave.

### Struktura e të ardhurave

Struktura e mbledhjes së të ardhurave përbëhet nga:

Të ardhurat tatimore neto që përbëjnë **59.3%** të të ardhurave totale neto

Kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore që përbëjnë **40.7%** të të ardhurave totale neto.

Për vitin 2024, të ardhurat tatimore bruto gjithsej janë programuar 400.5 miliardë lekë dhe janë realizuar 405.6 miliardë lekë, me realizim në vlerë prej 5.1 miliardë lekë ose 1.3 % më shumë.

Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2023, me realizim të ardhurash 357.1 miliardë lekë, rritja

e të ardhurave tatimore është 48.5 miliardë lekë më shumë ose 13.6 % më shumë ( \* *Kontributi i Solidaritetit për 12 mujorin 2023 është 9,741,559 mijë lekë dhe nuk përfshihet në krahasimet me vitin 2024*).

Nga të dhënat statistikore të evidencës së realizimit të të ardhurave për këtë periudhë rezulton:

### **Të Ardhurat Tatimore**

Për vitin 2024, të ardhurat tatimore janë programuar 246.9 miliardë lekë dhe janë realizuar 249.8 miliardë lekë, me një realizim prej 2.9 miliardë lekësh ose 1.2% më shumë.

Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2023, në të cilën të ardhurat u realizuan 217.9 miliardë lekë, rezultatet janë në rritje me 31.9 miliardë lekë ose 14.6 % më shumë.

### **Të Ardhurat nga Kontributet e Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore**

Për vitin 2024, të ardhurat nga Kontributet e Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore janë programuar 153.7 miliardë lekë dhe janë realizuar 155.9 miliardë lekë, me një realizim prej 2.2 miliardë lekësh ose 1.4% më shumë.

Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2023, ku të ardhurat nga KSSHSH ishin 139.3 miliardë lekë, rezultatet janë në rritje me 16.6 miliardë lekë ose 11.9 % më shumë.

### **Të Ardhurat Tatimore ndarë sipas llojit**

Realizimi i të ardhurave sipas llojit të tatimeve krahasuar me planin e vitit 2024 dhe faktin e vitit 2023, për periudhën Janar – Dhjetor 2024, bazuar në të dhënat statistikore, paraqitet si më poshtë:

#### ***Tatimi mbi Vlerën e Shtuar***

Për 12 mujorin 2024, të ardhurat tatimore nga Tatimi mbi Vlerën e Shtuar (neto) ishin programuar në vlerën prej 55.2 miliardë lekë dhe janë realizuar në vlerën prej 59.8 miliardë lekë, me një realizim në vlerë prej 4.5 miliardë lekësh ose 8.2% më shumë.

Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2023, në të cilën u arkëtuan 46.0 miliardë lekë, të ardhurat nga TVSH-ja neto janë arkëtuar 13.7 miliardë lekë ose 29.8% më shumë.

#### ***Rimbursimi i TVSH-së***

Për 12 mujorin 2024 rimbursimi për TVSH-në ishte programuar 22.6 miliardë lekë dhe është

realizuar në vlerën 22.4 miliardë lekë me një **mosrealizim prej 0.3 miliardë lekësh ose 1.2% më pak.**

Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2023 në të cilën janë rimbursuar 22.6 miliardë lekë, rimbursimet janë me **mosrealizim 0.2 miliardë lekë ose 1.1% më pak.**

### ***Tatimi mbi Fitimin***

Të ardhurat tatimore nga Tatimi mbi Fitimin, janë programuar 59.7 miliardë lekë dhe aktualisht janë arkëtuar 57.5 miliardë lekë, me një **mosrealizim prej 2.2 miliardë lekësh ose 3.7% më pak.**

Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2023, në të cilën u arkëtuan 55.0 miliardë lekë, të ardhurat nga ky lloj tatimi janë realizuar 2.5 miliardë lekë ose 4.6% më shumë.

### ***Tatimi mbi të Ardhurat Personale***

Tatimi mbi të ardhurat personale është programuar 64.4 miliardë lekë dhe është realizuar 66.7 miliardë lekë, me një realizim prej 2.3 miliardë lekësh ose 3.6% më shumë.

Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, në të cilin u arkëtuan 58.0 miliardë lekë, të ardhurat nga ky lloj tatimi janë realizuar 8.7 miliardë lekë ose 15.1% më shumë.

### ***Taksat Kombëtare dhe Tarifa***

Të ardhurat tatimore nga Taksat dhe Tarifa Kombëtare janë programuar në vlerën 19.2 miliardë lekë dhe faktikisht janë arkëtuar 19.5 miliardë lekë, me një realizim prej 0.3 miliardë lekësh ose 1.7% më shumë.

Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2023, në të cilën u arkëtuan 14.3 miliardë lekë, mbledhja e taksave është në rritje prej 5.2 miliardë lekë ose 36.2 % më shumë.

### ***Taksa e Qarkullimit Rrugor***

Te ardhurat tatimore nga Taksat e Qarkullimit dhe Karburantit, të cilat janë programuar 23.3 miliardë lekë, janë arkëtuar 21.3 miliardë lekë, me një **mosrealizim në vlerë prej 2.0 miliardë lekësh ose 8.6% më pak.**

Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2023, në të cilën u arkëtuan 19.5 miliardë lekë, të ardhurat janë realizuar me rritje prej 1.8 miliardë lekë ose 9.0 % më shume.

## **Struktura e të Ardhurave Tatimore për periudhën 12 mujore 2024**

Struktura e të ardhurave tatimore tregon se:

TVSH-ja vazhdon të jetë kontribuesi kryesor në të hyrat publike me 32.9% të të ardhurave tatimore. Tatimi mbi të ardhurat personale përbën 26.7% të të ardhurave tatimore, Tatimi mbi fitimin zë 23.0 % të të ardhurave tatimore dhe Taksa e qarkullimit 8.5% të të ardhurave tatimore.

Grafik 1. Struktura e të ardhurave




Tabela 1. Totali DPT 12 Mujori 2024

EMERTIMI		FAKTET		PLANI	Diferenca Fakt Plan		Diferenca 2024-2023*	
		2023	2024	2024	+ ose -	Përqindje	+ ose -	Përqindje
	<b>D.P.TATIMEVE TOTAL (Bruto)</b>	<b>357,132,812</b>	<b>405,647,901</b>	<b>400,544,050</b>	<b>5,103,851</b>	<b>1.27%</b>	<b>48,515,088</b>	<b>13.58%</b>
<b>A</b>	Të Ardhurat Tatimore gjithsej (arkëtim)	<b>217,877,895</b>	<b>249,777,085</b>	<b>246,886,050</b>	<b>2,891,035</b>	<b>1.17%</b>	<b>31,899,191</b>	<b>14.64%</b>
<b>1</b>	TVSH (bruto)	68,657,656	82,155,813	77,875,000	4,280,813	5.50%	13,498,158	19.66%
	- TVSH (neto)	46,043,114	59,782,174	55,239,000	4,543,174	8.22%	13,739,060	29.84%
	- Rimbursimi i kryer	22,614,542	22,373,640	22,636,000	(262,360)	-1.16%	(240,902)	-1.07%
<b>2</b>	Tatim mbi Fitimin	54,986,282	57,494,691	59,719,000	(2,224,309)	-3.72%	2,508,409	4.56%
<b>3</b>	Të Ardhura Personale	57,999,211	66,746,937	64,439,000	2,307,937	3.58%	8,747,726	15.08%
<b>4</b>	Taksat dhe Tarifa	14,339,846	19,536,403	19,210,294	326,109	1.70%	5,196,557	36.24%
<b>5</b>	Taksa Qarkullimi	19,545,556	21,301,954	23,305,031	(2,003,077)	-8.60%	1,756,399	8.99%
<b>6</b>	Lojrat e Fatit	2,176,798	2,303,120	2,337,725	(34,605)	-1.48%	126,322	5.80%
<b>7</b>	Të tjera							
<b>8</b>	Dënimet Administrative	172,545	238,166	0	238,166		65,621	38.03%
<b>B</b>	Të Ardhurat Tatimore (neto)	<b>195,263,353</b>	<b>227,403,446</b>	<b>224,250,050</b>	<b>3,153,395</b>	<b>1.41%</b>	<b>32,140,093</b>	<b>16.46%</b>
<b>C</b>	Kontributet e Sigurimeve	139,254,918	155,870,816	153,658,000	2,212,816	1.44%	16,615,897	11.93%
<b>D</b>	<b>D.P.TATIMEVE TOTAL (Neto)</b>	<b>334,518,271</b>	<b>383,274,261</b>	<b>377,908,050</b>	<b>5,366,211</b>	<b>1.42%</b>	<b>48,755,990</b>	<b>14.57%</b>

Tabela 2. Të ardhurat e realizuara për vitin 2024 sipas DRT-ve (000 lekë)

	Të ardhura Total Bruto			Të ardhura Tatimore Neto			Sigurime Shoqerore		
	Fakt	Plan	%	Fakt	Plan	%	Fakt	Plan	%
<b>Berat</b>	4,945,710	4,775,000	3.58%	1,510,445	1,417,544	6.55%	3,157,712	3,080,000	2.52%
<b>Dibër</b>	4,971,863	4,820,000	3.15%	2,017,015	2,015,476	0.08%	2,817,837	2,730,000	3.22%
<b>Durrës</b>	23,450,934	22,790,000	2.90%	8,327,282	8,038,757	3.59%	13,140,060	13,050,000	0.69%
<b>Elbasan</b>	10,201,140	9,898,000	3.06%	3,477,900	3,151,361	10.36%	6,275,320	6,250,000	0.41%
<b>Fier</b>	12,344,496	12,075,000	2.23%	4,194,379	3,835,290	9.36%	7,288,045	7,300,000	-0.16%
<b>Gjirokastrë</b>	3,977,797	3,738,000	6.42%	1,358,214	1,225,648	10.82%	2,486,351	2,400,000	3.60%
<b>Korçë</b>	8,136,175	7,837,000	3.82%	2,770,524	2,517,493	10.05%	5,129,595	5,050,000	1.58%
<b>Kukës</b>	3,016,973	2,794,600	7.96%	958,254	793,179	20.81%	1,838,866	1,760,000	4.48%
<b>Lezhë</b>	5,271,531	5,068,500	4.01%	1,724,741	1,596,201	8.05%	3,374,412	3,310,000	1.95%
<b>Sarandë</b>	3,546,509	3,184,800	11.36%	1,402,016	1,207,006	16.16%	1,928,168	1,780,000	8.32%
<b>Shkodër</b>	8,809,266	8,608,000	2.34%	2,828,315	2,605,539	8.55%	5,706,179	5,700,000	0.11%
<b>Tiranë</b>	154,817,677	153,669,031	0.75%	89,609,626	90,548,571	-1.04%	61,132,650	60,098,000	1.72%
<b>DTM</b>	153,565,100	152,892,118	0.44%	104,053,405	102,223,090	1.79%	36,592,740	36,200,000	1.08%
<b>Vlorë</b>	8,592,730	8,394,000	2.37%	3,171,328	3,074,894	3.14%	5,002,881	4,950,000	1.07%
<b>Total</b>	<b>405,647,901</b>	<b>400,544,049</b>	<b>1.27%</b>	<b>227,406,113</b>	<b>224,250,050</b>	<b>1.41%</b>	<b>155,870,816</b>	<b>153,658,000</b>	<b>1.44%</b>

Tabela 3. Të ardhura nga Tatimi mbi Vlerën e Shtuar (000 lekë)

	Fakti TVSH		Plan TVSH		Ndryshimi %	
	neto	bruto	neto	bruto	neto	bruto
Berat	421,925	699,478	402,544	680,000	4.81%	2.86%
Dibër	711,239	848,250	785,476	860,000	-9.45%	-1.37%
Durrës	2,073,613	4,057,206	2,028,757	3,730,000	2.21%	8.77%
Elbasan	1,022,833	1,470,753	878,361	1,375,000	16.45%	6.96%
Fier	1,398,010	2,260,082	1,160,290	2,100,000	20.49%	7.62%
Gjirokastrë	440,353	573,585	387,648	500,000	13.60%	14.72%
Korçë	930,742	1,166,799	830,493	1,100,000	12.07%	6.07%
Kukës	171,611	391,462	158,579	400,000	8.22%	-2.13%
Lezhë	565,938	738,316	512,701	675,000	10.38%	9.38%
Sarandë	456,471	672,795	422,206	620,000	8.12%	8.52%
Shkodër	765,356	1,040,128	617,539	920,000	23.94%	13.06%
Tiranë	22,193,236	26,268,637	21,952,539	24,975,000	1.10%	5.18%
DTM	27,663,456	40,582,411	24,050,971	38,520,000	15.02%	5.35%
Vlorë	967,391	1,385,911	1,050,894	1,420,000	-7.95%	-2.40%
<b>Totali</b>	<b>59,782,174</b>	<b>82,155,813</b>	<b>55,239,000</b>	<b>77,875,000</b>	<b>8.22%</b>	<b>5.5%</b>

Tabela 4. Te ardhura nga Tatimi mbi Fitimin (000 lekë)

Tatimi mbi fitimin			
	Fakt	Plan	%
Berat	384,431	370,000	3.90%
Dibër	487,734	570,000	-14.43%
Durrës	2,922,443	2,960,000	-1.27%
Elbasan	904,071	840,000	7.63%
Fier	1,118,370	1,100,000	1.67%
Gjirokastër	261,764	260,000	0.68%
Korçë	628,846	580,000	8.42%
Kukës	306,620	240,000	27.76%
Lezhë	413,215	440,000	-6.09%
Sarandë	550,164	460,000	19.60%
Shkodër	681,065	750,000	-9.19%
Tiranë	12,579,360	12,850,000	-2.11%
DTM	35,328,209	37,409,000	-5.56%
Vlorë	928,400	890,000	4.31%
<b>Totali</b>	<b>57,494,691</b>	<b>59,719,000</b>	<b>-3.72%</b>

Tabela 5. Të ardhura nga Tatimi mbi të Ardhurat Personale (000 lekë)

	Fakt	Plan	%
Berat	663,022	600,000	10.50%
Dibër	694,203	600,000	15.70%
Durrës	3,143,991	2,950,000	6.58%
Elbasan	1,492,561	1,380,000	8.16%
Fier	1,619,280	1,530,000	5.84%
Gjirokastër	624,132	550,000	13.48%
Korçë	1,165,513	1,070,000	8.93%
Kukës	464,631	390,000	19.14%
Lezhë	701,196	625,000	12.19%
Sarandë	373,483	310,000	20.48%
Shkodër	1,339,873	1,200,000	11.66%
Tiranë	23,578,920	22,644,000	4.13%
DTM	29,670,440	29,500,000	0.58%
Vlorë	1,215,691	1,090,000	11.53%
<b>Totali</b>	<b>66,746,937</b>	<b>64,439,000</b>	<b>3.58%</b>

Tabela 6. Krahasimi TAP sipas zërave (000 lekë)

		FAKT	FAKT	Diferenca 2024-2023	
		2023	2024	+ ose -	Perqindje
	<b>Tatimi mbi të ardhurat personale</b>	<b>57,999,211</b>	<b>66,746,937</b>	<b>8,747,726</b>	<b>15.1%</b>
1	Tatimi mbi pagë nga listëpagesa	33,798,919	40,175,924	6,377,004	18.9%
1,1	Nga të punësuarit e Sektorit Publik	12,591,345	15,608,380	3,017,035	24.0%
1,2	Nga të punësuarit e Sektorit Privat	21,207,574	24,567,544	3,359,970	15.8%
2	Tatim mbi të Ardhurat nga Interesat	2,451,942	3,391,086	939,144	38.3%
3	Tatim mbi të Ardhurat nga Qiratë	4,847,144	5,347,609	500,465	10.3%
4	Tatim mbi Fituesit e Lodrave të Fatit	63,744	110,797	47,053	73.8%
5	Tatim mbi A.Personale Biznesi Vogel me xhiro 2-8 mln lekë	2,465	1,994	(470)	-19.1%
6	Të tjera Tatime mbi të Ardhurat në Burim	3,683,605	3,803,068	119,463	3.2%
7	Tatimi mbi të ardhurat nga Dividentët dhe Aksionet	5,877,343	5,774,686	(102,657)	-1.7%
8	Tatim mbi të Drejtën e Autorit dhe Pronësisë Intelektuale	305,387	357,535	52,148	17.1%
9	Tatimi mbi Deklaratën Individuale Vjetore të të ardhurave	1,434,219	1,781,733	347,513	24.2%
10	Tatim, shitja e pasurisë së paluajtshme	5,450,045	5,534,659	84,615	1.6%
11	Tatim, trashëgimia dhe dhurimi	84,399	35,789	(48,610)	-57.6%
12	Tatim mbi të Ardhurat nga Interesat e tjera				
13	Tatim mbi të Ardhurat nga Honorare				
14	Tatim mbi të Ardhurat për pjesmarrje në borde drejtuese dhe keshilla ose trupa drejtuese të tjerë				
15	Tatim mbi të Ardhurat për Prime sigurimi				
16	Tatim mbi të Ardhurat për performancën e aktorëve, muzikantëve ose sportistëve				
17	Tatim mbi të Ardhurat për shërbime teknike				
18	Tatim mbi të Ardhurat për ndërtime, instalime, montime ose punë				
19	Tatim mbi të ardhurat personale Biznesore		432,058	432,058	

Tabela 7. Të ardhura nga Taksat Kombëtare dhe Tarifa (000 lekë)

	Fakt	Plan	%
Berat	37,555	45,000	-16.54%
Dibër	119,699	60,000	99.50%
Durrës	157,187	100,000	57.19%
Elbasan	49,758	53,000	-6.12%
Fier	36,386	45,000	-19.14%
Gjirokastër	23,753	28,000	-15.17%
Korçë	32,974	37,000	-10.88%
Kukës	11,714	4,600	154.64%
Lezhë	36,307	18,500	96.26%
Sarandë	12,587	14,800	-14.95%
Shkodër	30,863	38,000	-18.78%
Tiranë	9,020,716	9,017,000	0.04%

DTM	9,929,688	9,705,394	2.31%
Vlorë	37,215	44,000	-15.42%
<b>Totali</b>	<b>19,536,403</b>	<b>19,210,294</b>	<b>1.70%</b>

Tabela 8. Taksat Kombëtare dhe Tarifat sipas llojeve (përfshirë Tarifa Buxhetore)

Struk.	Lloji i të Ardhurave	FAKTET		Diferenca FAKT 24-23	
		2023	2024	+ ose -	Perandrie
A=B+C	TAKSAT dhe TARIFA NACIONALE	<b>14,339,846</b>	<b>19,536,403</b>	<b>5,196,557</b>	<b>36.2%</b>
B	Tarifa Kombëtare	787,840	706,040	(81,800)	-10.4%
C	Taksa Kombëtare	13,552,006	18,830,363	5,278,357	38.9%
1	8.Tarifë shërbimi për Qarkullimin e Automjeteve	83,595	74,774	(8,822)	-10.6%
2	12.Tarifë për regjistrimin e Lojrave të Fatit ,	153,642	154,251	609	0.4%
3	5. Tarifë shërbimi për licencat radiotelevizive	7,711	19,739	12,028	156.0%
4	2. Tarifë shërbimi për përdorimin e aparateve	1,283,347	1,326,126	42,779	3.3%
5	6. Tarifë shërbimi për shërbimet e radiokomunikacionit	455,828	460,447	4,619	1.0%
6	Taksë nacionale për lejen e ushtrimit të veprimtarisë së peshkimit	20,823	19,908	(915)	-4.4%
7	Taksë nacionale e karbonit për benzinën, benzolin dhe gazolin	2,476,959	2,943,622	466,663	18.8%
8	Taksë nacionale për ambalazhet plastike të lëngjeve të ambalazuara (shishe, bidona etj)	2,046,755	2,345,182	298,427	14.6%
9	Taksë mbi të drejtën e përdorimit të truallit shtetëror nga persona juridik tregtarë dhe ndërmarje shtetërore	1,557	980	(577)	-37.1%
10	Taksë mbi Primet e shkruara	1,708,575	2,019,977	311,402	0.0%
11	Taksa për regjistrim fillestar për automjete luksoze	186,998	236,208	49,210	0.0%
12	Taksa e përvitshme për automjetet luksoze	290,806	328,398	37,592	0.0%
13	Taksë për automjetet e përdorura të transportit	5,869,654	6,491,200	621,545	10.6%
14	9.Tarifë shërbimi për kalimin e kufirit me avion	355,369	498,793	143,424	40.4%
15	Taksa portuale	739	920	180	24.4%
16	Taksa e Akteve dhe e Pullës	97,117	64,202	(32,914)	-33.9%
17	Taksa e rentës minerare	850,528	1,108,300	257,773	30.3%
18	3 .Tarifë për Shërbimet Konsullore	285,488	216,887	(68,600)	-24.0%
19	1.Tarifë Për paisjen me Dëshmi Aftësie për Drejtim	405,787	296,304	(109,483)	-27.0%
20	13. Tarifë për Regjistrim në arsimin e Lartë	143,547	219	(143,328)	-99.8%
21	7. Tarifa për pasaportë lundrimi të personave	1,656	1,415	(242)	-14.6%
22	4. Tarifa për aktet administrative	396,065	453,830	57,765	14.6%
23	Taksa e rentës për Hidrokarbure	85	113	28	32.7%
24	Taksa e Qumështit Pluhur	0	219,301	219,301	#DIV/0!
25	Taksa e pijeve të Homogjenizuara	0	12,156	12,156	#DIV/0!
26	Taksa e Hurrës së Qumështit	0	52,789	52,789	#DIV/0!
27	Taksa e Krem Qumështit	0	37,573	37,573	#DIV/0!
28	Taksa e lëndës djegëse e përdorur si karburant për mjete lundruese për qëllime turistike dhe argëtimi jashtë territorit të Shqipërisë	0	2,947,622	2,947,622	#DIV/0!
29	Tarifë , gjoba, interesa	1,624	1,812	188	11.6%
30	Taksa të tjera, gjoba, interesa	1,411	1,914	503	35.7%

D	Taksa e qarkullimit	19,545,556	21,301,954	1,756,399	9.0%
---	---------------------	------------	------------	-----------	------

Tabela 9. Të ardhura nga Taksa e Qarkullimit Rrugor (000 leke)

	2023	2024	Plan 2024	Fakt vs Plan	2023vs2022%
Berat					
Dibër					
Durrës					
Elbasan					
Fier					
Gjirokastër					
Korçë					
Kukës					
Lezhë					
Sarandë					
Shkodër					
Tiranë	19,545,556	21,301,954	23,305,031	-8.60%	8.99%
DTM					
Vlorë					
<b>Totali</b>	<b>19,545,556</b>	<b>21,301,954</b>	<b>23,305,031</b>	<b>-8.6%</b>	<b>8.99%</b>

Tabela 10. Të ardhurat nga sigurimet shoqërore & shëndetësore

	2023	2024	Plan 2024	Fakt vs Plan	2024vs2023%
Berat	2,983,839	3,157,712	3,080,000	2.52%	5.83%
Dibër	2,465,918	2,817,837	2,730,000	3.22%	14.27%
Durrës	12,240,826	13,140,060	13,050,000	0.69%	7.35%
Elbasan	5,674,316	6,275,320	6,250,000	0.41%	10.59%
Fier	6,555,637	7,288,045	7,300,000	-0.16%	11.17%
Gjirokastër	2,233,900	2,486,351	2,400,000	3.60%	11.30%
Korçë	4,603,488	5,129,595	5,050,000	1.58%	11.43%
Kukës	1,649,335	1,838,866	1,760,000	4.48%	11.49%
Lezhë	3,071,556	3,374,412	3,310,000	1.95%	9.86%
Sarandë	1,640,873	1,928,168	1,780,000	8.32%	17.51%
Shkodër	5,144,797	5,706,179	5,700,000	0.11%	10.91%
Tiranë	53,698,269	61,132,650	60,098,000	1.72%	13.84%
DTM	32,789,956	36,592,740	36,200,000	1.08%	11.60%
Vlorë	4,502,207	5,002,881	4,950,000	1.07%	11.12%
<b>Totali</b>	<b>139,254,918</b>	<b>155,870,816</b>	<b>153,658,000</b>	<b>1.44%</b>	<b>11.93%</b>

Në kuadër të përmirësimit të parashikimeve të flukseve monetare të qeverisjes së përgjithshme, për një menaxhim me efektivitet dhe me kosto të ulët të mjeteve monetare të qeverisë, Drejtoria e Kontabilitetit dhe Statistikës, Sektori i Statistikës dhe Analizës, pranë DPT është pjesë e grupit të punës me Ministrinë e Financave (shkresa MF nr.9968/1 Prot, dt.17.07.2024, protokolluar me tonën nr.12988 Prot, dt.18.07.2024).

Në vitin 2024, ka dërguar informacion mbi fluksin ditor të të ardhurave tatimore për vitet 2021, 2022, 2023 dhe 2024.

### Sektori i Kontabilitetit dhe Pagesës

Sektori i Kontabilitetit dhe Pagesës monitoron funksionimin e sistemit të pagesave të detyrimeve tatimore dhe kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, me qëllim lehtësimin e procedurave të pagesës nga tatimpaguesit, lehtësimin e punës me bankat e nivelit të dytë për përgatitjen e informacionit në lidhje me këto pagesa dhe përmirësimin e përpunimit të të dhënave të pagesave për qëllime të administratës tatimore.

Sektori i Kontabilitetit dhe Pagesës, në përputhje me Objektivin e Planit Strategjik “Garantimi i asistencës për përmbushjen vullnetare” – duke ofruar shërbime cilësore dhe duke ndikuar në reduktimin e barrës administrative në pagesën e detyrimeve tatimore dhe kontributeve shoqërore, ka mundësuar arritjen e rezultateve si më poshtë:



1. Raportimin në kohë sa më të shpejtë të pagesave të arkëtuara në buxhetin e shtetit pranë Drejtorisë së Kontabilitetit dhe Analizës, si dhe strukturave drejtuese në DPT.
2. Identifikimin e pagesave pezull dhe sistemimin e tyre në llogarinë e duhur të tatimpaguesit.

Gjatë vitit 2024, ky sektor ka ndjekur, përgatitur dhe raportuar në kohë dhe me saktësi informacionin mbi pagesat e kryera në bankat e nivelit të dytë dhe në thesar lidhur me të ardhurat tatimore dhe kontributet e detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore. Puna e kësaj drejtorie gjatë vitit 2024 është fokusuar në:

- Marrjen dhe krahasimin e ekstraktit bankar me të dhënat e ardhura elektronikisht nga sistemi i thesarit.
- Komunikimin me Drejtorinë e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit në funksion të mirëvajtjes së punës dhe saktësisë së informacionit. Numri i komunikimeve elektronike për

zgjidhjen e problematikave te konstatuara gjate vitit 2024 ka qene rreth 32 dhe 39 komunikime per mosrakordimin e raporteve te pagesave ne Drejtorine e Informacionit DPT prane AKSH-it.

- Sistemimin e pagesave pezull në bazë të Akt-Marrëveshjes mes Ministrisë së Financave dhe bankave të nivelit të dytë, duke komunikuar në mënyrë permanente me bankat e nivelit të dytë dhe me tatimpaguesit. Më saktësisht, janë sistemuar 2 142 raste për vitin 2024. Me poshte paraqiten me grafik keto sistemime sipas muajve dhe sipas bankave.



Përgatitjen e raporteve ditore, mujore dhe progresive të të ardhurave të tatimore dhe kontributeve te detyrueshme te sigurimeve shoqerore dhe shendetesore per Drejtorine e Pergjithshme te Tatimeve dhe per cdo drejtori rajonale tatimore pas rakordimit të të ardhurave me bankat e nivelit të dytë dhe degën e thesarit si dhe vënia e këtyre raporteve në dispozicion te Drejtorise se Kontabilitetit dhe Analizes dhe strukturave drejtuese ne Drejtorine e Pergjithshme te Tatimeve. Gjate vitit 2024 jane kryer 52 komunikime elektronike me bankat e nivelit te dyte dhe me tatimpaguesit per problematika te ndryshme.

- Komunikimin e vazhdueshem me bankat e nivelit të dytë në zbatim të Akt- Marrëveshjes për të gjitha sqarimet për rastet e sistemimeve të pagesave që nuk mund të identifikohen nga

administratë tatimore apo të ndonjë problemi të lindur gjatë zbatimit të kësaj akt marrëveshje me bankat e nivelit të dytë.

### III. SHËRBIMI I TATIMPAGUESVE

Gjatë vitit 2024, puna e Drejtorisë së Shërbimit të Tatimpaguesve, është përqendruar në konsolidimin, rritjen e nivelit dhe lehtësimin e shërbimit ndaj tatimpaguesve. Kjo është arritur duke ndjekur realizimin e detyrave dhe objektivave të përcaktuara, në Planin Operacional të vitit 2024, detyrave të ngarkuara në funksion të reformave të DPT-së, si dhe ndjekjen e realizimit të procedurave të përcaktuara në Manualin e Shërbimit ndaj tatimpaguesve.

Drejtoria e Shërbimit për Tatimpaguesit është përgjegjëse, për sigurimin e ofrimit të shërbimit cilësor dhe asistencës për të gjithë tatimpaguesit kryesisht nepermjet shërbimit dhe komunikimit elektronik, si dhe kontaktet e vazhdueshme me tatimpaguesin nepermjet sistemit Call Center, me qëllim përmbushjen vullnetare të detyrimeve ligjore.

Funksioni Drejtorisë së Shërbimit të Tatimpaguesve është realizuar nëpërmjet veprimtarisë së dy sektorëve të saj: - Sektorit të Asistencës dhe shërbimit të Tatimpaguesit, - dhe Sektorit të thirrjeve.

#### I. Puna e kryer nga Sektori i Asistencës dhe shërbimit ndaj tatimpaguesve

1. Sektori i Asistencës dhe Shërbimit për Tatimpaguesit është pjesë e Drejtorisë së Shërbimit për tatimpaguesit në DPT, dhe si pjesë e rëndësishme e komponentit të shërbimit ndaj tatimpaguesve, për vitin 2024 ka garantuar përmbushjen e funksionit të shërbimit në DPT dhe në DRT, duke orientuar DRT për përmirësimin e shërbimit me metoda elektronike dhe duke shërbyer sipas rastit për tatimpaguesit edhe në sportele. Rëndësi e veçantë është dhënë identifikimit të problemeve por dhe pyetje-përgjigjeve të standartizuara nepermjet komunikimit me Tëp në e-filing, si dhe nepermjet faqes zyrtare të DPT.

Një vlerësim i veçantë është dhënë fokusit në zbatimin e detyrave dhe aktiviteteve për përmbushjen vullnetare të detyrimeve nga ana e tatimpaguesit, bazuar në Planin Operacional 2024 të DPT, të orientuar tek tatimpaguesi, me qëllim përmirësimin e shërbimeve që i ofrohen tatimpaguesve, për reduktimin e barrës administrative në pagesën e detyrimeve tatimore dhe kontributeve shoqërore, dhe objektivave të përcaktuara në funksion të reformave të ndërmarra nga DPT.

Objektivat e këtij Sektori për vitin 2024 ishin:

- Rritja e nivelit të asistencës, informimit dhe ndërgjegjësimin të tatimpaguesve në funksion të përmbushjes vullnetare të detyrimeve të tyre tatimore.

- Përmisimi i shërbimeve të ofruara online nepermjet portalit e-albania, me synim shtimin e shërbimeve online per tatimpaguesit.

Drejtoria e Sherbimit ne DPT per mirefunksionimin e gjithë aktivitetit te Sherbimit gjate vitit 2024 ka komunikuar dhe ka pritur vazhdimisht çdo dite problemet e konstatuara per zgjidhje te derguara nga DRT ne rrethe, dhe ka ndermjetesuar zgjidhjen e tyre nga Pala mirembajtese e sistemit, por dhe ka ndihmuar ne ruajtjen e standarteve te shërbimeve te arritura si dhe permiresimin e shërbimeve aktuale bazuar në kerkesat e tatimpaguesve.

Baza e aritjeve dhe puna konkrete e shërbimit ofrohet pergjithesisht nga DRT ne rrethe. DRT ne çdo muaj raportojne punen e bere nga ana e tyre ne sportele dhe komunikimet nepermjet adresave elektronike te tatimpaguesve, nepermjet evidencave te standartizuara nga DSHT ne DPT.

Sherbimi qe ofrohet çdo dite nga Drejtorite e Sherbimit ne DRT gjate vitit 2024 ka disa tregues performance te arritur te cilet raportohen sipas Planit Strategjik te DPT, aty ku atij i ofrohet shërbimi baze dhe nga ku administrohet dhe Tatimpaguesi. Konkretisht disa tregues te aritur rezultojne si me poshte:

Numri i njoftimeve dërguar tatimpaguesve me qëllim parandalimin e mashtrimit dhe nxitjen e korrektimit vullnetar	84 635
Numri i takimeve të mbajtura me tatimpaguesit me qëllim parandalimin e mashtrimit dhe nxitjen e korrektimit vullnetar	152
Numri total i vizitave këshilluese të përfunduara	224
Numri i seminareve edukues të realizuar	76
Numri total i taksapaguesve i asistuar (ballë për ballë)	108 419

Pra rezulton se gjatë vitit 2024, sportelet e Shërbimit ne DRT kanë pritur rreth 108 419 vizitorë, të cilët janë tatimpagues apo individë, që ju është ofruar shërbim dhe asistencë ne lidhje me kerkesat e tyre për informacion, kryesisht per kuptimin baze dhe ndryshimet e Legjislacionit Tatimor qe ndodhën ne vitin 2023-2024, për kuptimin e përgjegjësive tatimore, pagesen e detyrimeve tatimore, deklarimit elektronik, pajisjes me vertetime nëpërmjet portalit e-albania etj.

Jo vetem qe jane pritur shume tatimpagues per vitin 2024, por dhe jane derguar shume njoftime ne adresat elektronike te tatimpaguesve (rreth 84,635), keto ne disa raste te ideuara dhe nga DPT per fushata te ndryshme, per te nxitur permbushjen vullnetare, pasi jo çdo tatimpagues njoftohet nga Qendra e thirrjeve.

Bazuar te shqetësimet dhe pyetjet qe kane ardhur nga tatimpaguesit, Sherbimi ne DPT, ne bashkepunim me drejtorine Teknike, drejtorine e Informacionit dhe drejtorine e Proceseve te Biznesit, per llojin e tatimit ne burim, hartuan pergjigjet e aplikimit dhe zbatimit ne praktike te ketij lloji tatimi dhe i publikuan ato ne faqen e DPT.

Gjate vitit 2024 jane bere njoftime te here pas hershme ne faqen web per zbatimin e ligjit ne kushte konkrete, apo dhe ne adresen personale e-filing ne kontaktin direkt me tatimpaguesin.

Per permbushjen e funksionit te sherbimit dhe rritjen e tij, DSHT ne DPT bashkepunon ngushte dhe vazhdimisht me drejtori te tjera ne DPT, si Drejtorine e Riskut, Drejtorine e Proceseve te Biznesit, Drejtorine e Kontrollit, Drejtorine e Informacionit etj dhe diskuton vazhdimisht me ta, idete per permiresimin e komponentit te sherbimit.

Bazuar te rendesia qe ka rritja e nivelit te sherbimit, fokusi eshte drejtuar dhe perqendruar tek tatimpaguesi, pra si te jemi me prane tij, si ti sherbejme me mire dhe si te zgjidhim kerkesat e tij, dhe nepermjet zhvillimit te teknologjise ne sherbimet online.

Pjese e ketij fokusi gjate 2024 eshte evidentuar dhe ne Permiresimin e Komponentit te Sherbimit te tatimpaguesve, nepermjet asistences dhe ndihmen e Projektit Suedes, ku diskutimet jane perqendruar ne;

- Komunikimin me tatimpaguesit nepermjet gjuhes se thjeshte dhe te kuptueshme,
- Ne permiresimin e permbyshjes vullnetare te ligjit nga tatimpaguesit, duke ideuar standarte ne sherbimet online,
- Ne kryerjen e Anketave me bizneset per te matur nivelin e sherbimit dhe identifikuar problemet,
- Permiresimin dhe modernizimin e sherbimit nepermjet Qendres se thirjeve

Per te gjitha keto ka patur ecuri positive jane identifikuar nevojat , dhe po punohet dhe sot ne vijim ne 2025 per te aritur ne nje nivel me te larte.

2- Shërbimi për tatimpaguesit është orientuar drejt përmirësimit të shërbimeve dhe rritjes së cilësisë së tyre. Aktualisht nëpërmjet platformës Qeveritare E-Albania ofrohen ndaj tatimpaguesve 31 Shërbime online. Ndër këto 18 janë shërbime të mirëfillta si vërtetime dhe dokumenta për tatimpaguesit dhe individët.

**Përshkrimi i vërtetimeve të lëshuara nga funksioni i shërbimit dhe online nepermjet portalit e-albania**

Tabela 1. Vertetime të lëshuara/miratuara në sportelet e shërbimit 2024

Vertetime per individe qe nuk kane aktivitet privat , (aplikimi behet ne e-albania dhe miratimi i tyre dhe dergimi ne portalin e-albania behet nga DRT perkatese) etj.	60,208
Ndryshimi I Paswordit dhe dergimi ne adresen personale (Reset Password )	1,310
kerkesa te refuzuara mbas verifikimeve te aplikimeve te ardhura nga e-albania	2,713
<b>Totali</b>	<b>64,231</b>

Theksojme se Vertetimet per individe te paregjistruar aplikimi behet ne e-albania, dhe ky aplikim dergohet ne DRT perkatese duke u hapur nje çeshtje e cila pasi menaxhohet e verifikohet behet miratimi i saj, mbyllet si çeshtje dhe dergohet. Per vitin 2024 jane hapur 62, 921 çeshtje per vertetime t ardhura nga e-albania , kerkesa per individe te paregjistruar, nga te cilat jane refuzuar 2,713 prej tyre (62,921-2,713 =60,208).

Bazuar funksionimit normal te leshimit te vertetimeve ne menyre elektronike, ne DRT perkatese rralle here leshohen vertetime ne menyre manuale dhe kjo vetem ne rastet kur shfaqja e detyrimeve te paguara ne portalin e-albania vonon per 2-3 dite.

Tabela 2. Vërtetime te leshuara online nga portali e-Albania 2024

<b>Nr</b>	<b>Emërtimi i shërbimit</b>	<b>Janar - Dhjetor 2024</b>
1	Vërtetim për pagimin e kontributeve për individin	1,793,315
2	Vërtetim për pagimin e kontributeve nga subjekti	149,442
3	Vërtetim për përgjegjësitë tatimore	40,426
4	Deklarimi dhe pagesa e kontributeve nga punëdhënësit (verifikime nga punemarresi)	350,161
5	Vërtetim për regjistrim të investitorit	918
6	Vërtetim për pagim detyrimesh	280,409
7	Vërtetim statusi (aktiv, pasiv përfshirë datën)	62,004
8	Vërtetim xhiro për 3 vitet e fundit	158,785
9	Vërtetim për posedim mjete	4,648
10	Vërtetim për individ të paregjistruar	60,208
11	Tatim mbi të ardhurat personale të biznesit të vogël	0
12	Tatim fitimi	0
13	Tatim i mbajtur në burim	0
14	Tatim i thjeshtuar mbi fitimin	0
15	Tatim mbi vlerën e shtuar	0
16	Kontributet e sigurimeve shoqërore dhe	0

	shëndetësore	
17	Tarifat kombëtare	0
18	Tatim mbi të ardhurat nga punësimi	0
19	Taksat kombëtare	0
20	Renta minerare	0
21	Tatim mbi të ardhurat personale	0
22	Detyrime globale	0
23	Tatim i lojrave të fatit	0
24	Listëpagesa e kontributeve të sigurimeve shoqërore, shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat nga punësimi (eSig25)	57,560
25	Certifikatë Rezidence Tatimore ( biznes )	2,251
26	Vërtetim për aktivitet ekonomik të hapur	1,859
27	Rivendosje fjalëkalimi për tatimpagues të regjistruar	422
28	Aplikim për certifikatë rezidence për individët	351
29	Kërkesë për regjistrimin e një subjekti tatimpagues	10,410
30	Njoftim i ndryshimeve në regjistrim	14,112
31	Vërtetim page	1,234,497
	<b>Total</b>	<b>4,221,778</b>

Nga te dhenat rezulton se ne vitin 2024, jane leshuar **4,221,778** vertetime, ndersa ne viin 2023 jane leshuar 1,967,843 vertetime. Ndikimin me te madh ne rritjen e numrit te vertetimeve online per vitin 2024 e ka –Vertetimi per pagimin e kontributeve per individin- qe ka arritur shifren **1,793,315** vertetimeve , (nga 97,470 vetretimeve qe jane leshuar per 2023), te cilat kane permbushur me se miri dhe kerkesat e individeve.

Sqarojme se per vitin 2024 , mbas hakerimit te faqes e-albania ne vitin 2023 , nga tatimpaguesit nuk eshte perdorur pagesa e detyrimeve tatimore nga e-albania, por pavaresisht nga kjo sherbimet e tjera kane funksionuar normalisht dhe me nje ritje ne numer.

### **3- Informimi, sqarimi dhe ndërgjegjësimi i tatimpaguesve:**

Pervec vertetimeve qe jane leshuar ne funksion te sherbimit ndaj tatimpaguesit, gjate vitit 2024, nga DRT perkatese jane pritur nga e-filing dhe hapur si çështje rreth 72,127 pyetje te pergjithshme te cilat kane informuar dhe sqaruar Tatimpaguesit jo vetem per ligjin dhe ndryshimet perkatese te tij apo zbatimin ne kushtet konkrete, por kane plotesuar dhe kerkesat per sqarime lidhur me bllokimin dhe zhblokimin e llogarive bankare por dhe te kerkesave per sistemimin e detyrimeve ne llogarine personale te Tatimpaguesve.

Bazuar punes se bere gjate vitit 2024, por dhe nisur sa eshte konstatuar dhe evidentuar nga anketa e kryer nga Projekti Suedes ne 2023, rezulton se niveli I sherbimit ndaj tatimpaguesit ka arritje te theksuara, sidomos ne sherbimet dixhitale qe ofrohen ne menyre elektronike nga Administrata tatimore.

Pavaresisht punes se bere ne vitin 2024, per

- *komunikimin për informimin e Tatimpaguesve në lidhje me Ligjin e ri për “Tatimin mbi të Ardhurat”*
- *Përditësimi periodik i legjislacionit tatimor të publikuar ne faqen e internetit.*
- *Sqarimeve ne faqen zyrtare dhe Vizita informuese tek tatimpaguesit e rinj;*
- *Numrin e madh te tatimpaguesve të asistuar (ballë për ballë),*
- *Numrin e madh te tatimpaguesve te sqaruar nepermjet e-filing,*
- *Komunikimeve dhe asistences nepermjet Call Center,*


perseri jo vetem qe do te punojme ne keto drejtime por do te perqendrohemi me shume ne zgjidhjen e kerkesave te tatimpaguesve nepermjet zhvillimeve ne Sistem.

- 1- Rritjen e komunikimeve me tatimpaguesit debitore, si dhe komunikimeve per ligjin e Tatimit mbi te Ardhurat, per te gjitha nivelet e bizneseve.

## II. Sektori i Thirrjeve dhe struktura organizative

### **Sektori i Thirrjeve ( Call Centër )**

Sektori i Thirrjeve është pjesë e Drejtorisë së Shërbimit të Tatimpaguesve të Administratës Tatimore Qëndrore, miratuar me Urdhrin e Kryeministrit, nr. 69, datë 26.05.2023 “Për miratimin e struktures organizative dhe të numrit të përgjithshem të personelit të Administratës Tatimore Qendrore.



Sektori i Thirrjeve ju ofron tatimpagueseve dhe qytarëve informacion dhe asistencë pa pagesë përmes telefonit në numrin 0800 00 02 për pyetje rreth çështje tatimore si :

- Deklarimit elektronik
- Legjislacionit tatimor
- Çështje të tjera për administratën tatimore (shërbime të Administratës Tatimore ) pagesën e detyrimeve tatimore.

Sektori i Thirrjeve realizon komunikimin me anë të programit ViciDial, për sa i përket zbatimit të legjislacionit tatimor duke inkurajuar tatimpaguesit për rëndësinë e vetëdeklarimit dhe zbatimit vullnetar të legjislacionit tatimor, informimin e kategorisë së tatimpaguesve të cilët figurojnë në sistem që nuk kanë zbatuar legjislacionin tatimor, që duhet të bëjnë deklaratat dhe pagesën e detyrimeve tatimore sipas përcaktimeve ligjore në fuqi.

Qëllimi i komunikimit ndërmjet administratës tatimore dhe tatimpaguesve është harmonizmi i veprimeve organizative me masat edukuese. Komunikimi i përcjellë të tatimpaguesit realizohet në një kohë sa më të shpejtë duke ofruar informacionin e nevojshëm si dhe duke ndërgjegjësuar tatimpaguesit për mënyrën dhe pagesën e detyrimeve tatimore.

### III. Aktivitete të realizuara gjatë vitit 2024

Sektori i Thirrjeve e organizon metodologjinë e punës me anë të programit ViciDial në 2 nëndarje:

- a) Thirrje hyrëse- telefonata hyrëse nga tatimpaguesit në numrin 0 800 000 2.
- b) Thirrje dalëse- telefonata dalëse të realizuara nga specialistët e Sektorit të Thirrjeve.


- Komunikimi nëpërmjet sistemit elektronik të tatimpaguesve :
- ✓ Në vitin 2024 janë realizuar thirrje dalëse 113 954 thirrje , në vitin 2023 janë realizuar 97 120 thirrje dalëse. Pra me 2024 janë realizuar 16,834 thirrje me shume ose 17% me shume se 2023
- ✓ Në vitin 2024 janë realizuar janë realizuar 26,497 thirrje hyrese.
- **Tematika e komunikimeve:**
- **Thirrjet Hyrëse :** Pyetjet më të shpeshta të tatimpaguesve dhe qytetareve drejtuar Sektorit të Thirrjeve përgjatë vitit 2024.
  - Kam një apartament dhe dua ta lëshoj me qira ditore me booking. A duhet të regjistrohem për shtimin e përgjegjësisë së tatimit në burim, të plotësoj deklaratën individuale vjetore të të ardhurave apo të regjistrohem si subjekt tregtar dhe të lëshoj fatura?
  - Disponoj një apartament dhe dua t’ia lëshoj një individit me qira. A duhet të bëj kërkesë për shtimin e përgjegjësisë së tatimit në burim apo duhet të plotësoj deklaratën individuale vjetore të të ardhurave?
  - Unë pretendoj që nuk kam detyrim ligjor për të bërë deklaratën individuale të të ardhurave për vitin 2023. Ku mund ta ankimoj njoftimin e ardhur?
  - Lidhur me vendimin e Gjykatës Kushtetuese që shfuqizon pjesërisht ligjin e ri të tatimit mbi të ardhurat, a do të bëhet automatikisht rimbursimi i kësteve të parapagimit, apo duhet të bëj ndonjë kërkesë që të bëhet i mundur rimbursimi i kësteve të parapagimit?
  - Unë dua të plotësoj deklaratën individuale vjetore të të ardhurave. Si duhet të veprojmë?
  - Lidhur me njoftimin e administratës tatimore për rimbursimin e kësteve të parapagimit, a i kthehen këto këste tatimpaguesve që kanë kaluar në regjistrin pasiv apo/dhe tatimpaguesve që janë çregjistruar?
  - Lidhur me njoftimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve drejtuar tatimpaguesve për sa i përket detyrimit përditësimit të të dhënave të vendit të ushtrimit të aktivitetit, kur plotësoj të dhënat tek “Detajet e tatimpaguesit”, ju lutem si duhet t’i plotësoj dy kuadratet e afatit “Afati nga” dhe Afati deri në”?
  - Duke plotësuar deklaratën individuale vjetore të të ardhurave për vitin 2023, gabimisht kam krijuar edhe deklaratën vjetore të vitit 2022, 2021 dhe 2020, e sistemi më ka gjeneruar gjobë. A mund të më sqaroni?

- **Thirrjet Dalëse:** Gjatë vitit 2024, janë realizuar komunikime me tematika të ndryshme, duke bashkëpunuar me Drejtoritë në DPT, si Drejtoria e mbledhjes së detyrimeve të papaguara, Drejtoria e menaxhimit të rrishtit, Drejtoria për proceset e biznesit.

**Në mënyrë të përmbledhur thirrjet dalëse të realizuara sipas fushatave të ndryshme janë :**

- ✓ Komunikimeve me tatimpaguesit debitore, të Tvsh-së, Sigurime shoqërore dhe Diva.
- ✓ Komunikim me subjekte për kthimin e pagesave të kësteve të tatimit mbi fitimin për subjektet që ofrojnë shërbime profesionale.
- ✓ Komunikim me subjekte që kanë aktivitet në fushën e turizmit me qarkullim të ulët.
- ✓ Komunikimi për informimin e tatimpaguesve që regjistrohen për herë të parë në Administratën Tatimore, lidhur me detyrimet ligjore për deklarimin dhe pagesën e tatimeve etj.

Thirrjet dalëse në mënyrë grafike sipas fushatave dhe nr të thirrjeve të realizuara paraqiten si më poshtë:



- **Zhvillime dhe prioritete .**

Specialistët e Sektorit të Thirrjeve që mbulojnë thirrjet hyrëse i përgjigjen tatimpaguesit të parë në linjë, sipas listimit të programuar të tatimpaguesve për thirrjet hyrëse, ku nuk është e mundur të kuptohet paraprakisht nëse pyetja lidhet me individë apo kompani, ligjin e tatimit mbi të ardhurat, tatimin mbi vlerën e shtuar, aplikime të ndryshme në e Albania, procedura lidhur me masa shtrënguese etj, e parë në këtë prizëm, një sistemi i ri duhet të kategorizojë pyetjen dhe specialisti i thirrjeve hyrëse përgjigjet sipas profilizimit përkatës brenda për brenda sektorit.

Sistemi aktual i thirrjeve mundëson që 3 specialistët të punojnë në thirrjet hyrëse ,ka raste kur në linjë mund të ketë më shumë se tre telefonata, e kështu sistemi duhet të mundësojë që të shtohet numri i thirrjeve hyrëse ose opsioni call back, me qëllim që tatimpaguesi të marrë asistencën e nevojshme dhe në kohe sa më të shkurtër nga Sektori i Thirrjeve.

▪ **Prioritete për sektorin e thirrjeve (call center )**

Prioritet për përmirësimin e punës së sektorit të thirrjeve (call center ) në të ardhmen është :

- Kryerja e investime në teknologjinë e re, pasi teknologjia aktuale e qendrës së thirrjeve nuk lejon regjistrimin e të dhënave e raportim të avancuar me qëllim monitorimin si dhe vlerësimin e performancës.
- Rivendosija në funksion e Livechat
- Trajnimi i vazhdueshëm i punonjësve në Call Center për ndryshimet e reja ligjore, në mënyrë që të specializohen dhe të përdoret një gjuhë e thjeshtë në komunikimin me tatimpaguesit dhe individë.

## IV. PERFORMANCA TEKNIKO-LIGJORE

### Hyrje

Objekti kryesor i punës së Drejtorisë Teknike Dhe Ligjore siç është përcaktuar edhe në Rregulloren e Administratës Tatimore Qendrore është garantimi dhe zbatimi me paanshmëri i ligjit në mënyrë të tillë që çdo akt administrativ dhe dokument zyrtar që del nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, të jetë i mbështetur në Legjislacionin Tatimor dhe ligjet e tjera të zbatueshme në Republikën e Shqipërisë.

#### 1.1 Detyrat kryesore të Drejtorisë Teknike dhe Ligjore

- Bashkëpunimi dhe koordinimi me drejtoritë në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve dhe me DRT, i procesit për evidentimin dhe nevojën për ndryshime ligjore, si dhe hartimi e dërgimi i propozimeve përkatëse në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë;
- Përgatitja dhe bashkërendimi në formulimin e projekt-vendimeve, urdhrave apo qarkoreve për probleme teknike dhe ligjore të zbatimit të legjislacionit tatimor për t'u miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm;
- Bashkëpunimi në hartimin e projekt-planeve strategjike të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve;
- Bashkërendimi i punës dhe ndjekja e të gjitha proceseve gjyqësore ku administrata tatimore është palë si dhe asistimi me ndihmë juridike i Drejtorive Rajonale në pjesëmarrjen e tyre në proceset gjyqësore;
- Kthimi i përgjigjeve për të gjitha rastet kur kërkohet interpretim ligjor, vetëm ose në bashkëpunim me struktura të tjera të autorizuara;
- Interpretim e procedurave tatimore, TVSH, dhe ligjit për Tatimin mbi të Ardhurat. Angazhimi në dhënie mendimi ligjor dhe teknik për çdo projekt ligj, draft-marrëveshje, apo çështje të tjera të karakterit ligjor\teknik;
- Zbatimi i çdo detyre tjetër, që i ngarkohet me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm.

Në kuadër të realizimit të detyrave të mësipërme, DTL ka synuar t'i përmbahet vizionit për ofrimin e një Administrate Tatimore moderne dhe efikase në shërbim të tatimpaguesve, për të garantuar një nivel të lartë të transparencës dhe modernizimit të shërbimeve në zbatim të legjislacionit tatimor.

## **1.2 Organizimi i Drejtorisë Teknike dhe Ligjore**

Drejtoria Teknike dhe Ligjore pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve sipas strukturës organizative është e organizuar si vijon:

1. Sektori Ligjor (1+7).
1. Sektori Teknik (1+8).

### Objektivat e drejtorise per vitin 2024

#### **Garantimi i asistencës për përmbushjen vullnetare**

- ✓ Ofrimi i shërbimeve cilësore dhe reduktimi i barrës administrative në pagesën e detyrimeve tatimore dhe kontributeve shoqërore;
- ✓ Bashkëpunimi me drejtoritë përkatëse për dhënien e një informacioni të bazuar në ligj, të qartë dhe të kuptueshëm;

#### **Rritja e ndërgjegjësimit publik duke ndihmuar në zhvillimin e kulturës për përmbushje vullnetare më të lartë dhe kuptimin e rolit të Administratës Tatimore në shoqëri**

- ✓ Trajtimi në kohë i çdo njoftimi, sinjali apo propozimi që lidhet me aktivitetin e Administratës tatimore.

#### **Zbatimi i metodologjive dhe praktikave njehsuese**

- ✓ Dhënia e opinioneve për çdo ndryshim ligjor që do të propozohet lidhur me legjislacionin tatimor. Hartimi i propozimeve për ndryshime ligjore të iniciuara nga AT;
- ✓ Hartimi i komentareve përmbledhës të vendimeve teknike, të grupuara sipas natyrës së tyre.
- ✓ Përcjellja periodikisht për publikim i opinioneve që japin qëndrime për zbatimin e legjislacionit tatimor.
- ✓ Përgatita e buletineve informuese lidhur me vendimet e formës së prerë të gjykatave, shoqëruar me një analizë të vendimarrjes së tyre;
- ✓ Marrja e masave për përfaqësimin cilësor në konfliktet gjyqësore, përgatitjen e provave dhe prapësimeve etj.

### **Aplikimi i metodave dhe sistemeve për të menaxhuar një AT moderne**

- ✓ Ofrohet eksperiencia e deritanishme mbi shkëmbimin e informacionit me administratat homologe.
- ✓ Trajtim cilësor e në kohë i problematikave fiskale në lidhje me zbatimin e marrëveshjeve tatimore duke u mbështetur në ligj, për tatimpaguesit dhe administratën tatimore qendrore.

### **Zhvillimi i kapaciteteve dhe motivimi i punonjësve**

- ✓ Ndarja racionale e detyrave brenda Drejtorisë;
- ✓ Vlerësimi objektiv i punonjësve sipas meritës dhe aftësive.

### **Zhvillimi dhe përmirësimi i partneriteteve**

- ✓ Trajtimi me përgjegjshmëri i problematikave lidhur me marrëveshjet ekzistuese; Hartimi i draft-marrëveshjeve sipas nevojave institucionale;
- ✓ Trajtimi dhe dhënia e opinionit për draft-marrëveshjet e propozuara nga institucionet e tjera.

### **Aktivitetet e programuara dhe realizuara gjate vitit 2024 ne funksion te realizimit te objektivave**

Duke pasur parasysh organizimin e strukturës së Drejtorisë Teknike dhe Ligjore raportimi mbi rezultatet dhe veprimtarinë e saj për vitin 2024 do të pasqyrohet në 2 ndarje kryesore sipas sektorëve përkatës, përkatësisht: Sektori Ligjor dhe Sektori Teknik

#### **Sektori Ligjor**

Për periudhën Janar-Dhjetor 2024 ky sektor ka ofruar shërbim ligjor dhe konsulencë e asistencë juridike për Drejtorinë në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, Drejtorinë Rajonale Tatimore, tatimpagues të ndryshëm dhe për institucione të tjera të administratës shtetërore, nëpërmjet:

- Dhënies së opinionit ligjor për çështje dhe problematika të hasura në praktikë, për të cilat është kërkuar mendim nga strukturat në DPT apo Drejtorinë Rajonale Tatimore. Sektori Ligjor ka bashkëpunuar me drejtorinë përkatëse për dhënien e një informacioni të bazuar në ligj, të qartë dhe të kuptueshëm, në mënyrë që të garantohet asistencë teknike dhe ligjore për tatimpaguesin.

- Janë dërguar rreth 20 (njëzetë) opinione ligjore ndaj strukturave të administratës tatimore dhe subjekteve lidhur me çështje specifike të cilat janë analizuar rast pas rasti.
- Janë trajtuar mbi 900 (nëntëqind) shkresa drejtuar strukturave të administratës tatimore, subjekteve apo institucioneve të tjera të administratës shtetërore.
- Janë përgatitur 2 Buletine të Vendimeve Gjyqësore, përkatësisht për periudhat Janar - Qershor 2024 dhe Korrik - Dhjetor 2024.
- Janë hartuar 2 marrëveshje bashkëpunimi të reja si dhe janë draftuar amendimet për dy marrëveshje bashkëpunimi ekzistuese.
- Është draftuar Rregullorja e Administratës Tatimore Qendrore në përputhje me strukturën e re të miratuar.
- Është dhënë kontribut për ndryshimet ligjore në Udhëzimin nr. 11 “Për zbatimin e marrëveshjes për shmangien e tatimit të dyfishtë dhe parandalimin e evazionit fiskal”.
- Janë përcjellë propozimet për ndryshime ligjore pranë Ministrisë së Financave për:
  - ✓ Vendimin nr. 220, dt 12.3.2020 “Për përcaktimin e kategorisë së tatimpaguesve dhe të kriterëve të përdorimit të procedurës së thjeshtuar të fiskalizimit”

Gjithashtu, Sektori Ligjor ka dhënë një sërë komentesh/mendimesh në lidhje me projekt-aktet e përcjella nga institucionet e tjera ku mund të përmendim:

- Projektligjin Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9121, date 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.
- Projektvendimin e ardhur për bashkërendim “Për miratimin e Planit të Veprimit 2024-2026, në zbatim të Strategjisë Ndërsektoriale të Sigurisë në Komunitet 2021-2026”.
- Projekt memorandumit e bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Brendshme, “Për procedurat e bashkëpunimit për identifikimin e rasteve të punës së detyruar dhe trafikimit me qëllim shfrytëzimin për punë”.
- Projekturdhërin “Për ngritjen e komitetit ndërministror për bashkërendimin e mbështetjes së vendit pritës dhe plotësimit të katalogut të kapaciteteve të mbështetjes së vendit pritës”.

## **Proceset gjyqësore**

Specialistët e Sektorit të Çështjeve Ligjore në DPT përfaqësojnë Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve në të gjitha konfliktet gjyqësore ku ajo është palë ndërgjyqëse. Për vitin 2024 specialistët/juristët e Drejtorisë Teknike dhe Ligjore kanë përfaqësuar DPT- në të gjitha konfliktet gjyqësore të deleguara sipas rastit, me palë paditëse ish-punonjës të kontraktuar nga administrata tatimore, bazuar në dispozitat e Kodit të Punës apo nëpunës civilë të konfirmuar.

Janë marrë masat për të garantuar përfaqësimin në çdo proces gjyqësor. DPT është përfaqësuar profesionalisht në 113 çështje të lidhura me marrëdhënien e punës, si më poshtë:

- Në Gjykatat e Rrethit Gjyqësor gjatë vitit 2024 janë gjykuar 24 çështje gjyqësore me palë paditëse punonjës dhe ish-punonjës të kontraktuar me kontratë punësimi nga Administrata Tatimore, për të cilat Gjykatat e Rrethit Gjyqësor kanë dalë me vendim për 12 çështje gjyqësore ndërsa për 12 çështje vijon gjykimi.
- Në Gjykatat Administrative gjatë vitit 2024 janë gjykuar 74 çështje gjyqësore, ku Gjykatat Administrative të Shkallës së Parë kanë dalë me vendim për 32 çështje gjyqësore ndërsa për 42 çështje vijon gjykimi.
- Gjykatat e Apelit kanë dalë me vendim për 15 çështje gjyqësore.

## **Detyra të tjera të realizuara nga Sektori Ligjor**

- ✓ Ka garantuar trajtimin e praktikave për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, konform legjislacionit në fuqi.
- ✓ Janë ndjekur dhe vlerësuar praktikat e ardhura në DPT nga Zyrat e Përmbarimit apo kërkesa individuale për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore dhe ka përgatitur të gjitha praktikat e ardhura për trajtim si dhe përcjelljen për veprime të mëtejshme strukturave kompetente.
- ✓ Gjithashtu, janë trajtuar të gjitha shkresat për Regjistrin Qendror të Llogarive Bankare, ku subjekt raportues i të dhënave janë të gjitha institucionet financiare banka dhe jo banka, të cilat kanë në administrimin e tyre llogari bankare dhe kasete sigurie.
- ✓ Pjesëmarrja në grupe pune të ndryshme të caktuara me urdhër të titullarit si:

- Komisioni i inventarizimit për vlerat materiale në ngarkim të punonjësve të DPT-së dhe magazinave të saj.
- Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave
- Komisionit të Ekspertizës
- Hartimi/dizenjimi i formatit të dokumentit identifikues (badge) për punonjësit e Administratës Tatimore
- Zbatimi i procedurave të raportimit për çdo vend (country by country reporting) në kuadër të planit të masave të OECD
- Përgatitja e akteve rregullatore lidhur me raportimin për çdo vend në kuadër të masës 13 të projektit ndërkombëtar BEPS.
- Dy specialiste të Sektorit Ligjor janë anëtare të Komisionit të çertifikimit të prodhuesve dhe mirëmbajtësve të zgjidhjeve Softwarike.
- Shpërndarja për zbatim pranë strukturave kompetente e masave shtrënguese ndërkombëtare në përputhje me rezolutat përkatëse të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara të njoftuara nga Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme.

Gjithashtu specialistët e Sektorit Ligjor kanë marrë pjesë në një sërë grupesh pune në kuadër të përafrimit të legjislacionit si:

- Kapitulli 20 “Ndërmarrjet dhe Politikat Industriale”
- Kapitulli 18 “Statistikat”
- Kapitulli 23 “Gjyqësori dhe të drejtat themelore”

#### Sektori Teknik

Sektori Teknik ka trajtuar kërkesat e ardhura nga tatimpaguesit në lidhje me çështjet e parashtruara prej tyre mbi interpretimin e ligjeve tatimore në kuadër të zbatimit me efektivitet të legjislacionit fiskal. Gjithashtu Sektori Teknik ka trajtuar një numër të konsiderueshëm çështjesh të ardhura për sqarime teknike dhe ligjore të përcjella nga Drejtoritë Rajonale Tatimore apo nga Drejtoritë në DPT.

Konkretisht Sektori TVSH-së ka trajtuar 218 shkresa, duke siguruar një informacion të plotë, të kuptueshëm të përcjellë në kohë dhe të aksesueshëm në lidhje me përmbushjen tatimore duke ruajtur dhe garantuar konfidencialitetin e të dhënave të subjekteve tatimpaguese.

- Sektori Teknik ka përgatitur dhe përcjellë zyrtarisht në Ministrinë e Financave propozimet për ndryshime/shtesa tek Udhëzimi nr. 26, i Ministrit të Financave, “Për Tatimin mbi të Ardhurat”.
- Janë përgatitur dhe janë përcjellë propozime për ndryshime në Udhëzimin nr. 6, datë 30.01.2015 “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë”.
- Gjithashtu, është përgatitur dhe i është përcjellë Ministrisë së Financave “Projekt udhëzim për një shtesë në Udhëzimin nr. 26, datë 04.09.2008 “*Për Taksat Kombëtare*”, i ndryshuar.

Gjithashtu, Sektori Teknik ka dhënë një sërë komentesh/mendimesh në lidhje me projekt-aktet e përcjella nga institucionet e tjera ku mund të përmendim:

- Projektvendimin “Për miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Konfederatës Zvicerane, përfaqësuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) e Departamentit Federal Zviceran të Punëve të Jashtme, duke vepruar nëpërmjet Ambasadës Zvicerane në Shqipëri, në mbështetje për gadishmërinë dhe reagimin e shërbimit emergjent shëndetësor, faza kryesore, një program dypalësh bashkëpunimi dhe zhvillimi”;
- Projektvendim “Për një ndryshim në vendimin nr.1140, datë 24.12.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e strategjisë kundër krimit të organizuar dhe krimeve të rënda 2021–2025 dhe planin e veprimit 2023–2025”, të ndryshuar”;
- Projektvendim “Për miratimin në parim të Vendimit të Komitetit të Përbashkët të Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë së Evropës Qendrore “Për lehtësimin e tregtisë së shërbimeve të ofruara nga agjencitë e udhëtimit dhe operatorët turistikë”;
- Projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime” në ligjin nr. 79/2021 “Për të huajt”;
- Projektvendim “Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për lidhjen e marrëveshjeve të veçanta të bashkëpunimit midis subjekteve publike shqiptare dhe subjekteve publike dhe/ose private të Emirateve të Bashkuara Arabe, në fusha, projekte dhe programe konkrete”;
- Projektligj “Për përgjegjësitë e Zgjeruara të Prodhuesit”;

- Projektvendim “Për llojet e licencave/certifikatave dhe autorizimeve, dokumentacioni i aplikimit, formatet e kërkesave të aplikimeve, si dhe formatet e licencave, autorizimeve dhe certifikatave, për transferimet ndërkombetare për mallrat ushtarake dhe artikujt e teknogjitë me përdorim të dyfishtë, që lëshohen nga Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve”;
- Projektligj “Për krijimin e zyrës së rikuperimit të aseteve”;
- Projektvendimin, “Për përbërjen, mënyrën e organizimit dhe funksionimit, si dhe detyrat e Komitetit për të dhënat statistikore në turizëm”;
- Draft vendimit "Për përcaktimin e procedurës së krijimit të regjistrit elektronik, bazë të dhënash shtetërore, kriteret, mënyra dhe dokumentacioni për kërkesën për ID digjitale të rezidentit elektronik, përfshirë përpunimin, vlerësimin dhe miratimin e kërkesave”;
- Akt normativ Për një shtesë në ligjin nr. 29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar;
- Projekt Vendim i Këshillit të Ministrave “Per përcaktimin e periudhës së shfrytëzimit dhe nivelin minimal të kapacitetit të shfrytëzimit të strukturave akomoduese”.

## **II. Çertifikatat e Rezidencës.**

Çertifikata e Rezidencës shërben për të vërtetuar se tatimpaguesi plotëson kushtet e përcaktuara në legjislacionin tatimor për tu konsideruar rezident tatimor në Shqipëri, pra edhe detyrimin për të deklaruar në Shqipëri të ardhurat në shkallë botërore, të realizuara në Shqipëri dhe jashtë saj. Kjo certifikatë i shërben tatimpaguesit për ta paraqitur tek autoritetet e shtetit tjetër kontraktues, në zbatim të Marrëveshjeve të Taksimit të Dyfishtë përkatëse apo qoftë edhe legjislacionit të brendshëm në atë shtet tjetër.

Spektori Teknik për vitin 2024 ka trajtuar rreth 710 kërkesa për Lëshimin e çertifikatës së rezidencës, të adresuara nga individë, rezidentë në Republikën e Shqipërisë.

## **III. Angazhime të inspektorëve në grupe pune të ngritura në zbatim të akteve ligjore dhe Urdhërave të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve.**

Pjesëmarrja në grupe pune të ndryshme të caktuara me urdhër të titullarit si:

- Grupi i punës për hartimin e vendimit teknik për kryerjen e vlerësimeve tatimore për tatimpaguesit që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në ndërtimin dhe shitjen e banesave;
- Grupi i punës për ndjekjen e implementimin e ndryshimeve ligjore në kuadër të përmirësimit të sistemit e-Taxation;
- Grupi i punës për përgatitjen e draft Strategjisë Kombëtare, për mbrojtjen e interesave financiare të Bashkimit Evropian;
- Angazhimi në Njësinë e Prokurimeve për procedurat e prokurimeve të zhvilluara nga institucioni;
- Grupe pune në kuadër të përafrimit të legjislacionit:
  - Kapitulli 16 (Tatimet),
  - Kapitulli 24 (Drejtësia, Liria dhe Siguria),
  - Kapitulli 33 (Dispozitat Buxhetore dhe Financiare) si dhe Komiteti i Sigurisë së Informacionit.
- Grup pune "Për hartimin e Strategjisë Kombëtare Antimashtrim, për mbrojtjen e interesave financiare të BE-së, (NAFS)";
- Grupin ndërinstitucional të punës "Për bashkërendimin e mbështetjes së vendit pritës dhe plotësimit të katalogut të kapaciteteve të mbështetjes së vendit pritës".

## V. KONTROLI TATIMOR

Gjatë vitit 2024, Drejtoria e Kontrollit Tatimor në DPT, bazuar në objektivat Strategjike të hartuara,

punoi dhe realizoi detyrat e ngarkuara në funksion të rritjes së performacës së administratës tatimore për mbledhjen dhe realizimin e të ardhurave buxhetore si dhe udhëheqjen metodologjike të Drejtorive të Kontrollit në DRT-të.

Objektivi kryesor i Drejtorisë së Kontrollit në DPT është udhëheqja metodologjike e funksionimit të

kontrollit tatimor dhe monitorimi i punës së drejtorive tatimore rajonale., në zbatim të objektivave të

Planit Strategjik, si dhe në ndjekje të rekomandimeve të FMN-së.

Drejtoria e Kontrollit Tatimor në DPT ka funksion kontrollin e performancës së realizimit të

detyrave nga Drejtoritë e Kontrollit në DRT dhe ofrimi i asistencës së duhur profesionale dhe analiza e të dhënave statistikore të situatës së kontrolleve.

*Detyrat funksionale të Drejtorisë së Kontrollit janë si më poshtë dhe janë realizuar në përputhje*

*objektivat e miratuar në planin operacional për vitin 2024:*

DKT është pjesë aktive e Komitetit të Riskut, duke përmbushur detyrat e saj në këtë komitet.

Merr pjesë në procesin e vendimmarrjes, kryen monitorime sipas rastit, si dhe raporton pranë këtij komiteti.

Drejtoria e Kontrollit Tatimor:

- ❖ Kryen kontrole dhe bën verifikime në bazë të planit vjetor në drejtoritë rajonale për të verifikuar nëse funksionet e kontrollit nga zyra dhe kontrollit në vend në këto drejtori kryhen në përputhje me procedurat e përcaktuara në Legjislacionin fiskal dhe që janë pjesë e Manualeve të Kontrollit.
- ❖ Monitoron arritjet e drejtorive tatimore rajonale kundrejt planeve të dërguara për zbatim nga DPT, investigon ndryshimet nga plani i kontrollit, bën komente për çdo

shmangie të dukshme në masat e marra në kontroll nga ato të planifikuara dhe merr masa për të korrigjuar këto shmangie, kur është e nevojshme. Gjithashtu, ofron këshillim dhe udhëzim të specializuar për një kontroll eficient dhe efektiv të tatimpaguesit.

- ❖ Raporton gjetjet që kanë dalë gjatë kontrolleve në lidhje me metodologjinë e kontrollit tek tatimpaguesit, mospërbushjet apo shkeljet ligjore, ose shërbimet e ofruara për tatimpaguesin, së bashku me rekomandimet për ndryshime të mëtejshme, duke propozuar edhe masa në rastet e shkeljeve administrative e ligjore. Dhe duke analizuar problematikat e konstatuara dhe mangësitë e inspektoreve të kontrollit ai rekomandon programet e trajnimit, për rritjen e aftësive të inspektorëve.
- ❖ Ndjek zbatimin e planeve të kontrolleve mujore të dërguara në DRT-të, si dhe mbi bazen e rezultateve të kontrolleve mujore të raportuara nëpërmjet evidencave mujore, brenda datës 10 të çdo muaji, ka analizuar e përpunuar vlerësimet e mbledhura mbi analizën e riskut për tatimpaguesit e kontrolluar nga të gjitha drejtoritë tatimore rajonale si dhe ka mbajtur evidencë të detajuar në lidhje me numrin dhe llojin e kontrolleve për çdo DRT, duke analizuar rezultatet dhe progresin e bërë kundrejt planit dhe kundrejt faktorëve të riskut mbi të cilët subjekti është përzgjedhur për kontroll kjo në bashkëpunim me DMR.

## Objektivat për vitin 2024

Objektivat strategjike përkatësisht për drejtorinë e kontrollit objektivat dhe aktivitete konkrete të ndërmarra për vitin 2024 janë si më poshtë:

### **Objektivi 1: *Garantimi i asistencës për përmbushjen vullnetare.***

#### **Nënobjektivi 1.3: Zbatimi i metodologjive dhe praktikave njëhsuese**

**Aktiviteti:** Garantoni praninë e sistemeve të qarta dhe të rregulluara për operacionet e kontrollit tatimor të tatimpaguesve, që ato të kuptohen e të pranohen si të drejta e të arsyeshme si edhe të zbatohen dhe të ndiqen vazhdimisht nga DRT;

Përgatitje e udhëzimeve apo rregulloreve që do ndihmojnë në procesin e propozimeve të

kontrollit nga Drejtoritë e Kontrollit në DRT.

**Objektivi 2: Implementimi efikas i legjislacionit tatimor dhe sigurimeve shoqërore, dhe hetimi i**

**rasteve të mashtrimit tatimor.**

**Nënobjektivi 2.1:** Zbatimi i strategjisë së përmbushjes së menaxhimit të riskut.

**Aktiviteti:** Miraton planet mujore të Drejtorisë së Kontrollit Tatimor me detyra të të gjithë sektorëve

përbërës të saj, dhe planet e punës për secilin sektor.

Analizimi i të dhënave dhe raporteve të kontrollit në përputhje me legjislacionin për cdo DRT objekt Kontrolli dhe nxjerrje e rekomandimeve për rritjen e efikasitetit të Drejtorive të Kontrollit si dhe në udhëheqjen metodologjike të kontrollit nga Drejtoria e Kontrollit në DPT. Nga raportimet e DRT-ve kemi evidencën mbi kontrollet:

Kontrolle e planifikuara 12-mujori 2024			Kontrolle e kryera 12-mujori 2024			Realizimi i planit të kontrolleve në %		
Gjithsej	Të plota	V. Fiskale	Gjithsej	Të plota	V. Fiskale	Gjithsej	Të plota	V. Fiskale
3,258	2,385	873	3,107	2,332	775	95%	97%	88%

Analiza Mujore e Performancës së Drejtorisë së Kontrollit Tatimor në DRT (Sektorit të Kontrollit në

Vend).

**Nënobjektivi 2.2:** Përmirësimi i mëtejshëm i kontrollit tatimor dhe gjurmimi i mashtrimeve tatimore.

**Aktiviteti 1:** Harton dhe Miraton planet operacionale të Drejtorisë së Kontrollit Tatimor me detyra të të gjithë sektorëve përbërës të saj, dhe planet e kontrollit për cdo drejtori rajonale.

Analizon punën e sektorëve të Kontrollit sipas detyrave funksionale.

Gjatë vitit 2024 janë monitoruar vazhdimisht sektorët e kontrollit, në lidhje me kontrollet në proces, deklaratimet, dorëzimin e pasqyrave financiare etj.

Në mënyrë progresive mujore mbi bazë të raportimeve me email, por edhe në formë shkresore tërheq

vëmëndjen e DRT-ve për zbatimin e afateve të kontrolleve bazuar në Manualin e Kontrollit

Tatimor dhe Ligjit të Procedurave Tatimore.

Harton dhe miraton planet e punës dhe planet operationale për sektorët përbërës.

Për vitin 2024 është hartuar plani operacional për Drejtorinë e Kontrollit dhe është detajuar sipas sektorëve në plane pune.

**Aktiviteti 2:** Merr masa që rekomandimet dhe kërkesat e auditit të Ministrisë së Financës, Kontrollit

të Lartë të Shtetit, rekomandimeve të FMN dhe institucioneve të tjera shtetërore, të ndiqen dhe zbatohen në lidhje me kontrollin e tatimpaguesve;

Analiza e zbatimit të shkallëve të ndryshme të TVSH, sipas rekomandimit të KLSH.

Analiza e efektivitetit të punës së inspektorëve sipas formimit të tyre dhe shpërndarja e kontrolleve bazuar në aftësi, sipas rekomandimeve të FMN.

**Aktiviteti 3:** Verifikimi i Drejtorive Rajonale mbi problematikat e kontrollit tatimor, verifikimit në

teren, vlerësimit dhe analizës së riskut; Realizon kontrole në Drejtoritë Rajonale.

Program kontrolli në DRT, lidhur me funksionimin e Drejtorisë së Kontrollit Tatimor.

Evidentimi i problematikave që kanë nevojë për trajtim nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve si

dhe ndjekja e tyre.

Analiza e programeve dhe raporteve të kontrollit sipas sektorëve të ekonomisë dhe evidentimi i trajtimit të tyre në mënyrë specifike.

Kontrolli i Performancës së punës së Drejtorive të Kontrollit Tatimor, në DRT-të e cituara më poshtë,

përdorimi i kriterëve të duhura për vlerësim, me qëllim që të prodhojë efekte në plotësimin e detyrave të ngarkuara.

**Objektivi 3: Progresi organizativ i Administratës Tatimore dhe zhvillimi i kapaciteteve njerëzore**

**Nënobjektivi 3.2. Zhvillimi i kapaciteteve dhe motivimi i punonjësve**

**Aktiviteti:** Zbaton dhe rekomandon programet e trajnimit për drejtuesit dhe inspektorët e kontrollit

tatimor.

Evidentimi i nevojave për DRT dhe DPT nëpërmjet hartimit të një pyetësi, ku të përcaktohen fushat e trajnimit, sektorët, etj.

Ndjekja e procesit të bashkëpunimit me Administratën Tatimore Suedeze, në funksion të përcaktimit të objektivave dhe fushave që asistencës së nevojshme për Drejtorinë e Kontrollit.

### **Nënobjektivi 3.3. Mbajtja e proceseve optimale dhe struktura e Administratës Tatimore.**

**Aktiviteti:** Përmirësimi i cilësisë së kontrolleve. Përditësimi i procedurave të kontrollit për të siguruar

kryerjen në kohë dhe në mënyrë standarte të tyre.

Analiza e gjetjeve dhe rezultateve të raporteve të kontrollit tatimor dhe nxjerrje e rekomandimeve për përmirësimin dhe rritjen e cilësisë së kontrollit. Përmirësimi i cilësisë së kontrolleve dhe përditësimi i procedurave të kontrollit për të siguruar kryerjen në kohë dhe në mënyrë standarde të tyre.

<b>Nr. i kontrolleve të kryera me zbulime</b>	<b>Zbulime (000lekë)</b>				
	<b>TVSH</b>	<b>TF</b>	<b>Sig Shoq</b>	<b>Te tjera</b>	<b>Gjithsej</b>
<b>Raste</b>					
2599	2,811,212	3,096,929	46,404	638,561	6,593,106

Për vitin 2024 nga kontrollet e kryera janë evidentuar dhe ndjekur problematika lidhur me trajtimin në raportin e kontrollit të problematikave sipas sektorëve.

#### Aktivitete të realizuara për vitin 2024

Drejtoria e Kontrollit ka kryer kontrole tematike në Drejtorinë e Kontrollit Tatimor në DRT, sipas programeve të kontrollit, të miratuara për këtë qëllim, për zbatimin me korrektësi dhe profesionalizëm të legjislacionit tatimor, duke u përqëndruar në drejtimin metodologjik të veprimtarisë të Drejtorive të Kontrollit pranë DRT-ve. Kontrollin dhe analizën e punës së inspektorëve të sektorit të kontrollit pranë DRT-ve, bazuar në planet operationale vjetore të miratuara për këtë qëllim, në përputhje me procedurat ligjore dhe kërkesat e akteve nënligjore të përcaktuara në rregulloret e brendshme dhe në Manualin e Kontrollit Tatimor.

Nga drejtoria e kontrollit janë dërguar shkresa dhe email në Drejtorinë Rajonale Tatimore në lidhje me orientimin dhe zbatimin e analizës së riskut për subjektet e përzgjedhur për kontroll sa më efektive në mbështetje të manualin të kontrollit analizën e riskut duke u mbështetur në analizën dhe propozimet e kryera nga inspektori i kontrollit nga zyra.

Mbajtur protokollin e shkresave, shqyrtuar dhe adresuar shkresat për vitin 2024, si dhe përcjellë sipas problematikave sektorëve përkatës, në respektim të afateve ligjore të kthimit të përgjigjeve të afërsisht 3500 shkresa.

Trajtimi i shkresave të deleguara duke hartuar përgjigjet përkatëse si dhe në raste të caktuara edhe me email.

Ndjekja dhe hartimi raportimeve për Planin Operacional vjetor, pyetësorët e OECD, FMN si dhe analizën e performancës së Drejtorisë.

Drejtoria e kontrollit ka marrë pjesë në çdo program trajnimi, të organizuar në DPT në zbatimin e legjislacionit tatimor në fuqi dhe ligjit të ri të tatimit mbi të ardhurat; si fiskalizimi dhe në projekte të përbashkëta me Suedezët, FMN apo Bankën Botërore.

Nga drejtoria e kontrollit janë ndjekur dhe marr masa në lidhje me rekomandimet dhe kërkesat e auditit të Ministrisë së Financës, Kontrollit të Lartë të Shtetit, Avokatit të

Tatimpaguesve, etj.

Nga drejtoria e kontrollit janë ndjekur raportimet për Kontrollit të Lartë të Shtetit, gjithashtu janë ndjekur të gjitha raportimet e lidhura me listat e dërguara nga Komiteti i Riskut në Drejtori Rajonale, verifikime rast pas rasti për çdo DRT dhe raportimet lidhur me evidencat për Drejtorinë e Kontrollit.

Marre pjesë në trajnime dhe raportime, të organizuara në DPT në zbatimin e legjislacionit tatimor në fuqi; si fiskalizimi, ligji i tatimit mbi të ardhurat si dhe në projekte të përbashkëta me FMN apo Bankën Botërore etj.

Ndjekja e raportimeve dhe takimeve në kuadër të projektit të DPT me Administratën Suedeze për Drejtorinë e Kontrollit.

Hartimi i disa raportimeve përmbledhëse nga DRT për listat e dërguara pranë DRT-ve nga Komiteti i Riskut, referuar raportimeve dhe masave të marra nga drejtoritë rajonale sipas problematikave përkatëse. Evidentimi i rasteve të pa kryera nga ana e drejtorive rajonale, nxjerrje e të dhënave për raste që janë të përsëritura dhe referim për verifikime të mëtejshme.

## VI.MENAXHIMI I RISKUT

Drejtoria e Menaxhimit të Riskut në organigramën e DPT-së është në varësi të Drejtorisë së Hartimit të Programeve, drejtohet nga Drejtori i Drejtorisë së DMR dhe është e organizuar në 2 sektorë.

- Sektori i Analizës së Riskut me 1 Përgjegjës dhe 10 Specialistë (1 pozicion vakante-inspektor)
- Sektori i Hartimit të Strategjive për Trajtimin e Risqeve -me 1 Përgjegjës dhe 6 Specialistë ( 2 pozicione vakante, 2 Specialist )

Objektivi parësor i modelit të riskut që ushtron veprimtarinë DMR është identifikimi mbi bazën e kritereve të miratuara dhe zhvilluara paraprakisht i tatimpaguesve që përbëjnë risk potencial lidhur me përmbushjen, veprimtaria tregtare e të cilëve do të verifikohet dhe trajtohet nga ana e administratës tatimore në harmoni me procedurat ligjore në fuqi.

### Objektivat e Drejtorisë për vitin 2024

Objektivi Strategjik i DMR është përmirësimi i analizës dhe vlerësimi i risqeve të rëndësishme të mosrespektimit të legjislacionit tatimor që ka një ndikim në uljen e hendekut të mospërmbushjes. Ky objektivi bazohet në këto shtylla të rëndësishme:

- ✚ Zhvillimi dhe zbatimi i projekteve sektoriale të përmbushjes dhe reduktimi i nivelit të riskut
- ✚ Zgjerimi i kapaciteteve për të ekzaminuar të dhënat nga burime të ndryshme gjatë analizës së riskut të përmbushjes së tatimeve;
- ✚ Përdorimi i burimeve të informacionit nga palë të treta dhe sigurimi që çdo informacion të jetë i integruar në modelin e kontrollit duke u bërë një faktor për vlerësimin e riskut
- ✚ Hartimi i analizave cilësore që fokusohet në target risqe specifike
- ✚ Monitorimi i rregullt i niveleve të përmbushjes.
- ✚ Forcimi i kapaciteteve dhe bashkëpunimi i pandërprerë me bizneset duke synuar marrjen e një baze të plotë të dhënash

Tregues kryesorë të performancës janë:

- ✚ Madhësia e hendekut tatimor sipas llojeve të risqeve
- ✚ Zvogëlimi i riskut të sjelljes së tatimpaguesve, pas trajtimit – reduktimi i numrit të tatimpaguesve me risk.
- ✚ Zvogëlimi i riskut të sjelljes së tatimpaguesve, pas trajtimit – reduktimi i hendekut të permbushjes.
- ✚ Vlera dhe numri i deklaratave të korigjuara nga tatimpaguesit, si rezultat i njoftimeve të dërguara apo takimeve të mbajtura me ta.

Lidhja e objektivave me rekomandimet e TADAT

Objektivat e DMR janë në përputhje me vleresimin e TADAT Qershor 2022, Kapitulli IV,

Menaxhimi efikas i Riskut POA 2 ,

Raportimi i saktë në deklarata POA 6,

Fushveprimi i nismave për reduktimin e kostove të përmbushjes nga tatimpaguesit POA 3-10

[Aktivitetet e programuara dhe realizuara gjate vitit 2024 ne funksion te realizimit te objektivave](#)

Realizimi i Trajnimeve nga ekspertë të FMN-së lidhur me Menaxhimin e Riskut të Përmbushjes si dhe trajnime për programin e përpunimit të të dhënave me volum të madh ( R Studio) si dhe trajnime nga ekspertë të Administratës Suedeze.

Plani i Turizmit 2024

Në kuadër të Planit të turizmit 2024 të miratuar me Vendim të Komitetit të Riskut Nr.19 dt 31.05.2024 janë analizuar të dhënat në sistemin tatimor për subjektet pjesë e planit dhe janë kryer një sërë analizash për risqe të ndryshme të cilat janë dërguar për trajtim.

- ✚ TP me renie xhiro me përgjegjësi mbi TVSH , mbi 6 punonjes krahasuar javën 1- 12 Qershor 2024 vs 2023
- ✚ Tatimpaguesit pa xhiro nga fiskalizimi datë 21-23.06.2024, me 2 ose me shumë punonjës aktive dhe me përgjegjësi TVSH
- ✚ Subjekte me mbi 19 dhoma nga të dhënat e Ministrisë së Turizmit që kanë rënie të qarkullimit Qeshor 2024vs2023
- ✚ Subjekte me mbi 15 dhoma nga të dhënat e Ministrisë se Turizmit që kanë 1-2 punonjës aktivë të regjistruar në datë 13.06.2024 ( dyshohen per nendeklarim punonjesish)
- ✚ Subjektet me përgjegjësi Tvsh-je dhe me rënie  $\geq 100$  mije leke

- ✚ Analizë për hotelet që janë të rregjistruara në platformën Booking, që përfshihen në zonën e Vlorës, Sarandës dhe Dhërmiut , për çmimet e dhomave mbi 15,000 lek (te reja) me TVSH për datat 05 - 06- 07.07.2024.
- ✚ Analizë për hotelet që janë të rregjistruara në platformen Booking, që përfshihen në zonën e Shëngjinit , për çmimet e dhomave mbi 15,000 lek (të reja) me TVSH për datat 12 - 13- 14.07.2024.
- ✚ Analizë në lidhje me subjektet që ushtrojnë veprimtari në fushën e turizmit dhe që kanë një rritje më pak se 10 % ose janë me rënie në periudhën 1-14 korrik 2024 krahasuar me vitin 2023.
- ✚ Analizë të subjekteve të cilët janë pajisur me leje për stacion plazhi, subjekte të cilat kanë shitur më pak se 20 çadra ose shazllona në fundjavën (4,5,6 korrik ) dhe kanë më shumë se 5 punonjes., subjektet të cilat kanë kontrata të lidhura për vitin 2024 për dy ose më shumë parcale por nuk figurojnë të kenë shtypur artikuj me përshkrim shezllon çader.
- ✚ Analizë për hotelet që janë të rregjistruara në platformen Booking , që përfshihen në zonën e Vlorës, Sarandës, Lezhës dhe Durrësit për çmimet e dhomave mbi 15,000 lek (të reja) me TVSH për fundjavat me datat 05-06-07.07.2024 dhe 12 - 13- 14.07.2024.
- ✚ Tatimpagues me performancë të dobët në qarkullim të deklaruar për subjekte nga lista e Turizmit por që janë me përgjegjësi TVSH
- ✚ Tatimpaguesit me performancë të dobët në qarkullim të deklaruar gjatë muajit qershor bazuar në numrin e punonjesve të deklaruar për subjekte nga lista e Turizmit por që janë me përgjegjësi TVSH.
- ✚ 300 TP me qarkullim më të lartë nga lista e TP me mbi 500.000 leke qarkullim për muajin Qershor 2024 dhe që kanë 1-2 punonjes.
- ✚ Pas analizës së kryer lidhur me krahasimin e xhiros nga fiskalizimi krahasuar Korrik 2024 me Korrik 2023 janë evidentuar 100 TP aktiv me rënie në vlerë më të madhe. Rënie në vlerë është mbi 5 milione lekë.
- ✚ 99 TP me numër punonjësish > 10 dhe te të cilët totali i TVSH-se së detyrueshme për të dy periudhat është nën 200,000 leke për periudhën Qershor 2024, Korrik 2024.
- ✚ 27 TP me leje për stacion plazhi nga agjencia e bregdetit mbi 10 punonjes dhe pa fatura për çadra për periudhën 12 - 18 Gusht 2024.

Disa nga rezultatet e Planit të Turizmit janë:

Nga krahasimi i të dhënave nga fiskalizimi vihet re se për periudhën Gusht 2024 krahasuar me Gusht 2023 kemi një rritje të shitjeve prej 11% dhe një rritje të numrit të faturave të lëshuara prej 5%

Nga krahasimi i të dhënave nga fiskalizimi vihet re se për periudhën Qershor - Gusht 2024 krahasuar me Qershor - Gusht 2023 kemi një rritje të shitjeve prej 14% dhe një rritje të numrit të faturave të lëshuara prej 7%

Janë regjistruar për përgjegjësinë e TVSH-se rreth 110 TP gjatë periudhës Maj – Gusht 2024.

### **Shkeljet e evidentuara renditur sipas numrit më të lartë të llojit të shkeljeve:**

- ✚ Moslëshim faturë tatimore BM ;
- ✚ Moslëshim faturë tatimore BV
- ✚ Moslëshim faturë tatimore BV me TVSH
- ✚ Punonjes i padeklaruar BM;
- ✚ Punonjes i padeklaruar BV;
- ✚ Mosperditesim të dhenash BV;
- ✚ të tjera

#### [Informaliteti në punë](#)

Në kuadër të luftës kundër informalitetit në tregun e punës është vepruar si në krijimin e kritereve të riskut për të evidentuar tatimpaguesit mospermbushës ashtu edhe në dërgimin e mesazheve ndërgjegjësuese për nxitjen e përmbushjes vullnetare.

Mesazhet ndërgjegjësuese janë si më poshtë:

Tetor 2024 POP- UP të gjithë popullatës së tatimpaguesve të regjistruar.

Nëntor 2024 POP –UP për 30.159 tatimpagues të evidentuar me risk

Janë realizuar 1.452 vizita inspektuese nga administrata tatimore nga të cilat 16 nga strukturat e Hetimit Tatimor

860 tatimpagues janë dërguar për vlerësim dhe inspektim nga Inspektoriati Shtetëror i Punës në kuadër të Memorandumit të Bashkëpunimit të nënshkruar midis institucioneve tona.

Nga krahasimi i të dhënave nga listpagesat e dorëzuara për 3 muajt e fundit të vitit 2024 ka pasur rritje si në totalin e kontributeve ashtu dhe në totalin e TAP.

	<b>2410</b>	<b>2411</b>	<b>2412</b>
23+25 Totali kontribute	13,714,768,089	13,881,954,058	14,091,921,331
kutia : 26 TAP	3,571,963,685	3,704,208,444	4,500,712,477
<b>Kontribute+TAP</b>	<b>17,286,731,774</b>	<b>17,586,162,502</b>	<b>18,592,633,808</b>
pozicione pune	747,031	745,486	741,044
Tatimpagues	131,069	130,365	130,034

Pozicione pune me rritje page sipas SEKTORIT 2411vs2409

Sektori me numrin më të lartë të pozicioneve me rritje është ai i Shërbimit me 46.508 pozicione dhe me +252.863.865 lekë rritje në kontribute dhe TAP.

<b>SEKTORI</b>	<b>Nr punonjes</b>	<b>Rritja ne kontribute + TAP</b>
në Sektorin e Ndërtimit	18,913	109,694,309
në Sektorin e Prodhimit	38,147	145,662,006
në Sektorin e Shërbimit	46,508	252,863,865
në Sektorin e Transportit	5,070	24,433,086
në Sektorin e Tregtisë	34,488	167,036,191
<b>Grand Total</b>	<b>143,126</b>	<b>699,689,457</b>

Jane konsideruar me rritje page ato pozicione ku rritja eshte me shume se 10%

#### [Përmirësimi i Modullit të Riskut](#)

Rregullat e modullit të riskut janë në proces të vazhdueshëm përmirësimi pasi ndikohen drejtpërdrejtë nga ndryshimet në paketat fiskale, nga sjellja e tatimpaguesve si dhe nga dinamika e mjedisit ekonomik. Ne kuadër të përmirësimit të funksionalitetit të rregullave dhe përshtatjes me ndryshimin e ligjit 29/2023 “ Për Tatimin mbi të Ardhurat”, DMR ka vijuar me ndryshimet e nevojshme në logjikë si dhe në përditësimin e dokumenteve në word për rregullat që lidhen me pagat dhe tatimin në burim dhe është duke vijuar të njëjtin proces edhe me rregullat e tjera që preken nga ndryshimet e deklaratave.

Në bashkëpunim me specialist në Drejtorinë e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit për të siguruar mbarëvajtjen e modelit, zhvillimet e reja dhe përditësimin janë analizuar të dhënat nga Modeli i Riskut.

## Kërkesa për raporte të reja

Është bërë kërkesa drejtuar palëve mirmbajtëse për përmirësimin në sistemin C@ts për raportet:

- ✚ Mosdeklarues Listpagesa
- ✚ Kryqëzim i Librave të Blerjes Fiskalizim – C@ts
- ✚ Kryqëzim i Librave të Shitjes Fiskalizim – C@ts
- ✚ Punonjes të dypunësuar

[Analizimi i riskut të tatimpaguesve që bëjnë Kërkesë për Rimbursim](#)

Bazuar në rregulloren për rimbursimin e Tvsh-së, mbështetur në Analizën e Riskut kapitulli 6, për çdo kërkesë për rimbursim të ardhur elektronikisht nëpërmjet sistemit c@ts në formën e një mesazhi pop up nga DRTVSH-ja, nëse tatimpaguesi në fjalë bën pjesë në tatimpaguesit me risk të lartë sipas modulit të riskut, Drejtoria e Menaxhimit të Riskut kryen verifikimet e duhura dhe njofton elektronikisht DRTVSH-në, sipas afateve të përcaktuara në rregulloren e rimbursimit të TVSH-së mbështetur në analizën e riskut.

[Analiza periodike për fenomene të ndryshme , tatime të veçanta dhe për sektorë të caktuar](#)

Bazuar në vendimet e Komitetit të Riskut si më poshtë:

- Vendimi nr 15 date 01.02.2024,
- Vendimi nr 16 date 29.02.2024,
- Vendimi nr 17 date 28.03.2024,
- Vendimi nr 18 date 29.04.2024,
- Vendimi nr 19 date, 31.05.2024
- Vendimi nr 20 date, 28.06.2024
- Vendimi nr 21 date, 26.07.2024
- Vendimi nr 22 date,29.08.2024
- Vendimi nr 23 date, 27.09.2024
- Vendimi nr 24 date, 1.11.2024
- Vendimi nr 25 date, 2.12.2024

**U miratuan dokumentet:**

- ✚ Përmirësimi i Planit të Përmbushjes për vitin 2024.
- ✚ Plani Sektorial i Turizmit 2024.
- ✚ Plani për tatimpaguesit e rinj në bashkëpunim me palën Suedeze

**U propozuan dhe miratuan listat për tatimpaguesit si në vijim:**

Miratimi Planeve të kontrollit

Lista TP për ndryshim përgjegjësie tatimore

Lista TP që kanë Diferenca nga deklarata e TVSH-së dhe të dhënave nga Fiskalizimi

Lista TP deklarues me zero të deklaratës së TVSH-së por me xhiro në fiskalizim

Lista TP deklarues me zero të deklaratës së TF-së por me xhiro në fiskalizim

Lista TP që nuk dorëzojnë deklaratat e Rentës për periudhën Janar - Nëntor 2023

Lista e TP me qarkullim 9-10 mln lekë për vitin 2023, pa përgjegjësi TVSH –

Lista e TP me mbi 400 fatura Janar 2024 por pa fatura 3 ditët e fundit 29 - 31.01.2023

Dërgim POP UP TP që kanë NIVF jo të rregullt në libra shitje dhe blerje për periudhën e Nëntor 2023

Lista e TP që kanë thyer të paktën 2 nga 3 rregullat e fiskalizimit

Lista e TP total me kredi ne 16.01.2024 me shumë se 5 mln lekë krahasuar me total kredi në datë 17.10.2023

Lista e TP me fatura pa TVSH mbi 2 mil lekë, blerës me TVSH, Janar - Dhjetor 2023

Dërgim POP UP TP që kanë të punësuar në LP 2312 të dypunësuar por që shuma totale e kontributeve është nën nivelin e kontributeve për nivelin minimal të pagësLista e tatimpaguesve nga Moduli i Riskut me rregulla të thyera dhe me xhiro nën 30 milion:

Lista e TP me Xhiro 20-30 milion lekë

Lista e TP me Xhiro 15-20 milion Lekë

Dërgim letër të personalizuar TP për Xhiro nen 15 milion Lekë

Lista e TP me shitje 100% të përjashtuara dhe blerje me TVSH të kreditueshme për periudhën Janar - Dhjetor 2023

Lista e TP që kanë ndërhyrë në deklarata në ulje të detyrimit pas ndërhyrjes nga ana e administratës tatimore

Lista e TP nga analiza e TP me Kod “agjensi publicitare”

Dërgim POP UP tatimpaguesve që kanë punonjës me pagë të barabartë ose më të madhe se paga maksimale por me shumën e kontributeve më të vogël se kontributet për pagën maksimale

Dërgim POP UP tatimpaguesve që kanë punonjës me kategori të dypunësuar por figurojnë në një listpagesë

Dërgim POP UP tatimpaguesve blerës të produktit “Vaj palme” me vlerë mbi 200.000 lekë-

Lista e tatimpaguesve blerës të produktit “Vaj palme” mbi 700.000 lekë

Lista e tatimpaguesve shitës së produktit “Vaj palme” ndaj blerësve individë

Lista e tatimpaguesve me që kanë lëshuar mbi 400 fatura gjatë periudhës 1-22 Shkurt por pa fatura në datat 23-25 shkurt 2024

Lista e tatimpaguesve në fushën e shërbimeve profesionale sipas Vendimit NR.753, dt 20.12.2023 dhe që janë mosdeklarues TFTH 2023

Lista e tatimpaguesve me përgjegjësi TVSH dhe me të ardhura nga TFTH 23-A por pa xhiro nga fiskalizimi. Diferenca mbi 50.000 lekë për DRT Tiranë

Lista e tatimpaguesve me të ardhura mbi 2 milion lekë për DRT-të e tjera dhe mbi 5 milion lekë për DRT Tiranë, nga deklarata e TFTH 23-A por pa xhiro nga fiskalizimi

Lista e tatimpaguesve me të ardhura mbi 14 milion lekë nga deklarata e TFTH 23-A dhe fiskalizimi

Lista e tatimpaguesve me 1-10 fatura datë 24.02.2024 dhe mbi 4 punjonës

Lista e tatimpaguesve që kanë ndërhyrë në deklarata në ulje të detyrimit pas ndërhyrjes nga ana e administratës tatimore

Lista e tatimpaguesve që rezultojnë me diferenca nga Kryqëzimi I faturave të librave të blerjeve dhe shitjeve për periudhën Maj, Qershor, Korrik 2023

Dërgim mesazh POP UP tatimpaguesve me 1-10 fatura datë 23.03.2024 dhe mbi 4 punjonës - Për trajtim nga DVKT-të.

Lista e tatimpaguesve me aktivitet “Aktiviteti i taksive” pa qarkullim nga fizikalizimi për vitin 2023 - dërgim mesazhi POP-UP

Lista e tatimpaguesve me kod profesione të lira dhe me raport të shpenzimeve dhe të ardhurava mbi 100%

Lista e tatimpaguesve të ardhura mbi 8 mln ose shumë afër kufirit por, janë pa përgjegjësi Tatim Fitimi –

Lista e tatimpaguesve OJF të evidentuara me risk

Lista e tatimpaguesve me mbi 10 fatura të lëshuara në ditë, ku më shumë se 20% e tyre janë fatura korigjuese -

Lista e tatimpaguesve të cilët kanë lëshuar fatura cash B&B në vlerën 130,000-149,999 lekë – Dërgim Pop-up - Për trajtim nga pala.

Lista tatimpaguesve që janë të klasifikuar nga Ministria e Turizmit si struktura akomoduese/agroturizëm, por nga ana tjetër kanë përshkrim Rev 2 me aktivitete të ndryshme - Dërgim Pop-up - Për trajtim nga pala.

Lista tatimpaguesve që kanë plotësuar kutinë “(17) Shitje të tatueshme (me shkallë 6%)” në deklaratën e TVSH për vitin 2023 por kodet e aktivitetit nuk janë në përshatje me aktivitetet që përfitojnë shkallë të reduktuara sipas ligjit

Lista e tatimpaguesve me shumën e kontributeve më vogël se kontributet për pagën maksimale -

Lista e tatimpaguesve me mbi 3 punonjes, me më shumë se 12 muaj aktivitet, të pa kontrolluar 2 vitet e fundit dhe me raport xhiro mesatare mujore/ numër mesatar punojësis më e madhe se 200.000 lekë

Lista e tatimpaguesve me fatura pa TVSH mbi 2 mil lekë, blerës me TVSH, Janar - Dhjetor 2023

Lista e tatimpaguesve të cilët kanë checkuar në kutizën [19], [20] dhe [21] në deklaratën e Tatimit mbi Fitimin për periudhat 19-A deri në 23-A

Lista e tatimpaguesve të cilët në deklaratën e Tatimit mbi Fitimin për periudhat 21-A deri në 23-A kanë deklaruar të ardhura ushtrimore mbi 14.000.000 lekë, ndërsa në rubrikën 9 (Të ardhura tatimore) me vlerë zero.

Lista e tatimpaguesve të cilët rezultojnë me shtesë periodike të detyrimit për TVSH-në për periudhën Nëntor 2023 - Prill 2023

Lista e tatimpaguesve me përgjegjesi TVSH, pa xhiro nga fiskalizimi datë 21-23.06.2024, me 2 ose me shumë punonjës aktivë

Lista e tatimpaguesve pa përgjegjesi TVSH, pa xhiro nga fiskalizimi date 21-23.06.2024, me 5 ose me shumë punonjës aktivë

Lista e tatimpaguesve pa përgjegjesi TVSH, pa xhiro nga fiskalizimi date 21-23.06.2024, me 2-4 punonjës aktivë

Lista e Tatimpaguesve që në listëpagesen e muajit Maj 2024 kanë deklaruar punonjës në një nga kategoritë për kontribute "I dypunësuar..." por që gjenden vetëm në një listëpagese për këtë periudhë.

Lista e tatimpaguesve me shitje 6% mbi 100.000 lekë për muajin Qershor dhe me çertifikatë nga Ministria e Turzimit si strukturë akomoduese por me kod aktiviteti të ndryshëm nga akomodimi

Lista e tatimpaguesve me punonjës me të paktën 13 periudha me kategorinë "I punësuar cili për gjithë muajin ka qënë me raport leje barrë lindje"

Lista e tatimpaguesve me shitje me normën 6% mbi 100.000 lekë për muajin Qershor 2024 dhe pa çertifikate nga Ministria e Turzimit si strukturë akomoduese

Lista e tatimpaguesve në sektorin e Turizmit me qarkullim mbi 500.000 lekë por me 1-2 punonjës në 2406-

Lista e tatimpaguesve me TVSH të detyrueshme për tu paguar Qershor + Korrik 2024 nën 200,000 lekë dhe mbi 10 punonjës.

Lista e tatimpaguesve me leje për stacion plazhi por pa fatura për cada 12-18 Gusht 2024.

Lista e tatimpaguesve që kanë të deklaruar operator turn i 3-të me pagë deri në nivelin minimal për periudhen 01.06.2024-30.06.2024. - Për trajtim, dërgimi i një mesazhi Pop-Up në llogarinë e tatimpaguesit

Lista e Tatimpaguesve me qarkullim mbi 500.000 lekë por me 1-2 punonjës, (lista e përditësuar sipas Vendimit të komitetit Nr.21).

Lista e tatimpaguesve me shitje 6% mbi 100.000 lekë për muajin Qershor dhe me çertifikatë nga Ministria e Turzimit si strukturë akomoduese por me kod aktiviteti të ndryshëm nga akomodimi. (Listë e komitetit Nr.21, trajtimi i të cilës është shtyrë me e-mailin e datës 08.09.2024).

Lista e tatimpaguesve për procedura të mëtejshme hetimore nga Drejtoria e Hetimit Tatimor. U vendos të ndiqen procedurat e mëtejshme nga DHT për 3 tatimpagues nga lista e propozuar.

Lista e tatimpaguesve me qarkullim me minus për periudhen Janar - Gusht 2024 mbi 1.000.000 leke. - Për trajtim nga KZ në DRT

Lista e tatimpaguesve me diferencën mesatare të lëshimit midis dy faturave të njëpasnjëshme më të lartë se mesatarja e sektorit.

Lista e tatimpaguesve pa përgjegjesi tatimore TVSH dhe që për periudhen Janar - Qershor 2024 shuma e shpenzimeve referuar listëpagesave dhe deklaratës së TB është e barabart ose më e lartë se shuma e të ardhurave nga fiskalizimi. - Për trajtim, dërgimi i një mesazhi Pop-Up në llogarinë e tatimpaguesit

Tatimpagues i identifikuar me riskun e nëndeklarimit të të ardhurave.

Lista e tatimpaguesve që ushtrojnë aktivitet në sektorin e Mobilerive, të cilët kanë numër të ulët punonjësish në raport me qarkullim e deklaruar.

Lista e tatimpaguesve që ushtrojnë aktivitet në sektorin e Stomatologjisë, të cilët kanë numër të ulët punonjësish në raport qarkullim e deklaruar.

Lista e tatimpaguesve të sektorit ndërtim me fatura korrigjuese të larta për periudhën Janar-Shtator 2024. - Për trajtim nga Hetimi Tatimor dhe Kontrolli nga Zyra

Lista e 100 tatimpaguesve individ të cilët kanë ulur detyrimin për tu paguar për DIVA 2023. - Për trajtim nga DRT-të

Dërgim mesazh POP UP tatimpaguesve të vlerësuar me riskun e nëndeklarimit të pagave

Lista e tatimpaguesve të cilët referuar mesatares mujore të qarkullimit pritet që deri në fund të vitit të kalojnë pragun e regjistrimit për TVSH. (Këto TP për vitin 2023 kanë pasur një qarkullim në vlerat 9.5 - 10 milion lekë).

Lista e tatimpaguesve blerës të cilët kanë fatura blerje mbi 2 milion lekë për periudhën Janar - Gusht 2024 nga shitës pa përgjegjësi TVSH . - Për trajtim nga Hetimi

Lista e tatimpaguesve të vlerësuar me riskun e nëndeklarimit të pagave.

Miratim i kriterëve të riskut për tatimpaguesit OJF që paraqesin risk potencial për pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit

### **1. Fiskalizimi**

Gjatë vitit 2024 DMR është angazhuar në monitorimin e ecurisë së sjelljes së tatimpaguesit bazuar në procesin e fiskalizimit duke dërguar në menyrë periodike lista me tatimpaguesit mospërmbushes nëpër Drejtoritë Rajonale Tatimore.

Gjithashtu janë zhvilluar takime dhe komunikime të vazhdueshme me palën zhvilluese mbi sistemin e menaxhimit të rrezikut të implementuar ne CPCPM për të testuar risqet e zhvilluara në modul , për të verifikuar funksionalitetin e tyre dhe për të përmirësuar rezultatet e nxjerra nga këto risqe .

Brenda vitit 2024 janë testuar vazhdimisht rregullat dhe janë çertifikuar 46 rregulla, ndërkohë që vijonë komunikimet dhe testimet për rregullat e tjerë të mbetur.

### **2. Shkëmbimi automatik i informacionit**

Në kuadër të zbatimit të Përmbushjes Administrative për Standartet e Shkëmbimit Automatik të informacionit të Llogarive Financiare gjatë vitit 2024 janë realizuar aktivitetet si më poshtë:

1. Analizimi i raporteve të gjeneruara nga sistemi për raportimin e vitit 2023
2. Identifikimi i 5 institucioneve financiare të cilëve iu është dërguar letër për të plotësuar pyetësor dhe për 3 prej tyre iu është sqaruar dhe problematika që kanë në mënyrë që në vijim të përmirësojnë raportimin e tyre. Këto institucione janë përzgjedhur si më poshtë:



1 institucion financiar i cili është koherent në raportim

✚ 2 institucione financiar me rritje të konsiderueshme të llogarive financiare të raportuara si të padokumentuara.

✚ 1 institucion financiar me problematiken ku llogaritë e organizateve janë raportuar si llogari individuale, duke mos identifikuar personin kontrollues

✚ 1 institucion financiar me numër të ulët të llogarive të raportuara

✚ 3 institucione financiare kanë kthyer përgjigje dhe kanë plotësuar pyetësin. Përgjigjet e tyre janë duke u analizuar nga ana jonë për të kuptuar nëse u është dhënë përgjigje pyetjeve dhe a po realizojnë këto institucione vigjilencën e duhur.

3. Hartimi i letrës për tu çuar tatimpaguesve të cilët janë identifikuar nga ne si raportues por nuk kanë raportuar, për të dhënë arsyet e tyre për këtë situatë.
4. Zhvillimi i takimit me Bankën e Shqipërisë ku në vijim është dërguar shkresë për identifikimin e institucioneve financiare të liçencuara nga BSH dhe është kthyer përgjigje duke dërguar listen e institucioneve financiare të liçencuara si në formë shkresore ashtu edhe në formë elektronike.

#### Të tjera aktivitete të realizuara nga DMR gjatë vitit 2024.

Drejtoria e Menaxhimit të Riskut në DPT është përgjegjëse për menaxhimin e përzgjedhjes automatike të tatimpaguesve për kontroll, bazuar në kriteret e miratuara të riskut. Hartimi i planeve mujore të kontrollit, planifikim i rasteve për rimbursim referuar shkresave të DRTVSH dhe hedhja e evidencave të kontrollit në një plan-fakt te perbashket për 14 DRT. Drejtoria e Menaxhimit të Riskut përzgjedh 70% të tatimpaguesve për kontroll tatimor të plotë në vend sipas të dhënave të regjistrit elektronik të riskut me pëjashtim të DTM dhe DRT Tiranë ku përzgjedhja për kontroll të tatimpaguesve të vlerësuar me risk të lartë përfshin 50% të totalit të planit mujor.

Jane kryer ekzekutimet e modulit të riskut për projektet sektoriale, për rimbursimin e TVSH-së apo nevoja të tjera analizash.

Gjatë vitit 2024 janë kryer:

✚ 4 ekzekutime të Modulit të Riskut për Rimbursimin e TVSH-se

✚ 2 ekzekutime të Modulit të Riskut për Planet e Kontrollit

## 5. Objektivat e Drejtorise per vitin 2025

Objektivi kryesor i veprimtarisë së Drejtorisë Menaxhimit Riskut është evidentimi i risqeve të mospërbushjes tatimore, kryerja e analizave për risqet e evidentuara dhe hartimi i propozimeve dhe rekomandimeve për trajtimin e tyre në nivel sektorial/industri, rajonal apo kombëtar duke ja propozuar Komitetit të Riskut në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, me qëllim prioritizimin dhe trajtimin e risqeve të identifikuar. Ky është një proces sistematik ,gjatë së cilit DMR zgjedh në mënyrë objektive prioritetet që do të përdoren për të stimuluar efektivisht përmbushjen dhe për të parandaluar mospërbushjen.

Kjo është e realizueshme nëpërmjet koordinimit dhe bashkeveprimit në nivel drejtues, taktik dhe operacional ,duke qenë linjë me synimet e administratës ,si dhe marrjen në konsideratë në çdo moment të të dhënave/informacioneve që orientojnë në vendimarrje ku përfitimet afatgjata në rang kombëtar do të jenë më të medha se kostot afatshkurtra.

- ✚ Përgatitja e raporteve për kategoritë e tatimpaguesve me sjellje deviante dhe shmangie tatimore dhe propozimi i tyre në Komitetin e Riskut me qëllim kryerjen e vlerësimeve tatimore për mosdeklaruesit e transaksioneve nga DRT.
- ✚ Implentimi i ndryshimeve të ligjit të ri "Për tatimin mbi të ardhurat" në Modulin e Riskut dhe analizimi i fenomeneve me risk që rrjedhin nga zbatimi i këtij ligji.
- ✚ Rritja e funksionalitetit të modulit të riskut pjesë e fiskalizimit, përmirësim dhe zhvillim i rregullave që ndodhen në modul dhe krijim i rregullave të reja.
- ✚ Nxitja e bashkëpunimit dhe marrjes së informacionit nga palët e treta.
- ✚ Vlerësimi i Riskut për IFR lidhur me saktësinë e raportimit në kuadër të Ligjit 4/2020 "Për shkëmbimin automatik të informacionit të llogarive financiare".

### [Projekte të ndërmarra aktualisht në bashkëpunim me organizma ndërkombetare](#)

Bashkëpunimi midis Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe Agjencisë Tatimore Suedeze ka qenë thelbësor për forcimin e kapaciteteve në menaxhimin e riskut të përmbushjes për bizneset e reja. Ky bashkëpunim ka ndihmuar në identifikimin, trajtimin dhe ndjekjen e dukurive tatimore, për të përmirësuar përmbushjen vullnetare të detyrimeve nga këta tatimpagues. Projekti pilot

CRM (Komponenti i Menaxhimit të Riskut të Përmbushjes) ka trajtuar komponentë risku që lidhen me hapjen e bizneseve të reja, të cilat shpesh shmangin përmbushjen tatimore.

Faktoret janë :

1. Shmangia e përgjegjesisë për Tatimin në Burim
2. Biznese me të ardhura shumë afer pragut 8 mil ,por pa e kaluar atë
3. Subjekte qe ndryshojnë statusin e tyre nga aktiv ,pasiv apo kerkesë per çrregjistrim kur i afrohen pragut të Tvsh-se
4. Biznese te vogla të cilat faturojnë vlera të larta (faturime atipike) per biznese të mëdha
5. Hapja dhe mbyllja e shpeshtë e NIPTE-ve me të njëjtin aktivitet/adrese/nr kontakti
6. Subjekte te reja me administrator “Strawmen” te cilet nuk jane me aktiv ne veprimtarine e biznesit.

Gjatë viti 2024 DMR ka pasur asistencë nga FMN lidhur me përpunimin e të dhënave nëpërmjet programit R Studio. Seminaret u zhvilluan në dy misione të ndara. Në serinë e parë të seminareve (maj – korrik 2024) u bë prezantimi i konceptit sprint në analitikën e të dhënave dhe u trajtuan tri çështje të përmbushjes. Në serinë e dytë (gusht - tetor 2024) u trajtuan katër tema të ndryshme dhe kishte mundësi të përshtateshin për të përfshirë sfidat e reja të përmbushjes të identifikuara nga Drejtoria e Menaxhimit të Riskut.

## VII. DREJTORIA E MBLEDHJES SE DETYRIMEVE TATIMORE TE PAPAGUARA

Në zbatim të detyrave operacionale, menaxhimi i detyrimeve tatimore të papaguara në afat mbështetet në objektiva strategjike dhe përqëndrohet në garantimin e mbledhjes së detyrimeve të prapambetura, duke siguruar respektimin e të drejtave të tatimpaguesve, uljen e ekspozimit ndaj risqeve që lidhen me mbledhjen e detyrimeve të prapambetura dhe në të njëjtën kohë evidentimin sa më real të gjendjes së detyrimeve tatimore, bazuar në të dhënat e dërguara nga Drejtoritë e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara në Rajone dhe NJTM, sipas evidencave që raportohen çdo muaj nga ana e tyre.

Ecuria dhe gjendja e detyrimeve tatimore të papaguara në afat deri më 31 Dhjetor 2024 paraqitet si më poshtë:

Gjendja e detyrimeve të papaguara në afat në datë 01.01.2024 **155.2 miliardë lekë**

Gjendja në datë 31.12.2024 **162.5 miliardë lekë**

Në detyrimet prej 162.5 mld lekë, të cilat ndiqen deri më 31 Dhjetor 2024, është e përfshirë edhe vlera prej 12.56 mld lekë, e cila është në proces gjyqësor, ku deri në fund të Dhjetor 2024 zë 8% të stokut të detyrimeve te papaguara.

Gjatë periudhës së marrë në analizë, detyrimet tatimore kanë pësuar një rritje neto 7.37 mld lekë në krahasim me fillimin e vitit, ose thënë ndryshe është rritur stoku i detyrimeve me 4.7%, rreth 1.1 mld lekë ose 12% më pak krahasuar me vitin paraardhës.


Detyrimet e pakësuara gjatë vitit 2024 janë 32 mld lekë. Në detyrimet e pakësuara përfshihen arkëtimet dhe sistemimet e ndodhura gjatë periudhës.

Detyrimet tatimore të papaguara në afat deri më 31 Dhjetor 2024 të specifikuara sipas zërave përbërës paraqitet si më poshtë:

- Detyrimi 62 %
- Penalitete 33%
- Kamatëvonesa 5%


Nga të dhënat e mësipërme rezulton se principlali i detyrimeve tatimore të akumuluarra përbën rreth 62% të shumës totale të detyrimeve tatimore, ndërkohë që pjesa tjetër e këtyre detyrimeve 38% e mbetur përbëhet nga penalitetet dhe kamatëvonesat.

#### Detyrimet sipas Llojit të Tatimit



Në stokun e detyrimeve të papaguara në afat të ndarë sipas llojit të tatimit, TVSH zë peshën më të madhe në stokun e borxhit me 35% në vlerë 57.17 mld lekë, e ndjekur nga Tatim Fitimi me 29% në vlerë 47.18 mld lekë, zëri Sigurimet Shoqërore & Shëndetësore me 15% në vlerë 24.4 mld lekë, Të Tjera me 15% në vlerë 24.03 mld lekë, Tatimi në Burim me 4% në vlerë 6.45 mld lekë, TAP me 2% në vlerë 2,66 mld lekë dhe DIVA me 0.4% në vlerë 636 mln lekë.

## Detyrimet sipas llojit të Tatimit 2024 vs 2023 në miliardë lekë



Krahasuar me fundin e vitit 2023, gjatë këtij viti Tatim Fitimi me 2.38 mld lekë, TVSH është rritur me 1.9 mld lekë, Sigurimet Shoqërore dhe Shëndetësore me 1.89 mld lekë, Tatimi në Burim me 0.57 mld lekë, zëri TAP me 0.37 mld lekë, DIVA me 0.17 mld lekë dhe zëri të tjera me 0.09 mld lekë.

## Mosha e detyrimeve të papaguara në afat

MOSHA E BORXHIT DERI NË 31.12.2024						
Periudha	Borxhi deri në 3 muaj	Borxhi nga 3 - 6 muaj	Borxhi nga 6- 12 muaj	Borxhi nga 1- 2 vjet	Borxhi nga 2- 5 vjet	Borxhi mbi 5 vjet
Detyrimet e papaguara në afat	4,229,900	2,898,305	7,331,906	10,422,079	32,879,530	104,773,742


Në total stokun e borxhit mld lekë, borxhi sipas vjetërsisë paraqitet si më sipër ku:

- borxhi deri në 3 muaj **2.6% ndaj totalit të stokut**
- borxhi nga 3 - 6 muaj **1.8% ndaj totalit të stokut**
- borxhi nga 6-12 muaj **4.5% ndaj totalit të stokut**
- borxhi nga 1-2 vjet **6.4% ndaj totalit të stokut**

**Borxhi me vjetërsi mbi 2 vjet në vlerë 137.65 mld lekë është 84.7% ndaj totalit të stokut**

Referuar moshës së detyrimeve të papaguara vihet re se detyrimi më i ri është arkëtuar duke përdorur analizën e profilit të riskut (detyrimi më i ri dhe vlera më e lartë) si dhe duke ndjekur vetëdeklarimet për çdo muaj nga “Sektori i Monitorimit dhe Analizës” në Rajonet e Mbledhjes, me qëllim rritjen e performancës në arkëtimin e detyrimeve tatimore.

#### Detyrimet sipas statusit të tatimpaguesit



- Tatimpaguesit Aktivë zënë 40% të numrit total të tatimpaguesve debitorë me një vlerë prej 41.6 mld lekë ose 26% të masës totale të borxhit.
- Tatimpaguesit Pasivë zënë 60% të numrit total të tatimpaguesve debitorë me një vlerë prej 121 mld lekë ose 74% të masës totale të borxhit.

Gjatë vitit 2024 janë ndërmarë një varg iniciativash për të forcuar funksionin e mbledhjes së detyrimeve të prapambetura tatimore me fokus forcimin e kuadrit ligjor, përmirësimin e proceseve të punës, lehtësimin e proceseve të komunikimit me tatimpaguesit me qëllim ndjekjen e menjëhershme të detyrimit të ri, duke parandaluar kthimin e tij në detyrim të vjetër për mos përshkallëzimin e stokut të detyrimeve aktuale.

Nga ana e Rajoneve të Mbledhjes ka vijuar zbatimi i procedurës së komunikimit me tatimpaguesit duke patur për qëllim vetëpërbushjen vullnetare të detyrimeve të papaguara si dhe sqarimin e procedurave të mbledhjes me forcë të cilat do të vijojnë në zbatim të ligjit. Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve të Papaguara në DPT ka monitoruar ecurinë e stokut të detyrimeve, ka kryer analiza të situatës së detyrimeve në nivel tatimpaguesi dhe veçanërisht atyre më të mëdha, masave të ndërmarra në lidhje me to në përputhje me aktet ligjore në fuqi.

Indikator kyç për matjen e performancës së Drejtorisë së Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara është “Raporti i Detyrimeve Tatimore të Mbledhura në vitin N kundrejt detyrimeve të shtuara në vitin N”. Ky raport për vitin 2024 është realizuar në masën 81.3%, rreth 2% më shumë krahasuar me vitin paraardhës. Kjo është shenjë inkurajuese dhe pasqyron përparësinë që i jepet tanimë mbledhjes së borxhit të ri.

## VIII. RIMBURSIMI I TVSH-SË

### Objekti dhe detyrat e Drejtorisë së Rimbursimit të TVSH-së

Drejtoria e Rimbursimit të TVSH-së është struktura që merret me trajtimin, miratimin dhe kryerjen e procedurës së rimbursimit të TVSH-së në bashkëpunim me Drejtoritë Rajonale Tatimore, Drejtorinë e Menaxhimit të Riskut në DPT dhe Drejtorinë TIK të Tatimeve.

Detyrat e Drejtorisë së Rimbursimit të TVSH-së, janë si më poshtë vijon:

1. Të lehtësojë zbatimin me përpikmëri të legjislacionit tatimor në fushën e rimbursimit të tvsh-së si dhe unifikimin e procedurës së ndjekur lidhur me trajtimin e praktikave;
2. Të kryejë procedurën e rimbursimit të tvsh-së bazuar në analizën e riskut;
3. Të kryejë përveç procedurës së rimbursimit të TVSH-së bazuar në analizën e riskut edhe procedurën e rimbursimit të TVSH-së nëpërmjet sistemit të thesarit, nëse kërkesa për rimbursim tvsh-je është bërë:
  - nga organizatat jofitimprurëse për tvsh-në e paguar në blerje, për mallra të destinuara për eksport për përmbushjen e qëllimit si pjesë e veprimtarisë së tyre bamirëse jashtë Shqipërisë në kuadër të marrëveshjeve të posaçme;
  - në kuadër të marrëveshjeve financiare të ratifikuara nga Kuvendi ose në kuadër të marrëveshjeve të granteve të miratuara nga Këshilli i Ministrave, në të cilat parashikohet mospërdorimi i burimeve financiare të huaja për të paguar taksa e tatime, në bazë të parimit të reciprocitetit për TVSH-në e paguar për blerjet brenda vendit nga misionet diplomatike, organizatat ndërkombëtare dhe personeli i tyre.

### Baza Ligjore

Baza ligjore për rimbursimin e TVSH-së është e përcaktuar në:

1. Nenin 77 të Ligjit 92/2014 datë 27.4.2017 “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në RSH” i ndryshuar,
2. Nenin 62, 63 dhe 64 të Udhëzimit Nr. 6, datë 30.01.2015 “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në RSH”, i ndryshuar,

3. Nenin 75/1 të Ligjit Nr.9920, datë 19.5.2008 “Per Procedurat Tatimore ne RSH” i ndryshuar,
4. Pikën 75/1 të Udhëzimit Nr. 24, datë 02.09.2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH”, i ndryshuar,
5. VKM nr. 953, datë 29.12.2014, "Për dispozitat zbatuese të ligjit nr. 92/2014 "Për tatimin mbi vlerën e shtuar" për qëllime të rimbursimit të TVSH-së, e ndryshuar,
6. Udhëzimin Nr. 19, datë 3.11.2014 “Për zbatimin e regjimit të vecantë të skemës së kompensimit të prodhuesve bujqësorë për qëllime të tatimit mbi vlerën e shtuar” i ndryshuar,
7. “Rregulloren e Rimbursimit të TVSH-së mbështetur në analizën e riskut” dhe
8. “Manualin për rimbursimin e TVSH-së”.

Çdo person i tatueshëm, i cili plotëson kushtet e parashikuara në nenin 77 të ligjit 92/2014 "Për TVSH-në", ka të drejtë të kërkojë rimbursimin e TVSH-së.

1. Një person i tatueshëm kërkon rimbursim të tepricës së kreditimit tatimor të TVSH-se nëse:
  - a) personi i tatueshëm ka mbartur tepricën e TVSH-së së zbritshme për 3 muaj radhazi, sipas pikave 2 dhe 3, të nenit 76, të këtij ligji;
  - b) TVSH-ja e kërkuar për t’u rimbursuar tejkalon shumë prej 400 000 lekësh.

Procedura e rimbursimit është e percaktuar ne nenin 75/1 të Ligjit nr. Ligjit Nr.9920, datë 19.5.2008 “Per Procedurat Tatimore ne RSH” i ndryshuar dhe pikes 75/1 te Udhëzimit Nr.24, datë 02.09.2008 “Për Proçedurat Tatimore në RSH”, i ndryshuar.

Gjithashtu, brenda afatit ligjor 30 ditor, bazuar ne nenet 63 dhe 64 të Udhëzimit Nr. 6, datë 30.01.2015 “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në RSH”, i ndryshuar, kryhet :

- Rimbursimi i TVSH-së për projektet e kryera në kuadër të marrëveshjeve financiare të ratifikuara nga Kuvendi ose në kuadër të marrëveshjeve të granteve të miratuara nga Këshilli i Ministrave. **Neni 63**
- Rimbursimi i TVSH-së së paguar në blerjen e mallrave dhe shërbimeve për projektet e kryera në kuadër të zbatimit të Instrumentit të Parazgjerimit (IPA I) dhe Instrumentit për Asistencën e Paraanëtarësimit (IPA II). **Neni 63**

- Rimbursimi i TVSH-së së paguar në blerjen e mallrave dhe shërbimeve, për misionet diplomatike dhe organizatat ndërkombëtare. **Neni 64**

#### Aktivitetet e programuara dhe realizuara për vitin 2024

Bazuar në planin e aktiviteteve për vitin 2024, Drejtoria e Rimbursimit të TVSH-së ka realizuar aktivitetet kryesore të mëposhtme:

Trajtimi dhe Rimbursimi i kërkesave për rimbursim të TVSH-se sipas afateve ligjore;

Ecuria e treguesve të rimbursimit për vitin **2024** është si më poshtë:

**Kerkesat:** Gjate periudhes Janar - Dhjetor 2024, pranë DRTVSH-se janë regjistruar **2678 kërkesa** për rimbursim (nga **2877** kërkesa të regjistruara në 2023), me vlerë totale **38.760 milion leke** (nga **49.538** milion leke në 2023). Gjithsej **jane pranuar 1652 kërkesa** (nga **1690** kërkesa të pranuar në 2023), me një ulje në numër rreth 2.24% krahasuar me 2023, me vlerë **27,551 milion leke** (nga **28.743** milion leke në 2023), me një ulje në vlerë rreth 4.14% krahasuar me 2023, dhe **1026 kërkesa** me vlerë **11.209 milion leke** (nga **1187** kërkesa në 2023, me vlerë **20.795** milion leke), **nuk janë pranuar** për mosplotësim të kriterëve ligjore.

- Nga 1652 kërkesa të pranuar, **95 kërkesa** me vlerë **858 milion leke** janë bërë nga tatimpagues të klasifikuar si eksportues me Risk Zero, kërkesa e të cilëve duhet të miratohen dhe rimbursohen automatikisht brenda 30 ditëve nga data e kërkesës;
- Nga 1652 kërkesa të pranuar, **866 kërkesa** me vlerë **11.925 milion leke** janë bërë nga tatimpagues të klasifikuar si eksportues, kërkesa e të cilëve duhet të miratohet dhe rimbursohet brenda 30 ditëve nga data e kërkesës;
- Nga 1652 kërkesa të pranuar, **691 kërkesa** me vlerë **14.768 milion leke** janë bërë nga tatimpagues të klasifikuar si jo-eksportues, kërkesa e të cilëve duhet të miratohet dhe rimbursohet brenda 60 ditëve nga data e kërkesës.

**Rimbursimet:** Gjate periudhes Janar - Dhjetor 2024, janë rimbursuar në total (FIFO + Keste) **22,363 milion leke**, rreth **1.1 % më pak se në 2023** (nga 22.614 milion leke në rimbursuar në 2023). Janë miratuar dhe rimbursuar **1601 kërkesa** të trajtuara sipas metodës FIFO (nga 1655 kërkesa të pranuar në 2023), me një ulje në numër rreth 3.26 % krahasuar me 2023, me vlerë totale për rimbursim **24.931 milion leke** (nga **26.976** milion leke në 2023) me një ulje në vlerë

rreth 7.58 % krahasuar me 2023. Te gjitha kerkesat FIFO te miratuara per periudhen Janar - Dhjetor 2024 jane rimbursuar ne kohe, duke bere qe mos te kemi stok te kerkesave ne fund te vitit 2024.

Pjesa me e madhe vleres se rimbursuar (rreth 57.74%) eshte dhene per tatimpaguesit e DTM

Nr.	Rimbursuar sipas DRT-ve (000 leke)		
	DRT Tatimore	Numri i Kerkesave	Vlera e Rimbursuar
1	BERAT	54	277,552
2	DIBER	9	137,010
3	DURRES	361	1,983,593
4	ELBASAN	97	447,842
5	FIER	126	861,452
6	GJIROKASTER	31	133,232
7	KORCE	93	232,387
8	KUKES	20	219,852
9	LEZHE	40	172,378
10	SARANDE	23	216,324
11	SHKODER	68	274,773
12	TIRANE	276	4,073,915
13	DTM	242	12,914,279
14	VLORE	99	418,521
<b>TOTALI</b>		<b>1539</b>	<b>22,363,110</b>

**Koha e Rimbursimit:** Ne lidhje me kohen e procesimit (koha mesatare e miratimit te kerkeses per rimbursim te TVSH-se, nga data e kerkeses deri ne daten miratimit te kerkeses), per periudhen Janar - Dhjetor 2024, jane miratuar dhe rimbursuar **1601 kerkesa FIFO**, koha mesatare e procesimit ka qene **31 dite**, nga **31 dite** qe ishte per 2023, ku **56 %** te kerkesave jane procesuar brenda **30 diteve**. Rreth **43 %** e kerkesave jane procesuar brenda afatit **60-ditore**.

Duhet theksuar se **1 %** e kërkesave janë procesuar mbi **120 dite** dhe kryesisht arsyeja ka qene mospagimi i detyrimeve per “**1900, Kontributet e Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore**”, nga ana e tatimpaguesve.

**Stoku me 31.12.2024:** Stoku i rimbursimeve per kërkesat e miratuara dhe te pa likujduara nga administrate tatimore, ne date 31.12.2024, ishte 1.411,597,480 leke. Stoku analitik si me poshte:

DRT	Nipti	Subjekt	Lloji aktivitetit	Stoku 31.12.2024	Komente
DTM	K43128401L	BANKERS PETROLEUM ALBANIA LTD	Eksportues	1.411.597.48 0	Pezulluar subjekt nen hetim

Administrata Tatimore i qëndroi objektivit që kishte në fillim të vitit 2024 duke mbajtur stokun e rimbursimit të TVSH-së në mbyllje të vitit 2024. Gjithashtu, kërkesat FIFO u rimbursuan të gjitha në afat duke mos krijuar stok në fund të këtij tremujori.

**Kërkesat ne proces:** Deri ne date 31.12.2024 ne Drejtorine e Rimbursimit rezultojne se jane ne proces ne total rreth **258 kërkesa** (nga 145 kërkesa qe rezultonin ne 2023), me nje rritje ne numer rreth 71 % krahasuar me 2023 :

Kërkesat ne proces te regjistruara sipas viteve		
Viti	Numri i kërkesave	Vlera e Kërkesave (000 leke)
2018	1	5
2019	2	45
2020	4	11,193
2021	4	10,522
2022	2	1,351
2023	6	27,721
2024	239	8,256,288
<b>Total</b>	<b>258</b>	<b>8,307,125</b>

Kërkesat ne proces per vitin 2024 rezultojne 123 kërkesa te aplikuar ne muajin dhjetor 2024 ndersa pjesa tjeter rezultojne per detyrimet e Sigurimeve Shoqerore dhe ne proces kontrolli.

**Marreveshjet me Keste:** DPT, ne mbeshtetje te ligjit Nr.9920, date 19.05.2008, "Per procedurat tatimore ne Republiken e Shqiperise", i ndryshuar, si dhe te VKM Nr. 146, date 13.02.2020 "per procedurat dhe kriteret e marreveshjes per pagesen me keste te Tatimit mbi Vleren e Shtuar, te miratuar

per rimbursim", ka miratuar Urdherin, Nr 20, date 02.03.2020, per miratimin e formatit te projekt-marreveshjes "Per Pagesen me Keste te Tatimit mbi Vleren e Shtuar, te Miratuar per Rimbursim".

**Per vitin 2024 eshte arritur marreveshje me keste per tatimpaguesin BANKERS PETROLEUM ALBANIA LTD.**

- I. Ndryshime Neni 10 "Përcaktimi i kategorisë së eksportuesve për qëllim të rimbursimit të TVSH-së";

Ne Zbatim te Planit Operacional 2021 DRTVSH paraqiti propozimet per ndryshimet te Nenit 10 "Përcaktimi i kategorisë së eksportuesve për qëllim të rimbursimit të TVSH-së", në VKM Nr. 953 datë 29.12.2014 "Për dispozitat zbatuese të ligjit nr. 92/2014, datë 24.07.2014 Për tatimin mbi Vlerën e Shtuar" i ndryshuar, për të thjeshtuar dhe saktësuar kategoritë e eksportuesve si edhe afatet respektive të rimbursimit, mbështetur edhe në rekomandimet e KLSH-se.

Domosdoshmëria për saktësimin e nenit 10 të VKM të sipërcituar, erdhi si nevojë e:

- Zbatimit të rekomandimeve të FMN për të lehtësuar kategorinë e eksportuesve për të dhënë rimbursimin e TVSH-së automatikisht pa procedure kontrolli per kategorite pa risk;
- Zbatimit e rekomandimeve/gjetjeve të auditit të KLSH-së për vitin 2018 dhe 2019 ku shprehin paqartësi në kategorizimin e kërkesave të bëra nga personat eksportues të klasifikuar me Risk Zero;
- Implementimit të platformës dixhitale të rimbursimit të TVSH-së, e cila e do automatizojë të gjithë procesin duke shmangur shkëmbimin apo/dhe dorësimin shkresor të dokumentacionit siç parashikohet në nenin 10 të VKM-së aktuale, pika 1, gëra C;
- Legjitimitit të përfshirjes së elementëve të hetimit tatimor, me propozim nga MFE, në analizën e riskut të përcaktuar në rregulloren e rimbursimit.

[Publikimi i Stokut të Rimbursimit të TVSH-së;](#)

Ne zbatim te urdherit Nr. 28, date 08.04.2020, nr. 6380 Prot, ne mbeshtetje te Ligjit nr. 9920, date 19.05.2008, "Per procedurat tatimore ne Republiken e Shqiperise", i ndryshuar dhe Ligjit nr. 92/2014, "Per Tatimin mbi Vleren e Shtuar ne Republiken e Shqiperise", Drejtoria e Rimbursimit

te TVSH-se cdo tre muaj pergatit dhe publikon nje raport te detajuar statistikor lidhur me ecurine e procesit te rimbursimit per tremujorin per treguesit:

- Numrin e pergjithshem te kerkesave te trajtuara;
- Numrin e kerkesave te refuzuara;
- Vlera e rimbursimeve te ndara sipas tatimpaguesve me keste dhe FIFO;
- Stoku i rimbursimeve i detajuar sipas tatimpaguesve me keste dhe te tjere.

Publikimi i ka vijuar sipas planit, ne website e DPT.

[Automatizimi i sistemit te trajtimit te kerkesave per rimbursim.](#)

Platforma dixhitale e rimbursimit e cila u vendos ne funksion ne fillim te vitit 2022, ka ulur kohen e trajtimit të kerkesave duke garantuar trajtimin sipas radhës dhe ka mundesuar gjurmimin e kërkësës në çdo kohë dhe llogaritjen e kamatvonesave (interesit) per kerkesat e miratuara dhe te pa rimbursuara ne kohe. Gjate vitit 2024 jane mbajtur komunikime me kompanine zhvilluese lidhur me implementimin e platformes.

[Rimbursimi i TVSH-se sipas per projektet e kryeara ne kuader te marreveshjeve financiare te ratifikuara nga Kuvendi.](#)

Ne zbatim të ketij neni te Ligjit, ne nenet 63/1 dhe 63/2 te Udhezimit nr.6 date 30.01.2015 “Per Tatimin mbi vleren e shtuar”eshte parashikuar procedura e përjashtimit në import dhe trajtimit si furnizim i përngjashëm me eksportet për marrëveshjet e donacionit / grantit me donatorët dhe granteve nga Bashkimi Evropian.

**Bazuar ne nenin 63 “Rimbursimi për marrëveshjet financiare”, gjate vitit 2024 jane pranuar dhe rimbursuar 4 kerkesa per rimbursim te OJF-ve me vlere 11.226.648 leke.**

## IX. DREJTORIA E VERIFIKIMIT DHE KOORDINIMIT NË TERREN NË DPT

### Organizimi

Drejtorja e Verifikimit dhe Koordinimit në Terren (DVKT), është e organizuar dhe ushtron veprimtarinë funksionale në zbatim të Urdhërit Nr.69, datë 26.05.2023 i Kryeministrit të Shqipërisë “Për miratimin e strukturës organizative dhe të numrit të përgjithshëm të personelit të administratës tatimore qendrore”.

### Qëllimi

Parandalimi, ndërgjegjësimi, evidentimi dhe goditja e paligjshmërisë në fushën e tatim-taksave për tatimpaguesit që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në Republikën e Shqipërisë. Goditja e evazionit fiskal dhe marrjen e masave administrative përkatëse.


### Objektivat

- Garantimi i përmbushjes vullnetare dhe zbatimi i legjislacionit tatimor;
- Realizimi i detyrave funksionale për kontrollet në terren.
- Trajtimi i listave të ardhura nga Sekretariati I Komitetit të Riskut dhe nga Drejtorja e Menaxhimit të Riskut;
- Përpunimi, analiza dhe ndjekja e listave të tatimpaguesve sipas objektivit të ardhur nga Drejtorja e Menaxhimit të Riskut.
- Verifikimi i tatimpaguesve sipas sektorëve që do të klasifikohen me risk nga Sektori i Analizës dhe Informacionit.
- Mbledhja, analizimi, shpërndarja dhe trajtimi i ankesave të ardhura pranë Sektorit të Trajtimit të Ankesave;
- Ezaurimi i shkresave të ndryshme dhe trajtimi i emaileve të ardhura në drejtori.
- Kontrolle gjatë muajit Dhjetor 2024 në kuadër të festave të fundvitit.
- Bashkëpunime me struktura të tjera ligjzbatuese.


### Realizimet

Rezultatet totale të kontrolleve dhe shkeljeve të kryera për periudhën **Janar – Dhjetor 2024**:

Grafiku 1: Verifikimet dhe Shkeljet e DVKT-së



Grafiku 2: Vlera e Shkeljeve sipas DVKT-ve




Shkeljet kryesore për periudhën **Janar- Dhjetor 2024** renditen, të evidentuara sipas llojit si më poshtë:

- **699** tatimpagues janë penalizuar për moslëshim të faturës tatimore;
- **223** tatimpagues janë penalizuar pasi janë konstatuar me punonjës të padeklaruar, nga të cilët 90 subjekte janë të përgjegjësishë tatimore “biznes i madh” dhe 133 subjekte janë të përgjegjësishë tatimore “biznes i vogël”;

- **136** tatimpagues janë konstatuar se dispononin mallra pa dokumentacion tatimor;
- **106** subjekte të paregjistruara në organin tatimor;
- **98** tatimpagues të penalizuar për mosinstalim të sistemit të fiskalizimit;
- **102** tatimpagues janë konstatuar se nuk ishin te pajisur me çertifikate elektronike nga AKSHI;
- **415** shkelje të tjera të legjislacionit tatimor të konstatuara.

Grafiku 3: Shkeljet kryesore të DVKT-së



Krahas verifikimeve me qëllim kontrolli të mbajtura nga Sektori i Verifikimit dhe Monitorimit në Terren, gjatë vitit 2024 janë kryer gjithashtu dhe verifikime me qëllim këshillimi konkretisht:

- Gjatë muajit Dhjetor 2024 fokus kryesor ka patur sensibilizimi i Tatimpaguesve me qëllim ndërgjegjësimin për vetëdeklarim real të pagës ku janë trajtuar 1197 subjekte.
- Sensibilizimi I tatimpaguesve që ushtrojnë aktivitet gjatë Sezonit Turistik.
- Sensibilizimi i Tatimpaguesve gjatë festave të fundvitit.

Gjatë vitit 2024 rezultojnë 750 shkresa hyrëse, të cilat janë trajtuar nga Drejtoria e Verifikimit në Terren sipas lëndës së përcaktuar.

#### Krahasimore e kontrolleve gjatë vitit 2023 me vitin 2024

*-Drejtoria e Verifikimit dhe Koordinimit në Terren gjatë muajit **Janar-Dhjetor 2023** ka arritur rezultatet në total:*

*Sipas Rajoneve*

Drejtoria e Verifikimit dhe Koordinimit ne Terren	Janar-Dhjetor 2023 (Totali)			
DVKT	Verifikime	Shkelje	Vlerë	Efektiviteti
Task Forcë	828	121	7,910,000	15%
Rajoni Qendror	2,497	397	29,250,000	16%
Rajoni Jugor	1,890	355	13,410,000	19%
Rajoni Verior	68	36	2,400,000	53%
<b>Total</b>	<b>5,283</b>	<b>909</b>	<b>52,970,000</b>	<b>17%</b>

*Drejtoria e Verifikimit dhe Koordinimit në Terren gjatë muajit Janar-Dhjetor 2024 ka arritur rezultatet në total:*

*Sipas Rajoneve*

Drejtoria e Verifikimit dhe Koordinimit ne Terren	Janar-Dhjetor 2024 (Totali)			
	Verifikime	Shkelje	Vlere	Efektiviteti
DPT	656	239	11,750,000	36%
Rajoni Jugor	1,680	589	34,575,000	35%
Rajoni Qendror	1,779	796	43,540,000	45%
Rajoni Verior	379	155	7,250,000	41%
<b>Total</b>	<b>4,494</b>	<b>1,779</b>	<b>97,115,000</b>	<b>40%</b>

**Për sa më sipër gjatë vitit 2024 vëmë re efektivitet më të lartë të kontrolleve në raport me shkeljet krahasuar me vitin 2023:**

- Viti 2024    40%
- Viti 2023    17 %

**Për sa më sipër kemi një rritje të efektivitetit nga viti 2023 në vitin 2024 me 23%.**

✓ *Verifikime në kuadër të Sezonit Turistik 2024:*

Drejtoria e Verifikimit dhe Koordinimit ne Terren	Qershor-Gusht 2024 (Totali)			
DVKT	Kontrolle	Shkelje	Vlerë	Efektiviteti
Task Forcë	233	84	5.060.000	36%
Rajoni Jugor	823	355	23.695.000	43%
Rajoni Qendror	744	335	18.960.000	45%
Rajoni Verior	198	101	5.090.000	51%
<b>Total</b>	<b>1.998</b>	<b>875</b>	<b>52.805.000</b>	<b>44%</b>

- ✓ Verifikime në zbatim të Vendimit nr 25 të Sekretariatit të Riskut për Tatimpaguesit që janë me risk nëndeklarimi të pagës reale:

DVKT/DRT	Verifikime	Shkelje	Vlere
<b>Rajoni Jugor</b>	<b>299</b>	<b>8</b>	<b>875,000</b>
Berat	47	3	375,000
Fier	107	2	175,000
Gjirokaster	37	1	200,000
Sarande	36	2	125,000
Vlore	72		
<b>Rajoni Qendror</b>	<b>810</b>	<b>81</b>	<b>5,040,000</b>
Durres	135	19	1,070,000
Elbasan	94	12	545,000
Korce	99	6	335,000
Tirane	482	44	3,090,000
<b>Rajoni Verior</b>	<b>88</b>	<b>1</b>	<b>200,000</b>
Diber	12		
Kukes	15		
Lezhe	18	1	200,000
Shkoder	43		
<b>Total</b>	<b>1197</b>	<b>90</b>	<b>6,115,000</b>

#### Denoncime/Ankesa

Sektori i Trajtimit të Ankesave për periudhën 1 Vjeçare Janar – Dhjetor 2024, ka regjistruar në total 603 Raste, më konkretisht:

Nr.	Forma e marrjes së denoncimit	Nr i denoncimeve të ardhura	Të ezauruara	Të paezuruara
1-	Raste Abuzive (Janar – Dhjetor)	541	505	36
2-	Bashkëqeverisja (Janar – Dhjetor)	62	62	--
	<b>TOTALI</b>	<b>603</b>	<b>567</b>	<b>36</b>

Nga të cilat **Raste Abuzive 541**, të ardhura në forma të ndryshme, më konkretisht nëpërmjet e-mail-it, telefonit fix, telefonit cel, Ëhat's up, takim dhe shkresa, të ardhura këto nga denoncues, Drejtoritë Rajonale, Institucione të tjera, etj. Nga këto 541 denoncime të ardhura deri më 31 dhjetor 2023 janë ezauruar **505 raste**, dhe **36 të tjera janë akoma pa përgjigje**. Për të cilat presim në vazhdim të ezaurohen. Përsa i përket 56 rasteve pa përgjigje, janë të shpërndara sipas drejtorive si më poshtë:

- DVKT në Rajone 25 Raste që do verifikohen
- DHT 9 Raste pa përgjigje, jane në hetim nga Drejtoria e Hetimit Tatimor
- Drejtori e Mbledhjes së Detyrimeve të Papaguara 2 Raste pa përgjigje

Nga Platforma e Bashkëqeverisjes janë regjistruar në total 62 raste të dërguara, nga të cilat janë ezauruar të 62 rastet nga ana e Drejtorive përkatëse sipas shpërndarjes së bërë dhe juridiksionit përkatës.

Përgjatë gjithë vitit 2024 Sektori i Trajtimit të Ankesave, ka marrë dhe dërguar në total 79 shkresa, drejtuar DVKT-ve në Rajone, Drejtorisë së Hetimit, Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Inspektoriatit Shtetëror të Punës, Drejtorisë së Mbledhjes së Detyrimeve të Papaguara etj në varësi të problematikës së trajtuar.

Nga rastet e ardhura në mënyrë analitike denoncimet janë të ndara si më poshtë:

<b>Nr.</b>	<b>Forma e marrjes së denoncimit</b>	<b>Nr i denoncimeve të ardhura</b>	<b>Të ezauruara</b>	<b>Të paezauruara</b>
<b>1-</b>	Me Ëhat's Up	23	23	--
<b>2-</b>	Me Telefon	201	187	14
<b>3-</b>	Me Email	210	199	11
<b>4-</b>	Me Shkresë	58	53	5
<b>5-</b>	Me Takim në ambjentet e DVKT-së	12	10	2
<b>6-</b>	Me Email Ministria e Financave	1	1	--
<b>7-</b>	Me Email DSHT	1	1	--
<b>8-</b>	Me Email Zyra e shtypit DPT	27	25	2
<b>9-</b>	Me Email DMR në DPT	2	2	--
<b>10-</b>	Me Email Koordinator i Antikorrupsionit ne DPT	5	3	2
<b>11-</b>	Me Email Puna Informale	1	1	--

Në lidhje me ndarjet (format e marrjes së denoncimeve) të sipërcituara në rastet e ezauruara janë marrë dhe penalitete të ndara sipas llojit të tyre, më konkretisht:

<b>Nr.</b>	<b>Lloji i penalitetit</b>	<b>Nr i penaliteteve të vendosura</b>
<b>1</b>	Bllokim aktiviteti	40
<b>2</b>	Mosdeklarim punonjësi	22
<b>3</b>	Moskryerje fiskalizimi	29
<b>4</b>	Mosmbajtje dokumentacioni	22
<b>5</b>	Moslëshim fature, bilete	65
<b>6</b>	Mospërditësim adrese/të dhënash	17
<b>7</b>	Mosrinovim Çertifikate nga AKSHI	2
<b>8</b>	Mospagim Tatimi në Burim	3
<b>9</b>	Mall pa faturë	18
<b>10</b>	Mosafishim liste çmimesh, çmime ndryshe nga të afihuarat	4
<b>11</b>	Mospajisje me Çertifikatë Fiskalizimi	14
<b>12</b>	Mosinstalim pajisje fiskale	3
<b>13</b>	Sekuestrim printeri jofiskal	1
<b>14</b>	<b>TOTALI I GJOBAVE</b>	<b>240</b>

Persa i përketë Rasteve Abuzive të pa verifikuara në total 36 raste, jemi në pritje të verifikimit nga ana e DVKT-ve përkatëse dhe drejtorive të tjera.

- Gjatë kësaj periudhë STA është marrë gjithashtu dhe me problematit e ndryshme që subjektet kanë patur me fiskalizimin, ku nga ana jonë janë bërë orjentimet përkatëse për mënyrën se si duhet të procedojnë në lidhje me fiskalizimin.
- Për periudhën e 3 mujorit të fundit, STA-ja është marrë dhe me dhënien e asistencës si pjesë përbërëse e Planit Operacional për Pagën Reale, për qytetarët, punonjësit dhe bizneset e ndryshme kjo për të ndikuar sado pakë në rritjen e deklarimeve të sakta të pagave reale.
- Për muajt nga Marsi e në vazhdim STA është marrë dhe me dhënien e asistencës në lidhje me DIVA-N, më konkretisht gjatë të gjithë muajit në mënyrë konstante në telefonat si fix ashtu edhe atë cel me nr 0800 14 14 kanë ardhur me dhjetra telefonata çdo ditë, të cilat janë ndihmuar nga ana e STA sesi të bënin të mundur dorëzimin e Deklaratës së DIVA-S.
- Përveçse nëpërmjet telefonave, STA ka dhënë asistencë për DIVA-N edhe nëpërmjet adresës së e-mailit të denoncimeve [denoncime@tatime.gov.al](mailto:denoncime@tatime.gov.al), Viber si edhe nëpërmjet takimeve të drejtëpërdrejta të individëve të cilët paraqiteshin në DPT tek Informacioni.

- Përgjatë të gjithë vitit 2023, STA është marrë çdo ditë me ankesat e qytetarëve nëpërmjet linjës së gjelbër në numrin 0800 14 14, duke i dhënë asistencën përkatëse për problematikat e ndryshme për të cilat këta qytetar dhe subjekte telefonojnë, përveç denoncimeve për Evazion Fiskal.
- Sektori i Trajtimit të Ankesave, gjatë vitit 2024, është marrë dhe me dhënin e asistencës duke orjentuar individët dhe subjektet e ndryshme në lidhje me problematikën e Bllokimit të Llogarive nga ana e Drejtorisë së Mbledhjeve të Detyrimeve Tatimore të Papaguara, kjo gjë nëpërmjet të gjitha formave të komunikimit (nëpërmjet e-mail-it, telefonit fix, telefonit cel, takim dhe shkresa).

## X. MARRËDHËNIET ME JASHTË DHE MENAXHIMI I PROJEKTEVE

### Hyrje

Përshkrim i shkurtër i DMJMP

Drejtoria e Marrëdhënieve me Jashtë dhe Menaxhimit të Projekteve (DMJMP) është në varësi të zv.Drejtorit të Përgjithshëm të Mbështetjes së Programeve.

DMJMP organizon dhe koordinon marrëdhëniet dhe bashkëpunimin dypalësh të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve me organizma ndërkombëtarë, në zbatim të aktiviteteve të Administratës Tatimore Shqiptare; siguron harmonizimin dhe koordinimin e të gjitha projekteve me financim të brendshëm apo të huaj që zhvillohen në Administratën Tatimore Shqiptare dhe që ndërlidhen me bashkëpunimin vendas apo ndërkombëtar, përfshirë Administratat Tatimore, Organizatat Ndërkombëtare; koordinon procesin raportues në kuadrin e detyrimeve për integrimin në strukturat e BE-së.

### Detyrat funksionale

Detyrat funksionale të DMJMP-së janë:

- Propozon dhe harton kërkesat për asistencë ndërkombëtare.
- Analizon dhe kontrollon ecurinë e projekteve që zhvillohen në DPT.
- Siguron mbarëvajtjen e bashkëpunimit dhe marrëdhënieve dypalëshe të administratës tatimore me organizmat e huaja.
- Raporton lidhur me proceset e integritit të vendit në BE në strukturat e linjës, Ministrinë e Financave dhe Ministrinë e Integritit Europian.
- Bashkërendon punën me Drejtoritë e tjera në DPT dhe Drejtoritë Rajonale për pjesëmarrjen e personelit të administratës tatimore qendrore në programet dhe trajnimet e zhvilluara nga organizmat ndërkombëtarë si dhe në vizitat e kryera në kuadër të bashkëpunimit dypalësh.

Struktura

Me ndryshimet e strukturës më të fundit organizative të DPT, DMJMP përbëhet nga 1 Drejtor + 2 përgjegjës sektori + 5 inspektorë/specialistë.

Stafi aktual

- Sektori për Marrëdhëniet me Jashtë: 1 përgjegjës sektori, 2 specialistë; 0 vende vakante
- Sektori i Koordinimit të Projekteve: 1 përgjegjës sektori; 3 inspektorë; 0 vende vakante.

## Objektivat për vitin 2024

Objektivat strategjikë të DMJMP

**Objektivi strategjik 3:** Progresi organizativ i Administratës Tatimore dhe zhvillimi i kapaciteteve njerëzore.

**3.1** Aplikimi i metodave dhe sistemeve për të menaxhuar një AT moderne

**3.4** Zhvillimi dhe përmirësimi i partneriteteve

Treguesit kryesore të performancës

- Kontribut në grupin e punës të ngritur për zbatimin e projektit pilot mbi shkëmbimin automatik të informacionit sipas standardeve të OECD.
- Koordinimi i punës me Drejtoritë e përfshira në vitin e 3-të të projektit të asistencës së ofruar nga administrata tatimore e Suedisë.
- Përmirësimi i njohurive të stafit, përmes pjesëmarrjes sa më të gjerë në trajnimet e organizuara nga organizatat ndërkombëtare, vizitave studimore në administratat homologe apo sjelljes së ekspertëve të huaj të fushave të caktuara.
- Menaxhimi dhe koordinimi i kontributit të DPT në procesin e integritit në BE.

## Aktivitetet e programuara dhe realizuara gjatë 2024 në funksion të realizimit të objektivave

Sektori për Marrëdhëniet me Jashtë

- Koordinimi, marrja e informacionit dhe përgatitja e materialeve raportuese në kuadrin e detyrimeve për integrimin në strukturat e BE-së për Kapitullin 16 “Tatimet”.
- Koordinimi, marrja e informacionit dhe përgatitja e materialeve raportuese në kuadrin e detyrimeve për integrimin në strukturat e BE-së për Kapitullin 33 ”Dispozitat financiare

dhe Buxhetore"; Kapitullin 20 "Sipërmarrja dhe Politikat Industriale" ; Kriterin Ekonomik - PAR - Reforma e Administratës Publike, nënkomitetet "Për çështjet ekonomike, financiare dhe statistika" (ECOFIN), "Tregtia, Industria, Doganat dhe Tatimet - (TIDT)", PFM (*Public Finance Management*); *Reform and Growth Facility 2024-2027*, etj.

- Organizimi i trajnimeve ndërkombëtare për stafin AT, ofruar nga partneret e huaj IOTA, CEF, OECD, etj. (Organizuar 30 trajnime *online* dhe fizike).
- Mbledhje e informacionit nga Drejtoritë përkatëse në DPT, plotësimi dhe dërgimi i pyetësorit ISORA.
- Ndjekja e proceseve të Vlerësimeve të OECD-së për Shkëmbimin Automatik të informacionit të Llogarive Financiare (AEOI); për zbatimin e legjislacionit të Raportimit për Çdo Vend.

#### Sektori i Menaxhimit të Projekteve

- Koordinimi i punës për zbatimin e projektit pilot mbi shkëmbimin automatik të informacionit sipas standardeve të OECD.
- Ndjekja e detyrave lidhur me projektin e asistencës suedeze, me të gjitha strukturat e përfshira në DPT/DRT.
- Organizimi dhe koordinimi në DPT i angazhimeve lidhur me asistencën nga FMN dhe organizma të tjerë (Banka Botërore, FMN, etj.).
- Koordinimi i punës (me Drejtoritë e përfshira në DPT) për vlerësimin OECD të efikasitetit të shkëmbimit të informacionit të llogarive financiare (*first round AEOI effectiveness peer review*).

Sa dhe si ndikuan këto aktivitete në arritjen e objektivave të përcaktuara

U përmbyll viti i dytë i zbatimit të projektit 3-vjeçar të bashkëpunimit me Suedinë. Ky Projekt do të kontribuojë drejtpërdrejt në ngritjen e kapaciteteve të administratës sonë, duke dhënë asistencë teknike për 5 Komponentët: Kultura e integritetit, Kontrolli, Menaxhimi i Riskut CRM, Proceset e Biznesit & AEOI.

Gjatë vitit u zhvilluan:

- 2 vizita studimore për komponentin e Kontrollit Tatimor
- 15 Misione fizike në Tiranë
- 11 Takime digitale.

- 2 Webinare
- Po punohet për sondazhin e dytë drejtuar tatimpaguesve.
- Në bashkëpunim me IDM (Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim) u hartua dhe u miratua Plani i Integritetit të Administratës Tatimore Qëndrore dhe Rajonale.

## XI.BURIMET NJEREZORE

### Struktura organizative

Administrata Tatimore Qendrore, ushtron funksionimin e saj në zbatim të **Strukturës Organizative të miratuar me** Urdhrit nr. 69, datë 26.05.2023 të Kryeministrit “Për miratimin e strukturës organizative dhe të numrit të përgjithshëm të personelit të Administratës Tatimore Qendrore”, Urdhrit Nr. 189 datë 08.08.2023 “Për miratimin e Organigramës së Administratës Tatimore Qëndrore” të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë, **solli ndryshime në organizimin e strukturës së Administratës Tatimore Qëndrore.**

❖ Këto ndryshime në strukturën organizative janë të domosdoshmë për përmirësimin funksional të punës në kuadër të qëllimit dhe realizimit të objektivave që ka administrata tatimore qendrore, për përmirësim e shërbimeve ndaj tatimpaguesve, thjeshtimit të procedurave tatimore, përmirësimin të klimës bashkëpunuese me biznesin dhe garantimit në një nivel tjetër të një autonomie funksionale të administratës tatimore, konform me programin politik të Këshillit të Ministrave.

❖ Ndryshimi i propozuar i strukturës konsiston pas një analize të bërë për një periudhë 2-vjeçare të funksionimit të administratës tatimore pas ristrukturimit të vitit 2020, detyrë kjo e lënë dhe nga institucionet audituese e kontrolluese si Kontrolli i Lartë i Shtetit etj, të cilat kanë rekomanduar që të gjitha drejtoritë e krijuara rishtazi si dhe ato që pësuan ndryshime thelbësore duhet të vlerësohen dhe shikohen për mirëfunksionimin e tyre, efijencën në përmbushjen e objektivave në raport me qëllimin që ka kjo administratë.

❖ Ndryshimet strukturore, në zbatim të Urdhrit nr. 69, datë 26.05.2023 të Kryeministrit “Për miratimin e strukturës organizative dhe të numrit të përgjithshëm të personelit të Administratës Tatimore Qendrore”, që erdhën si pasojë dhe në zbatim të Rekomandimeve të FMN-së dhe Rekomandimeve të KLSH-së, të cilat nuk ndikuan në numrin e përgjithshëm të personelit të ATQ, mbeten 1450 numër plan punonjësish/nëpunësish, nga të cilët 1127 janë pozicione pune me status të nëpunësit civil dhe 323 pozicione pune janë pozicione marrëdhëniet e të cilëve rregullohen sipas Kodit të Punës.

Gjithashtu me implementimin e strukturës organizative në Maj 2023 si dhe shpërndarjes së burimeve njerëzore janë verifikuar dhe pasqyruar në databazë në vijimësi për të cilat u krye planifikimi i vendeve vakante të cilat do të vijojnë me shpalljet sipas kalendarit që DAP vendos për shpalljet në cilësinë e institucionit përgjegjës.

Në kuadër të kryerjes së veprimtarisë funksionale, Komisioni i Posaçëm, si dhe në zbatim të rekomandimeve të KLSH, mbi kontrollin e ushtruar pranë DPT-së, është minimizuar numri i praktikave gjyqësore, ku në databazën e gjyqfituesve deri aktualisht rezultojnë 61 praktika të paekzekutuara. Me qëllim përmbushjen e detyrimeve ligjore Komisioni i Posaçëm ka zhvilluar mbledhje për sistemimin e Gjyqfituesve, por aktualisht Institucioni po i nënshtrohet procesit të ristrukturimit, ku me Urdhrin nr. 69, datë 26.05.2023, të Kryeministrit është miratuar struktura dhe organika e re e Administratës Tatimore Qendrore. Praktikave gjyqësore të paekzekutuara do të shqyrtohen nga Komisioni i Posaçëm pas ristrukturimit, i cili i trajton praktikave në varësi të disa faktorëve sic janë vendet vakante në dispozicion në përputhje me kualifiket dhe kriteret e vecanta të pozicionit të punës sipas përshkrimeve të reja.

#### Aktivitetet në vitin 2024

1. Hartimi i **planeve vjetore të rekrutimit**; nevojave për personel të përkohshëm; vlerësim i punës dhe performancës; cdo 6 muaj. (Realizuar)

2. **Rishikimi i Treguesve Kyç të Performancës** - të paktën 2 herë në vit. Produkt: Matja e efektivitetit dhe efikasitetit të strukturave të reja të krijuara apo riorganizuar, në bashkëpunim me Drejtoritë përkatëse, mbi bazë të KPI.

Realizuar për 6 muajin e parë të 2024 dhe në proces për 6 muajin e dytë 2024 për nxjerrjen e rezultatit të përfundimtarë pas dërgimit të të dhënave nga të gjitha Drejtoritë në DPT dhe Drejtoritë Rajonale Tatimore.

Me shkresën nr. 10832 prot., datë 13.06.2024, është kërkuar matja e KPI për 6 muajin e parë të vitit 2024 për strukturat e kontrollit tatimor dhe borxhit tatimor, ka përfunduar ky proces për strukturat e kontrollit dhe sipas Rajonave për borxhin. Me shkresën nr. 20328 prot., datë 12.12.2024 është kërkuar matja e KPI për 6 muajin e dytë të vitit 2024 për strukturat e kontrollit tatimor dhe borxhit tatimor proces në fazën përfundimtare.

3. **Hetimi administrativ dhe ndjekja e procedimeve** (vjetore).

Për vitin 2024 janë trajtuar 97-fillime ecurie disiplinore (Total) sipas procedurave të përcaktuara në Ligjin nr: 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe akteve nënligjore në zbatim të tij për nëpunës pjesë e shërbimit civil dhe sipas Rregullores Nr. 10, datë 30. 01.2020 “Për marrëdhëniet e punës të personelit jo nëpunës civil në administratën tatimore qendrore”.( Në vijim tabela dhe të dhënat për rezultatet)

### Trajnimi dhe ngritja e kapaciteteve te burimeve njerezore

Gjatë vitit 2024 janë trajnuar gjithsej **690 punonjës**, në zbatim të plotë të programit vjetor të trajnimeve për vitin 2024 të miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve, me Vendimin nr.63, datë 29.12.2023 ”Për Miratimin e Programit Vjetor të Trajnimit të Administratës Tatimore Qendrore për vitin 2024”, si dhe programin e trajnimeve të miratuar me Urdher nr. 1 datë 08.01.2024 nga Bordi i MFE (Akademisë Fiskale), bazuar në kalendarin e trajnimeve sipas temave të miratuara, në bashkëpunim me QTATD/ASPA.

1. Zbatimi i plotë i programit të trajnimit për vitin 2024 përfshin:
  - a. Trajnimin e nëpunësve/punonjësve të rinj dhe punonjësve ekselent të rekrutuar në Administratën Tatimore gjatë vitit 2024. Temat e trajnimit të zhvilluara sipas kalendarit që lidhen me përfitimin e njohurive bazë për çështjet tatimore (shërbimin tatimpagues, mbledhjen me forcë, kontrollin tatimor etj), organizimin e Administratës Tatimore, marrëdhëniet e punës në Administratën Tatimore , kodin e etikës, konfliktin e interesit si dhe për mashtrimet në fushën e tatimeve (evazioni fiskal), për njohuritë bazë për legjislacionin e taksave nacionale dhe lokale etj.
  - b. Trajnimin e nëpunësve ekzistues për temat e trajnimit të zhvilluara sipas kalendarit të miratuar nga QTATD (bordi MFE) që lidhen me çështjet tatimore dhe legjislacionin tatimor në tërësi si dhe tema në lidhje me evazionin fiskal në fushën e tatimeve .
  - c. Trajnimi i nivelit funksional (punonjes ne funksion) për menaxhimin e punës i zhvilluar pranë QTATD me temat e trajnimit sipas kalendarit të trajnimeve, por edhe trajnime të ndjekura online nga stafi sipas programit të trajnimit të ASPA.
  - d. Trajnimi i punonjësve të strukturave të Hetimit Tatimor dhe Verifikimit në Terren për legjislacionin tatimor.

## Realizmi i programit trajnimeve per vitin 2024

DPT/QTATD			
PËRMBLEDHËSE E TRAJNIMEVE 2024 (TATIME)			
Tatimet			
Periudha	Të trajnuar	Tema	Orë
<b>Janar 2024</b>			
Shkurt 2024	65	1	24
Mars 2024	33	4	54
Prill 2024	54	6	84
Maj 2024	115	7	48
Qershor 2024	47	3	18
Korrik 2024	11	1	12
<b>Gusht 2024</b>			
Shtator 2024	133	3	36
Tetor 2024	104	3	30
Nentor 2024	98	2	36
Dhjetor 2024	30	1	12
<b>Totali</b>	<b>690</b>	<b>31</b>	<b>354</b>
<b>Totali të trajnuar (tatime)</b>	<b>690</b>		
<b>Totali temat (tatime)</b>	<b>31</b>		
<b>Totali orë (tatime)</b>	<b>354</b>		

### Trajnime të tjera jashtë programit të planifikuara dhe zhvilluara janë :

1. Zhvillimi i trajnimeve të tjera bazuar në nevojat e strukturave të hetimit tatimor në bashkëpunim me institucionet e pavarura (Prokurorinë) me temë: “Evazioni fiskal në fushën e tatimeve”.
2. Trajnime pranë MFE, me strukturën e auditimit, trajnim për kontabilitetin me strukturën e statistikës dhe kontabilitetit.

3. Trajnime pranë ASPA për tema specifike të kërkuara nga DPT: “Certifikatë e sigurisë” si dhe trajnime të tjera sipas programit të trajnimeve për vitin 2024.
4. Në bashkëpunim me QTATD/ASPA, për vitin 2024 përfundoi trajnimi dhe testimi për 18 nëpunës në periudhë prove, të cilët kaluan testimin dhe kanë përfituar certifikatën pranë ASPA dhe QTATD.
5. Tajnime me palen suedeze ne vijim te projektit te bashkepunimit 3 vjecare si dhe ne miratim te planit integritetit te administrates tatimore qendrore.

Për vitin 2025 janë evidentuar nevojat për trajnim dhe Drejtori i Përgjithshëm me vendim ka miratuar programin e trajnimeve duke përcaktuar drejtimet e synuara, organizimin dhe intsitucionet e bashkëpunimit për zhvillimin e tij. Programi i trajnimit për vitin 2025 është përcjellë me shkresën nr. 21642/1, datë 31.12.2024, pranë QTATD dhe ASPA me qëllim paraqitjen për miratimin e programit të trajnimeve nga Bordi i Akademisë Fiskale, pranë MFE.

## Masat disiplinore

### **a. Procedura disiplinore të filluara dhe përfunduara në 2024.**

Në lidhje me procedurat disiplinore të trajtuara për vitin 2024, janë filluar ecuritë disiplinore për 97 nëpunës/punonjës të administratës tatimore qendrore.

Janë shqyrtuar dhe zbardhur vendimet përfundimtare nga Komisioni i Disiplinës për 69 ecuri disiplinore për nëpunës civil që trajtohen sipas dispozitave të ligjit mbi shërbimin civil, vendime të cilat janë përcjellë nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore organeve kompetente brenda afateve të parashikuara në ligj.

Nga eprorët direkt janë trajtuar gjithsej 20 (njëzet) masa disiplinore.

Për punonjës që trajtohen me dispozitat e Kodit të Punës janë zbardhur gjithsej 18 vendime sipas procedurave të përcaktuara në Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve, Nr. 10, datë 31.01.2020 “Për miratim e Rregullores për marrëdhëniet e punës të personelit jo nëpunës civil në Administratën Tatimore Qendrore”.

Në mënyrë të detajuar trajtohen në tabelën e mëposhtme:

## Procedimet disiplinore ne Administraten Tatimore

VENDIME TE DHENA GJATE VITIT 2024	
Vendime te vitit 2024	Per ecuri 2024
<b>A. Masa te dhena per punonjes te sherbimit civil:</b>	<b>51</b>
1 Largim nga Sherbimi Civil	8
2 Mbajtje page	0
3 Pezullim ngritje ne detyre	3
4 Nxjerrje jashte juridiksioni	0
5 Verejtje	20
6 Ndërprerje e Ecurisë disiplinore	20
<b>B. Masa te dhena per punonjesit me Kod Pune:</b>	<b>19</b>
1 Zgjidhje e menjehereshme e kontrates se punes	9
2 Verejtje me shkrim	8
3 Verejtje me paralajmerim	1
4 Ndërprerje e Ecurisë disiplinore	1
<b>GJITHSEJ</b>	<b>70</b>
<b>Në proces</b>	<b>27</b>
<b>TOTAL FILLIM ECURIE DISIPLINORE</b>	<b>97</b>

Ndërkohë Komisioni i Disiplinës gjatë vitit 2024 ka zbardhur 14 vendime përfundimtare për procedura disiplinore të nisura në vitin 2022 dhe 2023. Nga këto:

- 5 vendime Ndërprerje ecurie disiplinore
- 4 vendime Largim nga shërbimi civil
- 1 vendime Mbajtje page
- 3 vendime Pezullin nga e drejta ngritjes ne detyre
- 1 vendime Nxjerrje jashtë juridiksioni

[Te dhenat per vleresimet e rezultateve ne pune per vitin 2024](#)

Për gjashtë mujorin e parë të vitit 2024 procesi i vlerësimit të rezultateve të punës, është përmbyllur për nëpunësit e administrates tatimore, konform procedurave të përcaktuara në ligjin Nr.152, datë 30.05.2013, “Për nëpunësit civil”, dhe VKM 109, datë 03.05.2014, i ndryshuar, me VKM Nr. 252/2016.

### 1. Vlerësimet e nëpunësve civil në Administratën Tatimore 6 –mujori I 2024

Nr	Pozicioni punes	Gjithsej	Niveli i vlerësimit			
			Shume mire (1)	Mire (2)	Kenaqshem (3)	Jo kenaqshem (4)
1	Inspektor	<b>526</b>	64	460	2	0
2	Specialist	<b>174</b>	35	138	1	0
3	Përgjegjës Sektori	<b>92</b>	40	52	0	0
4	Drejtor Drejtorie	<b>28</b>	14	14	0	0
5	Drejtor Rajonal	<b>17</b>	0	17	0	0
6	Zv.Drejtor i Përgjithshëm	<b>2</b>	2	0	0	0
	<b>GJITHSEJ</b>	<b>839</b>	<b>155</b>	<b>681</b>	<b>3</b>	<b>0</b>

Procesi i vlerësimit të punës për 6-mujorin e dytë të vitit 2024, për nëpunësit civil si dhe për strukturat të cilat trajtohen sipas dispozitave të Kodit të Punës, është në proces përfundimi dhe do vijohet me administrim në dosjet e personelit.

## XII. BUXHETI DHE FINANCA

Në zbatim të Ligjit Nr.84/2022 “Për buxhetin e vitit 2023”, të Udhëzimit Nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, të Udhëzimit plotësues Nr.2, datë 19.01.2023 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2023”, si dhe në bazë të miratimit të tavaneve buxhetore nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Drejtoria e Financës dhe Buxhetit ka zbatuar me rigorozitet tërësinë e shpenzimeve korrente dhe kapitale për Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve duke përmbledhur dhe Drejtoritë Rajonale.

Buxhetimi dhe shpenzimet e tyre janë realizuar përkatësisht në zërat e mëposhtëm :

- Zëri 600 “Paga, shpërblime dhe të tjera shpenzime personeli” përgjatë vitit 2024 është 1,648,058,305lekë;
- Zëri. 601 “Sigurime Shoqërore dhe Shëndetësore” përgjatë vitin 2024 është 273,194,845lekë
- Zëri 602 “Shpenzime operative” përgjatë vitin 2024 është 705,548,407 lekë;

### Shpenzimet faktike-Viti 2024

N r	Kod Qarku	RRETHET	Pagat	Kontribute Sig.Shoqero re	Shpenzime operative	Shpenzime te tjera	Plan 12m-2024	Fakti 12 M 2024	real izi mi ne %	
1	1010042	02 02	BERAT	35,447,595	5,869,586	3,261,614	125,200	45,595,200	44,703,995	98
2	1010046	06 06	DIBER	34,527,686	5,703,807	2,329,849	391,400	43,695,400	42,952,742	98
3	1010047	07 07	DURRES	100,205,920	16,726,299	3,272,260	339,740	123,466,740	120,544,219	98
4	1010048	08 08	ELBASAN	70,978,376	11,871,648	4,841,656	30,000	87,930,000	87,721,680	100
5	1010049	09 09	FIER	86,725,110	14,402,979	5,169,200	269,000	109,219,000	106,566,289	98
6	1010051	11 11	GJIROKASTER	35,314,394	5,871,386	3,081,949	268,000	44,955,000	44,535,729	99
7	1010055	15 15	KORÇË	71,346,514	11,915,376	4,447,508		88,263,000	87,709,398	99
8	1010058	18 18	KUKES	27,583,591	4,543,585	3,578,389		36,128,000	35,705,565	99
9	1010060	20 20	LEZHE	40,269,547	6,692,491	5,286,295	125,200	54,088,200	52,373,533	97
10	1010071	37 31	SARANDE	33,365,900	5,554,221	4,267,333	211,200	44,311,200	43,398,654	98
11	1010073	33 33	SHKODER	69,748,806	11,624,205	3,798,644		86,925,000	85,171,655	98
12	1010076	37 37	VLORE	57,617,283	9,612,558	2,946,789	267,545	71,517,325	70,444,175	98
13	1010318	35 35	DVKT QENDROR	73,023,615	12,175,227	2,079,393		87,416,000	87,278,235	100
14	1010319	33 33	DVKT VERIOR	26,631,401	4,422,899	2,067,557		34,055,000	33,121,857	97
15	1010320	09 09	DVKT JUGOR	30,893,295	5,469,960	3,941,027		40,364,000	40,304,282	100

16	1010321	35 35	DMDTP QENDROR	75,353,627	12,454,212	7,623,561	335,365	96,190,365	95,766,765	100
17	1010322	33 33	DMDTP VERIOR	19,853,363	3,287,486	2,825,260	30,000	30,218,000	25,996,109	86
18	1010323	09 09	DMDTP JUGOR	25,320,104	4,232,837	1,826,460		37,100,000	31,379,401	85
19	1010040	35 35	TIRANA Deg.1	213,147,412	34,999,822	11,198,526	1,035,639	261,756,279	260,381,399	99
20	1010041	35 35	TIR Deg.VIP	152,513,214	25,427,472	11,517,803	142,800	190,670,800	189,601,289	99
21	1010039	35 35	Drejt.Pergj.Tat	368,191,552	60,336,789	616,187,334	82,642,468	1,376,742,491	1,127,358,143	82
				1,648,058,305	273,194,845	705,548,407	86,213,557	2,990,607,000	2,713,015,114	91

## Numri i punonjesve ne Administraten Tatimore ne vitin 2024

Nr		Kod	RRETHET	Nr. Pun.Plan	Nr.Pun.Fakt
		Qarku			
		00 00			
1	1010042	02 02	BERAT	32	26
2	1010046	06 06	DIBER	28	25
3	1010047	07 07	DURRES	86	72
4	1010048	08 08	ELBASAN	57	53
5	1010049	09 09	FIER	70	59
6	1010051	11 11	GJIROKASTER	29	26
7	1010055	15 15	KORÇË	57	52
8	1010058	18 18	KUKES	27	21
9	1010060	20 20	LEZHE	36	32
10	1010071	37 31	SARANDE	29	23
11	1010073	33 33	SHKODER	58	47
12	1010076	37 37	VLORE	47	43
13	1010318	35 35	DVKT QENDROR	65	62
14	1010319	33 33	DVKT VERIOR	27	24
15	1010320	09 09	DVKT JUGOR	27	27
16	1010321	35 35	DMDTP QENDROR	84	71
17	1010322	33 33	DMDTP VERIOR	19	16
18	1010323	09 09	DMDTP JUGOR	29	24
19	1010040	35 35	TIRANA Deg.1	189	152
20	1010041	35 35	TIR Deg.VIP	127	110
21	1010039	35 35	Drejt.Pergj.Tat	327	276
				1,450	1,241

### XIII. DREJTORIA E SHERBIMEVE MBESHTETESE

#### SEKTORI I BRENDSHËM

Në zbatim të Ligjit Nr.10296, datë 08.07.2010 “ Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” dhe Udhëzimin e Ministrit të Financave Nr. 30, datë 27.12.2011, *për Sektorin e Shërbimeve të Brendëshme janë ndjekur Kontratat e Dokumentacionit Tatimor të cilat janë realizuar deri me 31.12.2024 si me poshtë:*

**Realizimi i kontratës për vitin 2024 të biletave të transportit rrugor me "Shtypshkronjën e Letrave me Vlerë"**

#### **Kontrata Nr.630/2 prot., date 15.01.2024 dhe Amendim kontrate Nr.630/6 date 11.12.2024**

Nr.	Emërtimi	Njësia	Sasia	Realizimi	Mbetja	Realizimi në %
1	Bileta Transporti Urban 40 lekeshe	blloqe	666.600	640.000	26.600	96%
	Bileta Transporti Urban 30 lekeshe	blloqe	12.400	12.400	0	100%
Nr.	Emërtimi	Njësia	Sasia	Realizimi		Realizimi në %
2	Bileta të Pajtimit Mujor (Abone)	copë	1.190.618	1.160.727	29.891	97.5%

Realizimi i kontratave per vitin 2024 të pullave të taksës dhe tarifës me "Shtypshkronjën e Letrave me Vlerë"Kontrata Nr.628/2 prot., date 15.01.2024

Emertimi	Sasia ne kontrata	Terhequr (Realizimi)	Pa realizuar	Realizimi në %
Pulla takse 50 leke	630,100	308,700	321,400	49%
Pulla tarife 750 leke	43,200	43,200	0	100%
Pulla takse 100 leke	459,000	306,000	153,000	67%
Pulla tarife 200 leke	1,176,400	936,000	204,400	79.5%
Pulla tarife konsullore 200 leke	680,000	680,000	0	100%
Pulle konsullore 1 euro	3,400	3,400	0	100%
Pulle konsullore 10 euro	17,000	17,000	0	100%
Pulle konsullore 20 euro	25,500	17,000	8,500	67%
Pulle konsullore 30 euro	34,000	34,000	0	100%

## SEKTORI I PROKURIMEVE

Në zbatim të ligjit të buxhetit Nr. 97/2023 Prot., “Për buxhetin e vitin 2024”, të Udhëzimit Plotësues Nr.1, datë 24.01.2024,“Për zbatimin e buxhetin e vitin 2024”, mbështetur dhe në Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimet Publike”, i ndryshuar dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, Kreu II, Neni 3, bashkëlidhur.

Ju bëjmë me dije ecurinë e realizimit të procedurave të prokurimit dhe realizimin e dokumentacionit tatimor deri më datë 31.12.2024.

Bazuar në parashikimet e regjistrit të prokurimeve të vitit 2024, deri në 31.12.2024, janë realizuar dhe mosrealizuar procedurat e mëposhtme:

<i>Nr</i>	<i>Objekti prokurimit 602</i>	<i>Fondi limit pa tvsh</i>	<i>Lloji procedurës</i>	<i>Realizimi 12/mujorit me tvsh</i>	<i>Statusi procedurën e prokurimit</i>	<i>Organi qe zhvillon procedurën e</i>
1	Shpenzime për mirëmbajtje të mjeteve të transportit	5 000 000	Marrëveshje Kuader Vilnik Motors, L01314031G MK 156/9 date 20.10.2022 per dy vjet.	1 999 680	Minikontrata Nr. 9191/4 dt 20.06.2024 Minikontrat Nr. 16156/4 dt.15.10.2024	ASHPP
2	Shpenzime blerje, gome	3 333 333	Marveshjes Kuader nr.25/10 prot., date 28.07.2023, per dy vite me fitues: Tires-R M12413025K	1 353 600	Minikontrat Nr. 12084/2 dt. 05.08.2024	ASHPP
3	Shpenzime blerje (Tонера)	13 750 000	Marveshjes Kuader nr.14/60 prot., date 15.04.2022, per dy vite me fitues: InfoSoft office J62426002Q	7 680 820	Minikontrata 1665/4 date 19.03.2024	ASHPP
4	Shpenzime blerje (leter)	12 500 000	Marveshjes Kuader dy vjecare Nr.143/14, datë 26.09.2022: BOE InfoSoft offic J62426002Q & Interlogistic K21605003M	14 962 257	Minikontrata 1581/4 date 22.02.2024	OBP

5	Shpenzime blerje kancelari me baze leter	5 000 000	Marveshjes Kuader dy vjecare Nr.123/19, datë 27.09.2022 me fitues: BOE InfoSoft office J62426002Q & Interlogistic K21605003M	5 459 045	Minikontrata 19410/1 date 10.12.2024	OBP
6	Blerje Karburant	20 166 667	Marveshjes Kuader tre vjecare nr.174/13, date 22.11.2022 me operatorin : KASTRATI& KASTRATI GOUP	19 225 800	Minikontrata nr.10426/3 dt 14.06..2024	ASHPP
7	Sigurimi i Godinave	8 000 000	Marveshjes Kuader nje vjecar Nr. 1204/9, datë 25.10.2024 me fitues: Albsig sha K42108801C	7 991 698	Minikontrata Nr. 18256/6, dt 14.11.2024	OBP
8	Qira operationale (Pajisje elektrinike, fotokopje, printare etj.)	16 666 667	Marveshje kuader tre vjecare me nr. 5030/40, date 07.11.2024 InfoSoft office J62426002Q	1 089 320	Minikontrata Nr. 5030/47, dt 18.11.2024	DPT

#### Investime te realizuara ne vitin 2024

	<b>INVESTIME 231</b>					
1	Blerje paisje zyre	1 666 667	Kontrate nr.17923/2,date 14.11.2024 operatori Shaga J96822229J	1 823 712	Kontrate e perfunduar me sukses	OBP
2	Brandimi i godinave DPT+14 DRT	31 666 667	Kontrate nr. 5787/13, date 06.08.2024 Dixhi print-AL K72210003J	34 352 844	Kontrate e perfunduar me sukses	AKSHI
3	Rikonstruksion e DRT Fier (shtese kati)	33 333 333	Kontrat nr.14370/20 date 23.12.2022 operator BOE Alba Konstruksion & OB Konstrucion	39 967 970	Kontrate e perfunduar me sukses	DPT

## XIV. DIBA

Në lidhje me masat e mëtejshme me qëllim parandalimin dhe goditjen e rasteve korruptive, bazuar dhe në zbatim të Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, “*Për Procedurat Tatimore në RSH*”, (i ndryshuar), Neni 105/1 i tij, dhe akteve të tjera nënligjore dalë në zbatim të tij, Drejtoria e Investigimit të Brëndshëm (Antikorrupsion) në DPT, gjatë periudhës raportuese Janar-Dhjetor 2024, ka kryer verifikimin dhe investigimin për **43 (dyzet e tre)** çështje të denoncuar, nga këto:

- **6 (gjashtë)** çështje kanë rezultuar me shkelje administrative gjatë kryerjes së detyrave funksionale, ku përfshihen gjithësej **23 (njëzet e tre)** punonjës me shkelje administrative të referuar pranë Komisionit të Disiplinës.
- **1 (një)** çështje është referuar pranë dhe Organit të Prokurorisë për veprën penale “*Falsifikim i dokumentave*” parashikuar në nenin 186, të Kodit Penal.
- **5 (pesë)** nga çështjet e regjistruar gjatë vitit 2024, janë në proces investigimi dhe kanë kaluar në regjistrin e vitit 2025.

## XV. Drejtoria e Kontrollit të Specializuar

### Hyrje

Që nga muaji Nëntor 2020, Drejtoria e Kontrollit të Specializuar, në bashkëpunim me Fondin Monetar Ndërkombëtar, ka nisur hartimin e një strategjie përmbushjeje për individët me të ardhura të larta. Kjo strategji mbështetet në 2 (dy) shtylla kryesore: - Menaxhimi i Riskut të Përmbushjes (MRP); - Kontrolli Tatimor.

Qëllimi i strategjisë së përmbushjes për individët me të ardhura të larta është nxitja e përmbushjes vullnetare për këta individë. Duke qenë se trajtimi i risqeve, përmes një strategjie që ka në fokus popullatën e individëve me të ardhura të larta, përbën një fushë relativisht të re për administratën tatimore, ka qenë e nevojshme ndjekja e udhëzimeve dhe rekomandimeve të Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN) në këtë drejtim.

Gjatë vitit 2024, Drejtoria e Kontrollit të Specializuar kreu detyrat funksionale, në përputhje me objektivat strategjike të administratës tatimore dhe me aktivitetet e planifikuara dhe të miratuara në Planin Operacional 2024.

Aktivitetet e planifikuara dhe të realizuara gjatë vitit 2024 lidhen me:

- Planin Sektorial të Informalitetit të Pagave;
- Planin e Përmbushjes për Individët me të Ardhura të Larta, Viti 2022;
- Planin e veprimit për individët që nuk kanë dorëzuar DIVA për vitin 2023; - Analizën e Riskut për Individët Importues 2023; - Trajnimin e stafit.

### Struktura organizative

Drejtoria e Kontrollit të Specializuar bën pjesë në organigramën e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe është në varësi të zv. Drejtorit të Përgjithshëm të Funksioneve Operacionale. Sipas strukturës organizative, Drejtoria e Kontrollit të Specializuar është e organizuar në 2 (dy) sektorë, si më poshtë:

- Sektori i Analizës së Riskut dhe Procesi i Përzgjedhjes së Individit; dhe - Sektori i Kontrollit të Individit.

Sipas strukturës organizative, Sektori i Analizës së Riskut dhe Procesi i Përzgjedhjes së Individit ka në përbërje të tij 5 (pesë) inspektorë, ndërsa Sektori i Kontrollit të Individit ka në përbërje të tij 4 (katër) inspektorë.

Gjatë vitit 2024, në Sektorin e Analizës së Riskut dhe Procesi i Përzgjedhjes së Individit kanë qenë të emëruar 4 (katër) inspektorë, ndërsa në Sektorin e Kontrollit të Individit kanë qenë të emëruar 3 (tre) inspektorë.

### Objekti dhe detyrat për vitin 2024

Objekti i Drejtorisë së Kontrollit të Specializuar është nxitja e përmbushjes vullnetare për individët me të ardhura të larta.

Detyrat kryesore të Drejtorisë së Kontrollit të Specializuar janë:

1. Mbledhja dhe administrimi i të dhënave të individëve me të ardhura të larta, të siguruara brenda sistemit tatimor dhe nga palët e treta, në funksion të kryerjes së analizës së riskut;
2. Kryerja e analizës së riskut të individëve, ku përfshihen identifikimi, vlerësimi i risqeve, hartimi dhe implementimi i strategjisë së trajtimit të risqeve, monitorimi i rezultateve etj.;
3. Kryerja e kontrolleve tatimore për individët;
4. Monitorimi i rezultateve faktike, gjatë zbatimit të strategjive të trajtimit të risqeve.

### Aktivitetet e planifikuara dhe të realizuara gjatë vitit 2024

#### Plani Sektorial i Informalitetit të Pagave

Në zbatim të Vendimit të Komitetit të Përmbushjes me nr. 31, datë 29. 07. 2022, pika 2

*“Miratimi i masave që lidhen me informalitetin në tregun e punës”*, Urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve me nr. 94, datë 05.08.2022 *“Për ngritjen e grupit të punës për monitorimin e zbatimit të planit sektorial për kontrollin e infomalitetit të pagave”*, ligjit nr.

9920, datë 19.05.2008 *”Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”*, i ndryshuar, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 *“Për tatimin mbi të ardhurat”*, i ndryshuar, Drejtoria e Kontrollit të Specializuar përfundoi kontrollet tatimore të individëve, të punësuar në biznese të sektorit të Medias dhe Arsimit.

Lidhur me rezultatet e kontrolleve tatimore, nga Drejtoria e Kontrollit të Specializuar u krye monitorimi i veprimeve procedurale përsa i përket vlerësimeve tatimore, të ndërmarra nga DRT-të përkatëse.

Plani i Përbushjes për Individët me të Ardhura të Larta, Viti 2022

“Plani i Përbushjes për Individët me të Ardhura të Larta, Viti 2022” u miratua me vendimin e Komitetit të Riskut me nr. 18, datë 29.04.2024.

Ky plan u fokusua në Menaxhimin e Riskut të Përbushjes (MRP), i cili ndoqi hapat si më poshtë:

1. Identifikimi i popullatës së individëve me të ardhura të larta;
2. Përgatitja e portofolit;
3. Hartëzimi i riskut.

1. Identifikimi i popullatës së individëve me të ardhura të larta

Për identifikimin e popullatës së individëve me të ardhura të larta u përdorën kriteret si më poshtë:

1. *Shuma e të të ardhurave të tatueshme, të deklaruar në deklaratën individuale vjetore të të ardhurave (DIVA), për vitin 2022; dhe*
2. *Pjesëmarrja në kapitalin e shoqërive nën juridiksionin e Drejtorisë së Tatimpaguesve të Mëdhenj, që kanë realizuar qarkullimin me të lartë, gjatë vitit 2022.*

2. Përgatitja e portofolit

Të dhënat e vitit 2022, që u përdorën për përgatitjen e portofolit, u morën nga:

- Deklaratat individuale vjetore të të ardhurave (DIVA), të dorëzuara nga individët e popullatës;
- Regjistri i subjekteve të lidhur (biznese ose entitete të lidhur me individët e popullatës);
- Deklaratat e tatimit të mbajtur në burim, të dorëzuara nga individët e popullatës;
- Deklaratat e tatimit të mbajtur në burim, të dorëzuara nga subjektet e lidhur;
- Vendimet e Asamblesë së Ortakëve, të dorëzuara nga subjektet e lidhur;
- Pasqyrat Financiare dhe raportet e audituesve ligjorë, të dorëzuara nga subjektet e lidhur; - Regjistri Qendror i Llogarive Bankare.

3. Hartëzimi i riskut

Bazuar në të dhënat e portofolit, u krye hartëzimi i riskut, sipas hapave të mëposhtëm:

- a. Përcaktimi i kriterëve të riskut dhe i pikëve përkatëse. U përcakuan kriteret e riskut dhe pikët përkatëse për secilin prej tyre, lidhur me të dhënat nga sistemi informatik tatimor.

- b. Aplikimi i kriterëve të riskut dhe akordimi i pikëve përkatëse. U aplikuan kriteret e riskut dhe do të akordohen pikët përkatëse në popullatën e individëve me të ardhura të larta.
- c. Segmentimi i popullatës së individëve me të ardhura të larta. Pasi u aplikuan kriteret e riskut dhe u akorduan pikët përkatëse në popullatën e individëve me të ardhura të larta, u krye segmentimi i kësaj popullate, në varësi të nivelit të riskut që individët paraqisnin, si më poshtë:
- Individë me risk të ulët;
  - Individë me risk të mesëm;
  - Individë me risk të lartë;

#### Plani i veprimit për individët që nuk kanë dorëzuar DIVA për vitin 2023

Lidhur me individë të cilët nuk kishin përmbushur detyrimin ligjor për plotësimin dhe dorëzimin e deklaratës individuale vjetore të të ardhurave (DIVA) për vitin 2023, sipas parashikimeve të nenit 13, të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për Tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, u hartua “Plani i Veprimeve për Individët, Subjekt i Deklarimit të Deklaratës Individuale Vjetore të të Ardhurave (DIVA) për vitin 2023”. Ky plan u miratua me vendimin e Komitetit të Riskut me nr. 18, datë 29.04.2024.

Pas miratimit të këtij plani, Drejtoria e Kontrollit të Specializuar, në bashkëpunim me Drejtorinë e Teknologjisë së Informacionit në DPT (AKSHI) siguroi informacionin lidhur me individët që nuk kanë dorëzuar DIVA për vitin 2023. Ky informacion, në mënyrë të përmbledhur, paraqitet si më poshtë:

DRT	Individë që nuk kanë dorëzuar DIVA 2023		
	Të regjistruar	Të paregjistruar	GJITHSEJ
Drejtoria Rajonale e Tatimeve Berat	137	393	530
Drejtoria Rajonale e Tatimeve Dibër	141	616	757
Drejtoria Rajonale e Tatimeve Durrës	797	3,036	3,833
Drejtoria Rajonale e Tatimeve Elbasan	358	993	1,351
Drejtoria Rajonale e Tatimeve Fier	400	1,392	1,792
Drejtoria Rajonale e Tatimeve Gjirokastrë	125	357	482
Drejtoria Rajonale e Tatimeve Korçë	220	607	827

Drejtoria Rajonale e Tatimeve Kukës	98	263	361
Drejtoria Rajonale e Tatimeve Lezhë	196	491	687
Drejtoria Rajonale e Tatimeve Sarandë	138	458	596
Drejtoria Rajonale e Tatimeve Shkodër	210	645	855
Drejtoria Rajonale e Tatimeve Tiranë	5505	13,744	19,249
Drejtoria Rajonale e Tatimeve Vlorë	326	1,145	1,471
Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj	-	8,854	8,854
<b>GJITHSEJ</b>	<b>8,651</b>	<b>32,994</b>	<b>41,645</b>

Informacioni në nivel analitik lidhur me individët që nuk kanë dorëzuar DIVA për vitin 2023, së bashku me kërkesën për veprim, u drejtuan në drejtoritë rajonale tatimore përkatëse. Veprimet e drejtorive rajonale tatimore konsistojnë, së pari, në marrjen e masave për njoftimin e individëve, me qëllim vetëdeklarimin e deklaratës individuale vjetore të të ardhurave (DIVA) për vitin 2023. Së dyti, në rast mosreflektimi të individëve, në kryerjen e vlerësimit tatimor nga inspektori.

Drejtoria e Kontrollit të Specializuar monitoroi, në mënyrë sistematike, kryerjen e aktiviteteve, sipas këtij plani. Për këtë qëllim, u hartuan formatet e raportimit lidhur me këto aktivitete, të cilat i'u vunë në dispozicion Drejtorive Rajonale Tatimore.

#### Trajnimi i stafit

Me qëllim rritjen e kapaciteteve dhe aftësive, gjatë vitit 2024 stafi i Drejtorisë së Kontrollit të Specializuar ndoqi një seri trajnimesh, si më poshtë:

Nr.	Tematika	Organizmi/instanca trajnuese
1	Shkëmbimi Automatik i Informacionit (AEOI)	Agjencia Tatimore Suedeze (STA)
2	Kontrolli tatimor	Agjencia Tatimore Suedeze (STA)
3	Ligji nr. 29/2013, datë 30.03.2023 "Për tatimin mbi të ardhurat"	Qendra e Trajnimeve të Administratës Tatimore dhe Doganore (QTATD)
4	Taksimi Ndërkombëtar (International Taxation)	Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN)

## XVI. DREJTORIA PËR PROCESET E BIZNESIT

Varësia sipas strukturës organizative të DPT dhe historiku i krijimit.

❖ Drejtoria për Proceset e Biznesit (shkurtimisht DPB) është një drejtori e cila bën pjesë në funksionet mbështetëse në DPT.

Drejtoria për Proceset e Biznesit në organigramën e DPT është në varësi të zv. Drejtorit të Përgjithshëm të Mbështetjes së Programeve dhe drejtohet nga Drejtori i Drejtorisë së DPB.

❖ DPB është krijuar në korrik të vitit 2020 me objektiv strategjik për t'ju ardhur në ndihmë drejtorive, pra për përmirësimin e proceseve të tyre më qëllim automatizimin dhe lehtësimin në kryerjen e detyrave funksionale, e cila do të sillte ndikim drejtpërdrejt tek tatimpaguesit, duke ulur barrën administrative të tyre, në funksion të përmbushjes së planit strategjik të DPT për zgjerimin e komunikimeve elektronike midis tatimpaguesit dhe DPT, si dhe përmirësimin e proceseve. Po ashtu edhe në funksion të përmbushjes së Rekomandimeve të FMN.

Në bashkëpunim me drejtoritë e tjera, DPB bën identifikimin e opsioneve dhe rekomandon opsionin më të përshtatshëm për tu implementuar në mënyrë që zgjidhja IT të përputhet me kërkesat e administratës tatimore, e realizueshme kjo nëpërmjet sektorit të analizës dhe implementimit.

Me ndryshimet e reja në strukturën organizative të administratës tatimore për vitin 2023, efektive në muajin Janar 2024, DPB përbëhet nga dy sektorë, Sektori i Analizës dhe Implementimit të Proceseve të Biznesit dhe Sektori i Koordinimit të Manualeve të Punës.

### Organizimi

DPB është e organizuar në dy sektor:

❖ **Sektori i Analizës dhe Implementimit të Proceseve të Biznesit**, (1+5) i cili ka si funksionalitet kryerjen e një analize për mënyrën e implementimit të proceseve të biznesit. Aktualisht ky sektor ka patur si Plan Operacional zhvillimin e takimeve me drejtoritë e tjera brenda DPT duke nxitur bashkëpunimin mes tyre në lidhje me përmirësimin e proceseve të tyre dhe ka rezultuar i frytshëm pasi janë koordinuar punët me disa drejtori të cilat kanë shprehur nevojën për përmirësime apo automatizime procesesh pune.

❖ **Sektori i Koordinimit të Manualeve të Punës (1+2)** është një sektor i ri i cili u krijua me ndryshimet në strukturën organizative të administratës tatimore në vitin 2023.

#### Sektori i Koordinimit të Manualeve të Punës

Objekti i punës së Sektorit të Koordinimit të Manualeve të Punës është koordinimi me drejtoritë në DPT për krijimin dhe përditësimin e manualeve të punës. Në rast të ndryshimeve ligjore bashkërendon punën me drejtorinë përkatëse për përditësimin e këtyre ndryshimeve në manualin e punës. Në rastin kur ka ndryshime strukturore, si psh krijimi i sektoreve/drejtorive të reja, merr informacion nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore për ndryshimet e kryera dhe koordinon punën me këto drejtori për hartimin e manualeve të punës.

Pjesë e detyrave funksionale të Sektorit janë:

- Koordinimi i strukturave të DPT për krijimin, përditësimin e manualeve të tyre të punës me qëllim qartësimin, dokumentimin e punës së kryer nga strukturat për realizimin e detyrave të tyre funksionale;
- Mban një regjistër ku përditëson kërkesat e strukturave përkatëse lidhur me ndryshimet në manualet e punës, ndjek dhe koordinon punën deri në miratimin e ndryshimeve dhe variantin përfundimtar e kalon për publikim në rrjetin e brendshëm të Administratës Tatimore;
- Kërkon periodikisht apo kur paraqitet rasti, vlerësim nga strukturat në DPT, mbi vlefshmërinë e manualeve respektive të punës;

Gjatë vitit 2024 DPB ka zhvilluar trajnime në kuadër të asistencës nga STA (**Administrata Tatimore Suedeze**) bashkë me Sektorin e Analizës dhe Implementimit në lidhje me Proceset e biznesit.

Në kuadër të miratimit të strukturës së re në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve dhe ndryshimeve të fundit që prekin pjesën më të madhe të drejtorive dhe sektorëve, nga ana e Sektorit të Koordinimit të Manualeve të Punës është kërkuar të përditësohen manualet e punës për drejtoritë ekzistuese funksionale dhe të hartohen e strukturohen manualet e reja pune për drejtoritë e krijuar rishtazi, të detajuar në role për të gjithë punonjësit, në zbatim të detyrave funksionale të këtyre drejtorive.

## Sektori i Analizës dhe implementimit

Pjesë e detyrave funksionale të Sektorit të Implementimit dhe Analizës bazuar në Rregulloren e Administratës Tatimore Qendrore janë:

- Kryen analizën për mënyrën e implementimit të proceseve të biznesit në sisteme, në përputhje me legjislacionin dhe procedurat tatimore;
- Kryen analizën e diferencave midis procedurave dhe shkallës së automatizimit;
- Bën identifikimin e opsioneve, për t'u implementuar, në mënyrë që zgjidhja IT të përputhet me kërkesat e Administratës Tatimore;
- Bën identifikimin e risqeve kryesore për një projekt të suksesshëm;
- Mirëmban dhe kryen dizejnimin e dokumentave dhe formularëve elektronikë që përdoren në sisteme;
- Ndjek dokumentimin e sistemeve, manualeve të përdorimit në sisteme;
- Merr pjesë në idejimin e raporteve, analizave dhe statistikave;
- Ndjek proceset e testimit me Drejtoritë funksionale dhe bën dokumentimin e rezultateve të testimit.

Me hyrjen në fuqi të ligjit të ri për tatimin mbi të ardhurat, u ngrit grupi i punës ku ishte përfshirë edhe DPB, i cili hartoi dokumentin e analizës funksionale për ndryshimet që duhet të implementohen në sistemin E-tax.

Gjatë vitit 2024, përveç automatizimit të proceseve të punës, janë kryer përditësime edhe në procese pune të disa drejtorive funksionale si pasojë e ndryshimeve të tjera ligjore.

## Bashkëpunimi me palët e treta.

Në kuadër të realizimit të detyrave funksionale të përcaktuara shprehimisht në Rregulloren e Adminsitratës Tatimore Qendrore, Sektori i Analizës dhe Implementimit për zgjidhjen e praktikave të adresuara bashkëpunon me palët kontraktore të sistemeve dhe me palët e treta si vijon:

- ❖ **IKUB – DPB** dërgon për ndjekje dhe bashkëpunon me IKUB për implementimin e ndryshimeve dhe ndjekjen e problematikave në sistemin E-tax.
- ❖ **BOE – DPB** dërgon për ndjekje dhe bashkëpunon me BOE për implementimin e ndryshimeve dhe ndjekjen e problematikave në sistemin e Fiskalizimit. Gjatë vitit 2024,

janë kryer disa zhvillime të reja për përmirësimin e proceseve të sistemit të fiskalizimit. Ndër zhvillimet madhore të kryera gjatë vitit mund të përmendim: shfaqja në librat e blerjes të faturave të refuzuara, shtimi i kontrolleve për autofaturat dhe autongarkesën.

- ❖ **DPT – KLGJ** krijimi i protokollit të komunikimit për të dhënat e regjistrimit të organizatave jofitimprurëse dhe subjekteve të tjera të cilat regjistrohen në Gjykatë, sipas legjislacionit në fuqi.
- ❖ **DPT – QKB** përmirësimi i komunikimit dhe shkëmbimit të të dhënave ndërmjet sistemeve. Zgjidhja e problematikave të ndryshme në shkëmbimin e të dhënave sipas rastit.
- ❖ **Kompanitë e certifikuarat software – DPB** komunikime teknike mbi përditësimet e zhvillimeve në sistemin e Fiskalizimit, si dhe zbatimi i kërkesave teknike që janë propozuar nga kompanitë e certifikuarat.
- ❖ **Sistemet ASYCUDA – E-TAX – SELFCARE** komunikimi me sistemin doganor Asycuda për të dhënat e deklaratave doganore të tatimpaguesve. Janë ndërmarrë disa ndryshime teknike që të mos ketë ndërprerje të transmetimit të të dhënave ndërmjet sistemeve. Po ndërmerren masa për ndryshimin e protokollit të komunikimit për ngritjen e webservice të ri për mundësinë e transmetimit të të dhënave doganore direkt nga Asycuda drejt SelfCare, pa kaluar nëpërmjet sistemit CATS.
- ❖ **Drejtoria e Menaxhimit të Riskut** dhe Drejtoria për Proceset e Biznesit ka evidentuar disa nga regjistrat elektronik të palëve të treta që janë të publikuara në GOVNet, dhe në bashkëpunim me AKSHI-n po evidenton mundësinë për shfrytëzimin e të dhënave duke i përfshirë në DataWarehouse e sistemit të fiskalizimit. Disa nga regjistrat të cilat aktualisht merren të dhëna (jo të gjitha në kohë reale), mund të përmendim OSHEE, UKT, Regjistri i Noterëve NISA, Bashkia e Tiranës, DPSHTRR, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, AKEP etj.

#### Veprimtaritë në proces dhe të kryera

Gjatë vitit 2024 janë ndërmarrë disa përmirësime apo zhvillime të reja në sisteme (E-tax dhe atë të Fiskalizimit), ndër të cilat mund të përmendim:

- Implementimi i plotë i deklaratave të reja, bashkë me raportet përkatës, sipas Ligjit 29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar, i cili hyri në fuqi me datë 1 Janar 2025.

- Ngritja e webservice të ri për marrjen e faturave të shitjes dhe të blerjes nga kompanitë software të certifikuara.
- Kontrolllet dhe kufizimet tek vetëfaturimet në sistemin e fiskalizimit në mjedisin test.
- Shfaqja në librat e blerjeve të faturave të refuzuara.
- Implementimi i regjistrit elektronik të OJF në gjykatë, ne proces.
- Rishikimi i kushteve në sistem (në bashkëpunim edhe me ISSH) për dërgimin e listëpagesave me probleme për institucionet shtetërore, kryesisht Zyrat Arsimore, Repartet ushtarake etj.
- Shtimi i kontrolleve në vlerë për faturat korigjuese në sistemin e fiskalizimit. Moslejimi i refuzimit të faturave anuluese/korigjuese, e cila lëshohet për korigjimin e një fature elektronike të refuzuar më parë.
- Shtimi i funksionalitetit në SelfCare dhe ngritja e webservice të ri për kompanitë e certifikuara për deklarimin e numrit real të klientëve që përdorin zgjidhjet e tyre software-ike, dhe vlefshmëria e kontratave të ofrimit të këtij shërbimi.
- Zgjidhja e problematikave të ndryshme sipas rastit, në sistemin C@TS dhe atë të Fiskalizimit.
- Si dhe të gjitha ndryshimet e kryera në sisteme të cilat reflektojnë ndryshimet ligjore.

Gjatë vitit 2024, DPB ka zhvilluar trajnime në kuadër të asistencës nga STA (Administrata Tatimore Suedeze) mision fizik i tyre në Tiranë dhe misione online, në lidhje me Proceset e biznesit. Gjatë vitit 2024 është përfunduar në mjedisin test pyetësori “**Tax Test**” për individët që duan të informohen mbi detyrimin për deklarimin e të ardhurave individuale vjetore (DIVA). Pritet miratimi për ta kaluar në faqen zyrtare web të këtij pyetësori.

## XVII. DREJTORIA E INFORMACIONIT

### HYRJE

Objekti kryesor i punës së Drejtorisë së Informacionit përcaktuar edhe në Rregulloren e Administratës Tatimore Qendrore është garantimi i informimit të tatimpaguesve dhe individëve për punën e institucionit/produktin dhe shërbimet e tij dhe si kthimi i përgjigjeve të kërkesave për informacion që i drejtohen Drejtorisë së Informacionit.

### Detyrat kryesore të Drejtorisë së Informacionit

- Planifikimi dhe hartimi i fushatave sensibilizuese mbi objektivat e punës së Administratës Tatimore dhe për çështje me impakt të gjerë në publik;
- Garanton maksimizimin e daljeve publike për çështje të ndryshme, në të gjitha kanalet e komunikimit publik (Web-e, TV dhe media sociale);
- Siguron organizimin e aktiviteteve, intervistave dhe takimeve me qëllim informimin dhe promovimin e punës së institucionit/produktin dhe shërbimet e tij;
- Kultivon komunikim të vazhdueshëm me përfaqësues të medias, gazetarë dhe profesionistë të tjerë, influentë të fushës;
- Ka në ngarkim funksionin e Koordinatorit për të Drejtën e Informimit për dhënien e informacionit duke respektuar afatet ligjore, në zbatim të ligjit “Për të Drejtën e Informimit”;
- Trajton kërkesat për informacion që vijnë në kuadër të AEOI (Automatic Exchange of Information) dhe EOIR (Exchange of Information on Request) si dhe kërkesat që i drejtohen Drejtorisë së Informacionit që vijnë nga:
  1. Mediat;
  2. Institucionet publike;
  3. Tatimpaguesit;
  4. Individët;
  5. Përmbauesit

Në kuadër të realizimit të detyrave të mësipërme, Drejtoria e Informacionit ka në fokus rritjen dhe përmirësimin e komunikimit me tatimpaguesit nëpërmjet informimit në të gjitha kanalet e komunikimit dhe jo vetëm.

## Organizimi i Drejtorisë së Informacionit

Drejtoria e Informacionit sipas organigramës së DPT-së është në varësi të Drejtorit të Përgjithshëm, drejtohet nga Drejtori i Drejtorisë së DI dhe është e organizuar në 2 sektorë.

- Sektori i Shkëmbimit të Informacionit me 1 Përgjegjës dhe 7 Inspektorë (5 pozicione vakante - 1 Përgjegjës, 4 Inspektorë)
- Sektori i Komunikimit me 1 Përgjegjës dhe 3 Specialistë ( 1 pozicion vakant - 1 Përgjegjës)

## Objektivat e Drejtorisë për vitin 2024

### **2.1 Garantimi i informimit dhe ndërgjegjësimit të tatimpaguesve dhe opinionit publik me qëllim përmbushjen vullnetare të detyrimeve tatimore**

- ✓ Publikimi në kohë i çdo njoftimi, lajmi apo pop-up që lidhet me aktivitetin e Administratës Tatimore;
- ✓ Bashkëpunimi me drejtoritë përkatëse për dhënien e një informacioni të bazuar në ligj, të qartë dhe të kuptueshëm brenda afateve ligjore;
- ✓ Rikujtesë tatimpaguesve për përmbushjen e detyrimeve tatimore me qëllim shmangien e masave administrative të parashikuara në ligj.

### **2.2 Rritja e sensibilizimit publik në kuptimin e rolit të Administratës Tatimore në shoqëri**

- ✓ Informimi dhe komunikimi publik i vazhdueshëm me tatimpaguesit;
- ✓ Zbatimi i planit të komunikimit me në fokus ndryshimet ligjore sipas ligjit të ri dhe çështjet prioritare që Administrata Tatimore ka në fokus, në kohë dhe rrethana të caktuara.

### **2.3 Zhvillimi i kapaciteteve dhe motivimi i punonjësve**

- ✓ Ndarja racionale e detyrave brenda Drejtorisë;
- ✓ Vlerësimi objektiv i punonjësve sipas meritës dhe aftësive;
- ✓ Trajnimi i vazhdueshëm i punonjësve me qëllim ofrimin e shërbimit dhe informacionit për tatimpaguesit në mënyrë sa më efektive;

## AKTIVITETET E PROGRAMUARA DHE KRYERA GJATË VITIT 2024

Duke pasur parasysh organizimin e strukturës së Drejtorisë së Informacionit, raportimi mbi rezultatet dhe veprimtarinë e saj për vitin 2024 do të pasqyrohet në 2 ndarje kryesore sipas sektorëve përkatës, përkatësisht: Sektori i Komunikimit dhe Sektori i Shkëmbimit të Informacionit.

### SEKTORI I KOMUNIKIMIT

#### **Publikimi dhe redaktimi i njoftimeve në website dhe rrjete sociale.**

- ✓ Janë përgatitur, redaktuar dhe publikuar njoftime/ lajme në web-in të Administratës Tatimore.
- ✓ Janë përgatitur dhe publikuar njoftime dhe poste në rrjetet sociale Facebook, Instagram dhe LinkedIn.
- ✓ Janë përgatitur dhe redaktuar pop-up me temat si më poshtë vijon dhe ju janë shfaqur tatimpaguesve në momentin që hynin në eFiling:
  - Paga të nëndeclaruara;
  - Tatimpagues me kontribute më të ulta se kontributet për pagën maksimale;
  - Tatimpagues me kategori "Të Dypunësuar...." në një listëpagesë;
  - NIVF jo të rregullt;
  - Individ të dypunësuar;
  - Të dhëna kontakti;
  - Dorëzimi i pasqyrave financiare;
  - Llogari bankare rikujtesë;
  - Llogaritë financiare;
  - Shërbimet profesionale;
  - Mesazh në kuadër të DIVA;
  - Tatimpagues me aktivitet taksis;
  - Llogari bankare;
  - Mesazh Sensibilizues;
  - Tatimpagues me blerje Vaj Palme;
  - Rritje e pagës Minimale në 40 000 lekë;

- Deklarimi i listëpagesës cdo muaj;
- Sektori turistik;
- Adresa ambientit;
- Nëndeklarimi i pagave;
- Tatimpagues me pak fatura shitje;
- Avokati i Tatimpaguesit2
- Avokati i Tatimpaguesit1

### **Publikimi i Spoteve në rrjetet sociale.**

Gjatë vitit 2024 në kanalet e komunikimit të Administratës Tatimore janë publikuar 5 Spote me qëllim informimin e tatimpaguesve në lidhje ndryshimet e Ligjit nr. 29/2023 “Për Tatimin mbi të Ardhurat” i ndryshuar.

### **Trajtimi i kërkesave dhe çështjeve të ardhura në Zyrën e Shtypit dhe te Koordinatori për të Drejtën për Informim.**

- ✓ Te koordinatori për të drejtën për informim kanë ardhur gjithsej 36 kërkesa. Të gjitha janë trajtuar dhe ju është kthyer përgjigje brenda afatit të përcaktuar në legjislacionin në fuqi.
- ✓ Te zyra e shtypit kanë ardhur dhe janë trajtuar rreth 650 çështje. Të gjitha rasteve i është kthyer përgjigje brenda afatit ligjor.

### **Përdorimi i gjuhës së thjeshtë**

Drejtorja e Informacionit ka bashkëpunuar me Drejtorinë e Shërbimit të Tatimpaguesve dhe Drejtorinë Rajonale Tatimore me qëllim përdorimin e një gjuhe sa më të thjeshtë dhe informimin e tatimpaguesve në kohë reale për ndryshimet dhe hapat që duhen ndjekur në zbatim të ligjit të ri 29/2023 “Tatimi mbi të Ardhurat” i ndryshuar.

### **Detyra të tjera të realizuara nga Drejtorja e Informacionit.**

- ✓ Ka përgatitur fjalimet e Drejtorit të Përgjithshëm për konferencat ku ky i fundit ka marrë pjesë;
- ✓ Ka organizuar aktivitete publike me qëllim informimin për çështje të caktuara që lidhen me ndryshimet ligjore dhe detyrimet tatimore;

- ✓ Ka organizuar intervista me qëllim informimin e publikut në lidhje me detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni tatimor apo çështje të tjera në fokus;
- ✓ Ka trajtuar dhe i ka kthyer përgjigje brenda afatit të gjitha kërkesave për informacion që kanë ardhur nga mediat.

## SEKTORI I SHKËMBIMIT TË INFORMACIONIT

### **Trajtimi i kërkesave për informacion në rrugë shkresore**

Gjatë vitit 2024 janë trajtuar dhe i është kthyer përgjigje brenda afateve ligjore 1930 shkresave të ardhura në Drejtorinë e Informacionit, të ndara si më poshtë vijon:

- 407 shkresa të ardhura nga Përmbauesit;
- 1402 shkresa të ardhura nga palët e treta (Institucionet publike);
- 80 shkresa të ardhura nga tatimpaguesit dhe individët;
- 41 shkresa të ardhura në kuadër të EOIR (Exchange of Information on Request).

### **Trajtimi i kërkesave/ ankesave të ardhura nga Zyra e Bashkëqeverisjes**

- ✓ Janë ndjekur, trajtuar dhe ju është kthyer përgjigje brenda afatit 243 kërkesave/ankesave të ardhura nga Zyra e Bashkëqeverisjes.

### **Angazhimi në grupe pune**

Inspektori i Sektorit të Shkëmbimit të Informacionit është pjesë e grupit të punës për trajtimin e kërkesave për përjashtim nga TVSH në kuadër të procesit të rindërtimit. Gjatë vitit 2024 ka trajtuar dhe ka kthyer përgjigje për 238 kërkesa për përjashtim nga TVSH.

Gjithashtu, inspektorët/specialistët e Drejtorisë së Informacionit kanë marrë pjesë në grupe pune të ndryshme të caktuara me urdhër të titullarit.

### **AEOI (Automatic Exchange of Information) – Shkëmbimi automatik i informacionit**

Në vijim të takimeve dhe komunikimeve të zhvilluara për sa i takon raportimit në OECD, por edhe FMN apo në Steering Committee të projektit me Administratën Tatimore Suedeze dhe Ambasadën e Suedisë në Tiranë, në lidhje me AEOI, Drejtoria e Informacionit në bashkëpunim

me Drejtoritë e tjera në DPT ka dërguar një pyetësor të dedikuar për 5 Institucione Financiare Raportuese që kanë raportuar deri në 30 Maj 2024, sipas tipologjisë në përputhje me strategjinë e përmbushjes administrative për standardin e shkëmbimit automatik të informacionit të llogarive financiare (AEOI)”.

Është bërë publikim në web duke rikujtuar Institucionet Financiare shqiptare në lidhje me afatin e fundit për të raportuar “Për Shkëmbimin Automatik të Informacionit për Llogaritë Financiare” në zbatim të ligjit 4/2020, si dhe detyrimin e tyre për të raportuar.

Është bërë publikim në web për të njoftuar Institucionet Financiare për respektimin e formatit të raportimit.

### **CBCR (Country by Country Report)**

Janë hartuar tre draft-manualet finale për “Raportimin Për Çdo Vend” nga grupi i punës, pjesë e të cilit është dhe DI, ku janë reflektuar edhe komentet e ekspertëve të OECD-së si më poshtë:

- ✓ Draft-Manualin e Përdorimit të Duhur;
  - ✓ Draft-Manuali i Brendshëm;
  - ✓ Draft-Manuali i Tatimpaguesit.
- 
- ✓ Një tjetër objektiv i Drejtorisë së Informacionit është dhe maksimizimi i daljeve publike me qëllim promovimin e punës së Administratës Tatimore, aktiviteteve të institucionit dhe misionit të tij.
  - ✓ Në fokus mbetet zbatimi i planit të komunikimit për vitin 2025, i cili fokusohet sipas 4 çështjeve prioritare:
    1. Implementimi i Ligjit të Ri të “Tatimit mbi të Ardhurat”;
    2. DIVA 2024
    3. Implementimi i Sistemit të Ri Elektronik të Borxhit